

4.8 Plani i Zhvillimit të Transportit Publik

Rritja e urbanizimit synon të ndryshojë jetën urbane dhe uljen e kostove të mallrave dhe shërbimeve për popullsinë. Në këtë kontekst, shërbimet e transportit publik duhet të plotësojnë kërkesa të ndryshme në qytet. Në këtë Studim, ka dy projekte të mëdha strategjike të Bashkisë së Tiranës, për planifikimin e zhvillimit të transportit publik:


- Zhvillimi i një terminali të transportit intermodal së bashku me rivendosjen e stacionit të trenit të Tiranës,
- Zhvillimi i dy linjave të tramit: lindje-perëndim (Kinostudio – Kombinat) dhe veri-jug (Terminali i Transportit Intermodal – Qytet Studenti)

Zhvillimi i transportit publik është propozuar për të mbështetur projektet e mësipërme bazë dhe për të zgjeruar më tej rrjetin e transportit publik në aspektet e zhvillimit të linjave të tramit, të transportit me autobusë, zhvillimit intermodal dhe hekurudhor. Ajo është paraqitur në Tabelën 4.8.1 dhe në Figurën 4.8.1. Për më tepër, projektet e zhvillimit të linjave të tramvajit dhe transportit me autobusë janë përfshirë në rrjetin e ardhshëm të tranzitit. Kërkesa në të ardhmen është parashikuar siç tregohet në Figurën 4.8.2.

Tabela 4.8.1 Lista e Projekteve të Zhvillimit të Transportit Publik


RUT-3-1	Tramlines Development
RUT-3-1-1	East-West (Kinostudio-Kombinat) Tramline Development
RUT-3-1-2	North-South (Student City-Intermodal Terminal) Tramline Development
RUT-3-1-3	North-South (Paskuqan) Tramline Development
RUT-3-1-4	Unaza (Circular) Tramline Development
RUT-3-2	Bus Transportation Development
RUT-3-2-1	Restructuring City/Commune Bus Lines
RUT-3-2-2	Transit Mall Development in the Center
RUT-3-2-3	Bus Location System Development
RUT-3-3	Intermodal Transportation Terminal Development
RUT-3-3-1	Relocation of Tirana Railway Station
RUT-3-3-2	Intercity Bus Terminal Development
RUT-3-4	Commuter Rail Development
RUT-3-4-1	Airport Rail Link Development
RUT-3-4-2	Tirana-Durres Commuter Railway Development

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 4.8.1 Projektet e Zhvillimit të Transportit Publik në Tiranë



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 4.8.2 Parashikimi i Kërkesës së Udhëtarëve të Rrjetit të Tranzitit të Propozuar në të Ardhmen (2027)

4.8.1 Zhvillimi i Linjave të Tramvajit

Bashkia e Tiranës po planifikon të ndërtojë linjat e tramit të sipërpërmendura, si pjesa bërthamë e rrjetit të transportit publik. Denduri e lartë lëvizjeje, zbatimi i orarit, shpejtësia, komforti, përballueshmëria, sistem në përputhje me çmimin dhe intermodaliteti i linjave të tramit, janë elementet kryesorë, që tërheqin jo vetëm banorët, që jetojnë në rrethina dhe që marrin autobusët, por edhe përdoruesit e transportit privat. Duke përfshirë dy linjat e sipërpërmendura për të rritur përdorimin e rrjetit, për zhvillimin e transportit publik janë listuar katër linjat e tjera:

- Linja e Tramvajit Veri-Jug (Terminali Intermodal i Transportit – Qytet Studenti): Kjo linjë shërben për të mbështetur biznesin e ri dhe aktivitetet tregtare përgjatë shëtitores veri-jug (Shëtitorja Zogu I), si dhe për transportin e udhëtarëve ndërmjet Terminalit të planifikuar Intermodal të Transportit dhe qendrës së qytetit. Kjo linjë duhet të lidhet në qendrën e Tiranës (Sheshi Skënderbej) me linjën e tramvajit lindje-perëndim, duke marrë udhëtarët ekzistues të të gjithë linjës së Uzinës Dinamo e Re.

- Linja e Tramvajit lindje-perëndim (Kinostudio – Kombinat): shërben për të zëvendësuar linjën ekzistuese të autobusëve, e quajtur linja Kinostudio – Kombinat, e cila lidh zonën verilindore dhe jugperëndimore të qytetit me numrin e dytë më të madh të udhëtarëve (afërsisht 43 000 udhëtarë/ditë).
- Zgjerimi i linjës së Tramvajit veri-jug (në drejtim të Paskuqanit): Zgjerimi i linjës veri-jug përkon me zhvillimin e korridorit të ri me shkallë të lartë banimi, industrie, tregtare dhe zhvillime krijuese të planifikuara nga Bashkia. DEK e kësaj linje është rezervuar në hapat e mëtejshëm të zhvillimit të shëtitorës veri-jug, hollësitë e së cilës nuk janë ende të qarta. Vëllimi i udhëtarëve në këtë linjë mund të jetë i pasigurt, ndërsa ajo ka potencialin më të madh për të shërbyer si bazë e zhvillimit të transportit të orientuar drejt tranzitit (ZhTO), i cili do të lejojë raporte të larta sipërfaqejeje përreth stacioneve të tramvajit për të nxitur përdorimin e dendur të përdorimit të tokës dhe zhvillimin.
- Linja unazore e Tramvajit (Unaza): shërben për të zëvendësuar linjën ekzistuese të autobusëve, e quajtur linja e Unazës, e cila ka numrin më të madh të udhëtarëve (afërsisht 54 000 udhëtarë/ditë). Për këtë arsye, mund të pritët një kërkesë e lartë e udhëtarëve, duke sjellë një efekt të integruar me linjat e tjera veri-jug dhe lindje-perëndim të tramvajit dhe që sjell formimin e një rrjeti më të plotë.

Duhet të shtohen vagonë të rinj, të rehatshëm, të sigurt dhe me ajër të kondicionuar, të paktën me të njëjtën interval si linjat ekzistuese të autobusëve, 4-7 minuta për të shmangur kohën e pritjes. Në Tabelën 4.8.2 është parashikuar vëllimi seksional mesatar dhe i lartë i udhëtarëve në të ardhmen në një orë të pikut në mëngjes në secilën prej katër linjave të tramvajit të propozuara më lart. Tre linjat e tramvajit, linja Veri-Jug (Terminali intermodal i Transporti - Qytet Studenti), Lindje-Perëndim (Kinostudio - Kombinat), dhe linja e unazës (Unaza) priten të kenë mbi 10 000 udhëtarë në orë, të cilat në përgjithësi quhen numër i mjaftueshëm i udhëtarëve për një projekt tramvaji ose THL të bëhet i zbatueshëm. Nga ana tjetër, zgjatimi i linjës Veri-Jug (në drejtim të Paskuqanit) pritët të ketë një numër të vogël të udhëtarëve. Prandaj, linjat e rregullta të autobusëve do t'i shërbejnë zgjatimit të Paskuqanit në rast se nuk janë parashikuar zhvillime shitesë me shkallë të gjerë, të cilat realizohen përgjatë këtij korridori.

Tabela 4.8.2 Parashikimi i Vëllimit Segmental të Udhëtarëve në Katër Linjat e Tramvajit të Propozuara (2027)


[Njësia: person/orë]

Linjat e Tramvajit	Mesatare	Maksimumi
Lindje-Perëndim (Kinostudio-Kombinat)	16 100	25 900
Veri-Jug (Qytet Studenti-Terminali Intermodal)	15 000	24 700
Veri-Jug (vetëm Zgjatimi i Paskuqanit)	3 700	6 200
Unaza (Qarkulluese)	10 700	14 400

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Në lidhje me zhvillimin e Unazës 4, Bashkia është gjithashtu e interesuar në kërkesën e udhëtarëve të pritshëm në një linjë tjetër tramvaji në Unazën 4, në qoftë se ajo është e vështirë për ta zhvilluar siç është planifikuar nga Bashkia. Meqë Unaza 4 do të jetë relativisht e ngushtë në krahasim me unazat e tjera, Bashkia është duke vlerësuar zhvillimin e një rruge vetëm për

linjën e tramvajit në segmentin verior dhe perëndimor të Unazës 4, e cila është e mbyllur për trafikun e makinave. Kështu, në Tabelën 4.8.3 janë parashikuar vëllimet segmentale mesatare dhe të larta të udhëtarëve në të ardhmen në një orë e pikut në mëngjes në secilën nga pesë linjat e tramvajit në rastin me një linjë tramvaji në Unazën 4. Numri mesatar i udhëtarëve i parashikuar në Unazën 4 është nën 5 000 udhëtarë në orë, madje edhe numri më i madh i udhëtarëve (parashikuar në segmentin ndërmjet Rrugës “Dritan Hoxha” dhe Rrugës “Don Bosko”) është nën 10 000 udhëtarë në orë, e cila në përgjithësi pranohet si pragu për të përcaktuar nëse duhet zhvilluar transporti me autobus apo transporti hekurudhor në shkallë të madhe. Kështu, linja e tramvajit në Unazën 4 nuk mund të mbështetet nga pikëpamja e kërkesës së udhëtarëve.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 4.8.3 Rrjeti i Tranzitit në të Ardhmen me një Linjë Tramvaji në Unazën 4 (2027)

Tabela 4.8.3 Parashikimi i Vëllimit Segmental të Udhëtarëve të Tramvajit me një Linjë Tramvaji në Unazën 4 (2027)

[Njësia: person/orë]

Linjat e Tramvajit	Mesatare	Maksimumi
Lindje-Perëndim (Kinostudio-Kombinat)	15 900	26 600
Veri-Jug (Qytet Studenti-Terminali Intermodal)	15 100	24 400
Veri-Jug (vetëm Zgjatimi i Paskuqanit)	3 700	6 200
Unaza (Qarkulluese)	10 200	13 200
Linja e Tramvajit në Unazën 4	4 600	9 200

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Në çdo rast, duhet të theksohet se kërkesa e udhëtarëve në të ardhmen do të ndryshojë në varësi të tërheqjes dhe komoditetit të sistemit të ri, duke përfshirë aksesin në linjën e tramvajit dhe intermodalitetin me mënyrat e tjera të transportit. Mbi të gjitha, vëmendje duhet t'i kushtohet transferimit ndërmjet mënyrave të ndryshme të transportit intermodal, që do të lidhë linjat e autobusëve (furnizuese) dhe ato të tramvajit, si dhe midis transportit privat dhe linjave të tramvajit (sistemi Parko dhe Udhëto). Për këtë, është shumë i nevojshëm përmirësimi i niveleve të transferimit, duke siguruar rrugët e këmbësorëve, objektet e parkimit të makinave dhe të biçikletave, si dhe sheshet e stacioneve. Kështu, terminalaet e tramvajit duhet të shërbejnë si stacione portë për ZQB dhe zhvillime të tilla Intermodale duhet të përfshihen në koston e projekteve të zhvillimit të tramvajit për të rritur numrin e udhëtarëve.

4.8.2 Zhvillimi i Transportit me Autobusë

Megenëse numri i automjeteve private në Tiranë është rritur me shpejtësi, përmirësimi i nivelit të shërbimeve të autobusëve është shumë i ngutshëm.

Siç u përmend më sipër, duhet të hiqet parkimi në rrugë dhe korsitë e pjesshme të përcaktuara për autobusë duhet të zgjaten më shumë e vazhdimisht në rrugët kryesore urbane për të formuar një rrjet të vijueshëm, që të shërbejnë si një ASHT. Duke mbajtur të qëndrueshme shpejtësinë e lëvizjeve të autobusëve nga trafiku i ngarkuar, orari mund të parashikohet, si pasojë e pakësimit të kohës së pritjes dhe tërheqjen e më shumë udhëtarëve. Duhet të theksohet gjithashtu se rrjeti i përcaktuar i linjave të autobusëve do të jetë tipi i tranzitit i bazuar në hekurudhë, si linjat e tramvajit nga kthimi i korsive të përcaktuara për autobusë në linja hekurudhore kur kërkesa rritet në një afat më të gjatë.

(1) Ristrukturimi i Rrugëve, që Ndjekin Autobusët

Sistemi i lartpërmendur i linjës së tramvajit duhet të zhvillohet në formën e rrjetit në mënyrë që njerëzit mund arrijnë destinacionet brenda sistemit. Kjo do të thotë që një rrugë e vetme në nivel të lartë shërbimi nuk mund të tërheqë njerëzit të përdorin transportin publik. Rrjeti i transportit publik duhet të përbëhet nga linja kryesore me shërbime ushqyese mbështetëse dhe duhet të mbulojë gjithë zonën metropolitane të Tiranës, sa më shumë të jetë e mundur. Prandaj, kur linjat e tramvajit të jenë futur si një sistem bazë i transportit publik, struktura e rrugës që ndjek autobusi duhet të riorganizohet në mënyrë hierarkike për të mbështetur linjat e tramvajit dhe përfundimisht për të rritur përdorimin e rrjetit të transportit publik.

Ndër të tjera, shërbimet e tanishme të autobusit në Tiranë, veçanërisht shërbimet e autobusëve vijëdrejtë, që lidhin zonat e rrethinave dhe qendrën e Tiranës janë në funksionim jo vetëm autobusët qytetas, por edhe autobusët rrethqytetas, që lidhin Tiranën dhe komunat përreth. Standardet e shërbimeve për këto linja të autobusëve të komunës nuk janë të rregulluara mirë. Edhe pse autobusët rrethqytetas supozohet të mos marrin udhëtarë, që udhëtojnë brenda Tiranës, ato u shërbejnë edhe udhëtarëve në Tiranë.

Në Tiranë dhe në komunat përreth shërbimi i udhëtarëve po bëhet më i ndërlikuar dhe më i vështirë. Prandaj, është e nevojshme që të rishqyrtohet dhe racionalizohet struktura ekzistuese e linjave të autobusëve, duke përfshirë mundësinë e shërbimeve me autobusë ushqyes në rrethina, si dhe mundësinë e një autoriteti menaxhimi të transportit rajonal, që të mbulojë gjithë zonën metropolitane të Tiranës dhe komunat përreth.

Nga pikëpamja e planifikimit të autobusëve rrugët mund të kategorizohen: (1) shërbimet e autobusëve vijëdrejtë, (2) shërbimet e autobusëve unazorë dhe (3) shërbimet e autobusëve ushqyes. Struktura ekzistuese e autobusëve duhet të rishikohet në bazë të kërkesës ekzistuese dhe të ardhshme të udhëtarëve, sistemit bazë të transportit publik të qytetit, si dhe mbulimin e popullsisë së zonës metropolitane të Tiranës.

Në figurën 4.8.1 është paraqitur një shembull i ristrukturimit të rrugëve, që ndjekin autobusët në të ardhmen. Linjat e reja të tipit (3) duhet t'iu shërbejnë stacioneve të tramvajit të planifikuara për të rritur koston e linjave të tramvajit, duke rritur përdorimin e sistemit bazë të transportit publik. Ndërkohë, rekomandohet që lloje të reja të linjave të autobusëve (dmth, (1) dhe (2)) të futen për të siguruar shpejtësi, shërbime të rehatshme të transportit me ndalesa të kufizuara sidomos për korridoret, që nuk janë shërbyer nga transporti hekurudhor.

(2) Sistemi i Vendndodhjes së Autobusit

Për funksionimin e ASHT pritet shërbimi me frekuencë të lartë dhe funksionimi i pandryshueshëm i autobusëve është një nga faktorët e rëndësishëm për të përmbushur kërkesën e udhëtarëve. Megjithatë, një interval i vazhdueshëm ndërmjet autobusëve nuk mund të mbahet pa një menaxhim të mirë të funksionimit të autobusëve. Pra, autobusët priren për të formuar një grup në shërbim me frekuencë të lartë. Për më tepër, në kontratën e tanishme të funksionimit të autobusëve të qytetit në bashkëpunim me operatorët privatë, edhe pse sasia dhe niveli i shërbimeve të autobusëve janë përcaktuar, Bashkia nuk mund të jetë shumë efikase në monitorimin e shërbimeve të autobusëve.

Por, futja e sistemit të vendndodhjes së autobusit do ta zgjidhë këtë çështje. Si pjesë e sistemit të vendndodhjes së autobusit, autobusët duhet të jenë të pajisur me pajisje GPS (Global Positioning Sistem), në mënyrë që agjencia rregullatore (qendra operacionale) të dijë vendndodhjen e autobusit dhe shpejtësinë e tyre në çdo vendndodhje të tyre. Sistemi ofron gjithashtu informacionin e lëvizjes së autobusëve për operatorët dhe udhëtarët.

Për udhëtarët në stacione, në bordin e autobusit sidomos me anë të internetit etj. duhet të sigurohet, informacioni i mëposhtëm:

- Informacion Statik: harta e linjave, orari, sistemi i çmimeve;
- Informacion Dinamik: vendndodhja në kohë e autobusit dhe informacioni i funksionimit.

Duhet të theksohet se sistemi i vendndodhjes në kohë reale i autobusit mund të jetë i integruar

me sistemin e planifikuar të kontrollit të sinjalistikës së trafikut, duke realizuar përparësinë e sinjalistikës së autobusit për të shmangur përplasjen me lëvizjet e automjeteve private.

(3) Përmirësimi i Sistemit të Biletës

Një problem në transportin publik, që shkurajon udhëtarët në përdorimin e tij është kostoja e përgjithshme e transfertave, si, tarifat e autobusëve, të cilat shpesh ngarkojnë negativisht udhëtarët, sidomos udhëtarët me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Ulja e kostonë së përgjithshme të transportit publik do të çojë në shtim të numrit të përdoruesve të këtij shërbimi. Një mënyrë e mundshme për uljen e kostonë është futja e një sistemi, që ul çmimin e biletës ndërmjet operatorëve të ndryshëm të autobusëve (dhe tramvajit të ardhshëm). Me zbatimin e një bilete të përbashkët (ose një kartë smart), sistemi do të përmirësojë ndjeshëm shërbimet e përdoruesit.

Fillimisht, bileta e autobusit ishte përcaktuar për të marrë parasysh të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e funksionimit të autobusëve. Familjet me të ardhura të ulëta nuk mund të përballojnë për të paguar nivel më të lartë të biletës për udhëtimet e tyre. Nëse çmimi i biletës së transportit publik rritet, ata do të vuajnë nga rritja e çmimeve dhe duhet të sakrifikojnë shpenzimet e tjera të rëndësishme. Nga ana tjetër, operatorët e autobusëve janë përballur me vështirësi në ofrimin e nivelit të mjaftueshëm të shërbimit me një çmim bilete të ulët, ndërkohë që çmimi i naftës ka qenë në rritje në tregun botëror.

Qeveria, ndonjëherë për shkak të burimeve të kufizuara financiare nuk mund të japë subvencione të mjaftueshme për të mbushur hendekun mes kostonë së funksionimit dhe të ardhurave. Prandaj, është propozuar për të siguruar subvencion për familjet me të ardhura të ulëta e jo për operatorët e transportit. Nga ana tjetër, qeveria mund të lejojë një nivel më të lartë të çmimit të biletës, e cila mundëson operatorët e autobusëve të ofrojnë shërbimet e tyre në një gjendje të mirë financiare, edhe pse metodologjia për identifikimin e transportit të “varfër” duhet të studiohet me kujdes.

Një tjetër masë e mundshme është shlyerja e shpenzimeve të transportit për punonjësit. Nëse qeveria lejon subjektet e biznesit të zbresin kompensimin e transportit nga fitimi, barra e institucionit të biznesit do të zvogëlohet. Ndikimet në të ardhurat e qeverisë si dhe përfitimet ekonomike duhet të shqyrtohen gjithashtu me kujdes.

4.8.3 Zhvillimi i Terminalit Intermodal i Transportit

Siç u përmend më lart, duhet t'i kushtohet vëmendje transferimit ndërmjet mënyrave të ndryshme të transportit intermodal, që është, ndërmjet lidhjes së linjave të autobusëve (furnizues) dhe tramvajit dhe midis mënyrave private të transportit dhe tramvajit (Sistemi Parko dhe Udhëto).

Meqë linjat e tramvajit do të shërbejnë si rrjeti kryesor i transportit publik, transferimi Intermodal në stacionet e tramvajit duhet të përmirësohet për të rritur komoditetin e transferimit për udhëtarët nga një mënyrë transporti publik në një tjetër. Për këto qëllime duhet të zbatohen këto masa:

- Përmirësimi i mjeteve të transportit për të qenë sa më miqësor me përdoruesit duke siguruar ecjen më këmbë, mjediset e parkimit për automjetet dhe biçikletat, si dhe shërbimet e tjera të transportit,

- Rritja e niveleve të transferimit, duke përmirësuar kushtet fizike, si shkurtimin e largësisë së ecjes me këmbë nga tramvaji për te një tjetër mënyrë transporti, sigurimi i informacionit për oraret dhe kushtet e funksionimit dhe sigurimin e shesheve të stacioneve,
- Krijimi i hapësirave të sigurta dhe të këndshme të pritjes për transferimin e udhëtarëve,
- Integrimi i sistemit të çmimeve, duke futur një sistem për uljen e çmimit gjatë transferimit ndërmjet tramvajit dhe autobusëve për përdorim sa më të përshtatshëm të transportit publik.

Si një mundësi për linjat e autobusëve ushqyes, për hyrjen në stacione mund të përdoret sistemi Parko dhe Udhëto. Kjo është e rëndësishme sidomos kur mungojnë shërbimet e autobusëve ushqyes për shkak të largësisë apo në zonat pak të populluara. Kjo thekson domosdoshmërinë e sigurimit të mjediseve të parkimit pranë stacioneve të tramvajit, sidomos në terminalaet e linjës së tramvajit. Stacionet e mëdha kandidate me shkallë të gjerë të mjediseve të parkimit janë: Terminali Intermodal i Transportit, Qytet Studenti, Kinostudio, Kombinat dhe Parku i Paskuqanit, siç tregohet në Figurat 4.7.7 dhe 4.8.1. Këto stacione do të shërbejnë si portë për ZQB, ku përdoruesit e automjeteve apo biçikletave mund të parkojnë automjetet e tyre dhe të marrin trenin e udhëtarëve për të shkuar në punë, apo për qëllime të tjera në qendër të qytetit.

Meqë nuk ka ende një terminal për autobusë ndërqytetas të integruar në Tiranë, është shumë i nevojshëm integrimi i autobusëve ndërqytetas dhe ndërkombëtarë dhe linjat e furgonëve në një terminal me mjediset e duhura, si: tualete, biletari, dhomat e pritjes, dyqanet, restorantet, vendqëndrimet për taksi dhe mjediset e parkimit, etj. Mendohet se do të ishte më praktike që furgonat të zëvendësohen shkallë-shkallë me autobusë të rinj, të mëdhenj, me ajër të kondicionuar. Terminali i ri Intermodal i Transportit duhet të zhvillohet në vendin ku do të vendoset stacioni hekurudhor ekzistues i Tiranës (rreth 85 000 m²), të planifikuar nga Bashkia. Të gjithë autobusët ndërqytetas dhe ndërkombëtarë dhe linjat e furgonëve për pjesën veriore, perëndimore dhe jugperëndimore duhet të integrohen në këtë terminal në mënyrë që të ndihmojnë në parandalimin e hyrjes së automjeteve të mëdha në ZQB e Tiranës. Më e rëndësishmja, terminali i ri duhet të jetë i lidhur me linjën e tramvajit dhe me disa linja të autobusëve të qytetit për transferimin në qendër të Tiranës apo në vendqëndrime të tjera.

Gjithashtu, duhet të realizohet futja e terminaleve të reja të tranzitit, ku disa linja qytetase të autobusëve, si dhe transportet e tjera publike të takohen dhe udhëtarët mund të transferohen apo të hyjnë me automjetet private. Ndër të tjera, në qendër të qytetit, mund të zhvillohet një tranzit qendror (Figura 4.8.4) në rrugët e këmbësorëve brenda korridorit të unazës së brendshme, duke lejuar vetëm këmbësorët dhe biçikletat, si dhe mjetet e transportit publik për të lëvizur më lirshëm, duke tërhequr kështu më shumë udhëtarë.

[Wellington, Zelandë e Re]



Burimi: Këshilli i Qytetit të Wellington-it

[Stamboll, Turqi]




Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 4.8.4 Shembuj të Tranzitit Qendror

4.8.4 Zhvillimi i Hekurudhës

Transporti i bazuar mbi shina ka një mundësi të madhe për shpejtësi, besueshmëri dhe transporti të këndshëm pa marrë parasysh ngarkesën e trafikut. Në përputhje me zhvendosjen e Stacionit të Tiranës në Terminalin e Transportit Intermodal të planifikuar nga Bashkia studimi propozon përmirësimin e rrjetit hekurudhor ekzistues për të tërhequr udhëtarët, të cilët sot përdorin mënyrat private të transportit për udhëtime ndërqytetase përreth Tiranës dhe që janë pothuajse të gatshëm ti lënë automjetet private. Siç është propozuar në Planin Urban Rregullues (2009), përmirësimi i linjave hekurudhore ekzistuese deri në Durrës dhe ndërtimi i linjave të reja aeroportuale (Figura 4.8.5), do të risë ndjeshëm përdorimin e transportit të udhëtarëve ndërqytetas, i cili sot ka vetëm autobusë edhe furgona.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 4.8.5 Zhvillimi i Transportit të Udhëtarëve të Hekurudhës përreth Tiranës

Stacioni ekzistues i Tiranës do të zhvendoset në një stacion të ri për funksionimin më të mirë të

transportit, të largësive të gjata dhe trenave të mallrave. Stacioni ekzistues i Tiranës do të rihvillohet si pjesë e projektit të zgjatjes së shëtitores Kryesore të Tiranës (dhe rehabilitimit të Lumit të Tiranës). Nga ana tjetër, Stacioni i ri i Tiranës do të përfshihet në Terminalin e Transportit Intermodal, i cili do të shërbejë si një portë e re multimodale, duke përfshirë shërbimet e autobusëve dhe furgonëve ndërqytetas, linjat qytetase të autobusëve dhe një linjë tramvaji, si dhe taksi e mjedise parkimi.

Por, ka ende vend për përmirësim në sistemin hekurudhor ekzistues, duke përfshirë infrastrukturën dhe objektet e saj, si: vagonët, shinat, sinjalistikën/telekomunikacionin, kalimet në nivel dhe elektrifikimin. Që të rritet kërkesa e përdoruesve të hekurudhës, është e nevojshme të ofrohen shërbime mjaft tërheqëse përsa i përket shpeshtësisë, komfortit, afimit në stacione dhe intermodaliteti me autobusë ushqyes dhe automjete private. Përmirësimi i hekurudhës ekzistuese ka një përparësi të madhe, duke u nisur që nga blerja e tokës, e cila nuk është shumë e nevojshme. Përmirësimet kryesore të nevojshme janë:

- Ngritja e pjesës së stacioneve ekzistuese të hekurudhës të Tiranës për të shmangur kalimet në nivel
- Dyfishimi i shinave dhe elektrifikimi i hekurudhës ekzistuese për shërbimet e udhëtarëve ndërmjet Durrësit dhe Tiranës
- Rritja e shpejtësisë në 120 km/orë, duke zëvendësuar ndarjen manuale të trenave me një sistem automatik dhe sistem sinjalistike, që mund të ndajë trenat me tri minuta larg me një nivel më të mirë sigurie për linjën Tiranë-Durrës. Gjithashtu, duhet të ngrihet edhe një nënstacion në Tiranë ose në Durrës për të menaxhuar të gjitha linjat;
- Ngritja e një stacioni të ri udhëtarësh në hekurudhën ekzistuese midis Tiranës dhe Vorës/Durrësit;
- Përmirësimi/zhvillimi i shesheve të stacioneve dhe përfaqja e rrugëve për të siguruar hyrje më të lehtë në stacione për të gjitha mënyrat e transportit;
- Modernizimi i stacioneve të trenit, veçanërisht stacionit të Tiranës, si pjesë e intermodalitetit, që përbëhet nga më shumë binarë dhe përmirësimi i mjediseve të stacioneve për shërbime më të mira (psh. sistemi i informacionit, gjatësia, gjerësia dhe lartësia e platformës);
- Ndërtimi i një linje hekurudhore (afërsisht 2 km) ndërmjet linjës Vorë-Shkodër dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (ANT), i cili do të funksionojë nga stacioni i Ri i Tiranës ose stacioni i Durrësit, duke përdorur linjën ekzistuese të përtërirë;
- Ndërtimi i një linje nga Vora, e cila lidh drejtpërdrejt Tiranën dhe Shkodrën (psh. ANT), për një lëvizje të vijueshme të udhëtarëve;
- Blerja e trenave të elektrifikuar me vetështytje me cilësi dhe frytshmëri të lartë (NjShE: Njësitë e Shumta të Elektrifikuara) për shërbimet e "udhëtarëve" të rregullt në linjat e reja Tiranë-Durrës dhe ANT.

Modernizimi i infrastrukturës, përmirësimi i kushteve operative, së bashku me investimet në trenat bashkëkohor, me cilësi të lartë do të përmirësojnë shërbimet e "udhëtarëve" të rregullt për/nga Tirana, veçanërisht ndërmjet Tiranës dhe Durrësit dhe Tiranës/Durrësit dhe ANT. Në këtë korridor mund të kursehet një pjesë e mirë e kohës së udhëtimit të udhëtarëve.

Përmirësimi i sistemit të përgjithshëm të transportit publik, përfshin jo vetëm përmirësimin e sistemit të bazuar në hekurudhë, por edhe duke siguruar përdorimin e tokës përreth në nxitje të përdorimit hekurudhor. Përdorimi i tokës dhe infrastruktura e transportit duhet të integrohen


sipas konceptit të Zhvillimit të Tranzitit të Orientuar (ZhTO). Nga nxitja e përdorimit tregtar të tokës me dendësi të lartë rreth stacioneve do të përfitojnë si ekonomia urbane ashtu dhe ajo e biznesit të operatorit hekurudhor.

4.9 Sistemi i Transportit të Mallrave

4.9.1 Rrugët Kryesore që Ndjekin Kamionët

Ashtu si rrugët kryesore me një kapacitet të lartë, rrugët kryesore urbane janë përdorur nga shumë automjete, që udhëtojnë rregullisht. Kjo, sepse rrugët kryesore urbane lidhin zonat kryesore industriale dhe zonat e magazinave në Tiranë si Kombinati, Qyteti i Nxënësve, Ish-Frigoriferi, dhe Rruga “5 Maji” nëpërmjet rrugëve ndërqytetëse për në Portin e Durrësit dhe qytete të tjera të mëdha në Shqipëri, ato shërbejnë edhe si një korridor transporti mallrash.

Për kamionët e mallrave, pasi Unaza e Jashtme nuk ka përfunduar ende, nuk ka asnjë rrugë tjetër, por të kalojnë nëpër Tiranë. Edhe pse kamionët (duke përjashtuar automjetet me kapacitet 3,5 tonë ose më pak) janë të ndaluar të hyjnë në ZQB brenda Unazës së Mesme, përveç gjatë natës, rezultatet e hyrjes së tyre në ZQB në trafikun e madh, të përzier me shumë automjete të ngadalta e të rënda në rrugët kryesore urbane ekzistuese, siç tregohet nga rezultatet e vërtetimit të transportit në Figurën 4.9.1. Një barrë e tillë në rrugët ekzistuese kryesore urbane duhet të lehtësohet duke siguruar rrugët alternative për kamionët dhe automjetet e udhëtarëve.




Burimi: Vërtetimi i Transportit 2011, Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 4.9.1 Përbërja e Trafikut të Automjeteve në Rrugët Urbane Kryesore në Tiranë


Edhe pse Unaza e Mesme e tanishme shërben si një korridor mallrash për të anashkaluar ZQB e Tiranës, nuk ka një korridor të përcaktuar të transportit të mallrave në rrjetin rrugor ekzistues të Tiranës. Ndërkohë, përbërja e trafikut në Figurën 4.9.1, vëllimi i kamionëve në Figurën 4.9.2, dhe gjenerimi i udhëtimit me kamion në Figurën 4.9.3 tregojnë që OD-et e udhëtimeve me kamion në/nga Jashtë Tiranës përqendrohen më së shumti në ZAT në perëndim të Tiranës të

tilla, si: Kombinati, Qyteti i Nxënësve, Kamza, Lapraka dhe përgjatë autostradës së Durrësit. Kështu, kamionët zakonisht kalojnë nëpër pjesën perëndimore të rrjetit rrugor kryesor, i cili është përdorur edhe nga shumë automjete që lëvizin rregullisht. Ky ndikon ndjeshëm në rrjedhën e trafikut, sepse kamionët që lëvizin ngadalë zënë hapësirë të madhe në rrugë.



Burimi: Vrojtimi i Transportit 2011, Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 4.9.2 Vëllimi i Kamionëve në/nga Tirana dhe Kamionët që Kalojnë nëpër Tiranë




Burimi: Vrojtimi i Transportit 2011, Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 4.9.3 Gjenerimi i Udhëtimeve të Kamionëve në/nga Jashtë Tiranës sipas ZAT

4.9.2 Plani i Shpërndarjes së Mallrave në të Ardhmen

Për të siguruar shpërndarjen e mallrave dhe trafikun e kamionëve, në Tiranë janë propozuar rrugët e kamionëve në të ardhmen duke patur parasysh zonat industriale ekzistuese dhe ato të planifikuara si dhe zhvillimet e rrugëve, siç shihet në Figura 4.9.4. Vëllimet e ardhshme të autoveturave dhe të kamionëve, që do të kalojnë në kufijtë kryesorë të zonës metropolitane të Tiranës janë parashikuar dhe treguar në figurë edhe për vitin 2027. Ndërsa Bypass-i i Tiranës është planifikuar jashtë zonës së studimit në PKShT 2. Këto vëllime të trafikut përputhen me ato të parashikuara në PKShT 2.


Rrjeti rrugor i ardhshëm i kamionëve, bazohet në rrugët kryesore dhe do të shërbejë edhe pranë zonave industriale. Gjithashtu, ai do të ofrojë një rrugë alternative për kamionë, e cila do të kalojë rreth qendrës së Tiranës dhe ky rrjet do të parandalojë përzierjen e rrugëve për mallrat me rrugët për automjetet e tjera.



Shënim: Vëllimet janë parashikuar për një orë të pikut të mëngjesit në 2027.
Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 4.9.4 Plani i Shpërndarjes së Mallrave në të Ardhmen në Tiranë

Duhet të theksohet që unaza e jashtme do të shërbejë jo vetëm për ndërmarrjet industriale, por edhe për transportin e mallrave ndërmjet Durrësit dhe Elbasanit. Meqë vëllimi i mallrave është i vogël, në një të ardhme të afërt, pritet të ketë shumë më shumë kamionë, që transportojnë ndërmjet Durrësit dhe Elbasanit në drejtim të Korridorit VIII të Transportit Pan-Evropian (Figura 4.9.5), në një rrugë më të shpejtë nëpërmjet Tiranës, pasi të përfundojë rruga e re ndërqytetëse/tuneli për në Elbasan.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s, bazuar në Sekretariatin e Korridorit VIII Pan-Evropian

Figura 4.9.5 Korridori i Transportit Pan-Evropian në Rajonin e Ballkanit

Kështu, pasi unaza e jashtme të ketë përfunduar, është më mirë të zgjerohet zona e tanishme, që ndalon hyrjen e kamionëve (duke përjashtuar automjetet me një kapacitet prej 3,5 tonë ose më pak) brenda korridorit të unazës mesme në zonën brenda korridorit të unazës së jashtme, duke përcaktuar unazën e jashtme si rrugën ku do të kalojnë mallrat. Ditën, ajo mund të shërbejë për kamionë të vegjël të dërguar nga një "qendër metropolitane logjistike", që është përshkruar më poshtë. Edhe në qoftë se kamionët e vegjël lejohen të hyjnë në zonën e ndaluar për kamionët, gjatë ditës, pakësimi i këtyre mjeteve të shpërndarjes duhet të arrihet duke siguruar/ofruar pika shpërndarjeje të mirave materiale buzë rruge ose jo.

Për më tepër, në Tiranë duhet të zhvillohet një terminal për kamionë, si një "qendër metropolitane logjistike" për shpërndarjen e mallrave, diku përgjatë rrugëve kryesore, sidomos në korridorin për transportin e mallrave (Durrës-Elbasan). Meqë zhvillimi i një terminali të transportit intermodal së bashku me zhvendosjen e stacionit të trenit të Tiranës tashmë është planifikuar nga Bashkia me një tokë me sipërfaqe afërsisht 85 000 m², ai mund të integrohet me infrastrukturën e hekurudhës dhe të zhvillohet në këtë vend.

Stacioni i Ri i Tiranës duhet të ndërtohet si një terminal për kontejnerë, pasi ajo ka hapësirë të mjaftueshme. Në këtë projekt, stacioni i Ri i Tiranës gjithashtu duhet të jetë i pajisur me objektet për trajtimin e mallrave. Të gjithë kontejnerët e caktuar për t'u transportuar në Portin e Durrësit apo vende të tjera në Shqipëri nëpërmjet hekurudhës duhet të vijnë në këtë terminal me kamionë dhe pastaj të përgatiten udhëtime të gjata, duke përdorur pajisjet e kontejnerëve, si paleta ose vinça të tipit Flamur. Kjo hapësirë duhet të jetë e mjaftueshme për të organizuar trenat e projektuar për mallra për të mbajtur kontejnerë me gjatësi 12,2 m.

4.10 Rregullimet Organizative dhe Institucionale

4.10.1 Krijimi i një Autoriteti Transporti

Ngritja e një agjencie të re, si autoriteti i transportit, këshillohet të bëhet në përputhje me një plan për zhvillimin e sistemit të gjerë të transportit metropolitan. Nëse nevojitet kohë për të ngritur një agjenci të tillë, duhet të krijohet një komision planifikimi për të përcaktuar detyrat në një kohë të shkurtër. Studimi, e rekomandon ngritjen e këtij autoriteti transporti për zonën metropolitane të Tiranës në kohë të shkurtër për të vijuar me hapin tjetër, që është ngritja e një autoriteti për zhvillimin urban.

(1) Komisioni i Planifikimit të Transportit në Tiranë

Komisioni i Planifikimit të Transportit në Tiranë duhet të ngrihet nën drejtimin e ministrive qendrore, i përbërë me personel të qeverive vendore, që lidhen me sektorin e transportit, duke përfshirë Bashkinë e Tiranës. Ky organ ekzekutiv duhet të ketë: kryetarët e qeverive përkatëse vendore si dhe përfaqësues nga ministrinë, si Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit. Funksionet e tij kryesore janë:

- Të koordinojë planifikimin e transportit përkatës dhe studimet në qeveritë vendore në një plan transporti metropolitan të integruar;
- Të kryejë hulumtime dhe vrojtime, ndër të tjera, një vërtetim gjithëpërfshirës në familje, që do të mbledhë informacion të të gjitha udhëtimeve në një ditë jave në zonën metropolitane në Tiranë, për planifikimin e transportit;
- Të rishikojë dhe përditësojë planin e transportit metropolitan të integruar, duke përfshirë në këtë Studim edhe menaxhimin e të dhënave, si dhe metodologjinë e planifikimit të fituar nga ky Studim.

Për të mbështetur komisionin dhe për të kryer detyrat e përditshme, duhet të ketë një sekretariat të përhershëm me ekspertë teknikë. Financimi për komisionin dhe personelin do të jetë nga kontributi i anëtarëve të komisionit.

(2) Autoriteti Metropolitan i Transportit në Tiranë

Autoriteti Metropolitan i Transportit në Tiranë është themeluar si një korporatë publike e pavarur, e cila ka përgjegjësinë kryesore publike dhe jo vetëm për qeveritë qendrore ose vendore. Autoriteti do të miratohet me ligj nga qeveria si një korporatë e pavarur publike. Ai mbikëqyr të gjitha çështjet e transportit tokësor dhe ka përgjegjësi kryesore:

- Harton politikat e transportit metropolitan,
- Harton planifikimin gjithëpërfshirës të transportit, duke përfshirë zhvillimin e rrjetit rrugor, zhvillimin e transportit publik, MKT-të dhe menaxhimin e sistemit të transportit urban,
- Zbaton planifikimin e transportit të integruar dhe programet, veçanërisht për të realizuar rristurimin e linjave të autobusëve për zonën metropolitane të Tiranës.
- Jep lejet dhe kontrollon transportin publik për lejet e lëvizjes së autobusëve, lejet e bizneseve të transportit publik, lejet e zhvillimit të stacioneve dhe terminaleve etj.,
- Rregullon shërbimet e transportit publik, si: tramvaj, autobusë, etj.,
- Mbështet zhvillimin e rrjetit rrugor ndërqytetës,
- Kryen MKT (Menaxhimi i Kërkesës së Transportit), si për shembull çmimin e parkimit.

Autoriteti do të funksionojë nga të ardhurat e biznesit të transportit, si tarifat e transportit publik dhe tarifat e parkimit ose subvencionit nga qeveritë qendrore dhe vendore. Si korporatë e pavarur, detyra e tij parësore është të jetë e pavarur financiarisht sepse dhënia e statusit financiar është një nga aspektet më të rëndësishme për të siguruar pozicionin e saj si korporatë publike, që ofron shërbime publike për përdoruesit në zonën metropolitane në Tiranë. Si korporatë publike, ajo gjithashtu mund të rrisë fondin nga tregu i kapitalit me lëshimin e bonove të korporatave.

(3) Bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve të Transportit Publik

Krijimi i një autoriteti të tillë për transportin metropolitane mund të jetë i vështirë për arsye të ndryshme. Megjithatë, shembujt, të cilët janë zbatuar shpesh në qytetet e Gjermanisë mund të jenë të dobishëm për koordinimin e linjave të ndryshme të autobusëve qytetas dhe rrethqytetas për zonën metropolitane të Tiranës dhe për një sistem të integruar tarifimi. Në Tabelën 4.10.1 janë paraqitur shembuj të bashkëpunimit ndërmjet operatorëve të transportit publik në rajonet metropolitane në Gjermani.

Shembuj të transportit të federatës (*Verkehrsverbund*), që janë më të theksuar në shkallën e bashkëpunimit, janë vërejtur në Hamburg, Berlin, etj. Kjo është një formë e autoritetit të transportit, që përqendrohet vetëm në bashkëpunim për ecurinë e transportit publik dhe planifikimin e tij. Kjo formë synon realizimin e sistemeve gjithëpërfshirëse të transportit publik për të tërhequr qytetarët, duke formuar një aleancë ndërmjet operatorëve të transportit. Detyra e saj kryesore është që të bashkëpunojë për planifikimin e rrugëve, sistemit të përbashkët të biletave, planifikimin e orarit, nivelin e shërbimit, marketing, financimin, etj., bazuar në nevojat e qytetarëve. Kështu, një numër i çështjeve të transportit publik do të zgjidhet bazuar në mirëkuptimin e palëve të interesuara, duke përfshirë edhe qytetarët.

Tabela 4.10.1 Shembuj të Bashkëpunimit ndërmjet Operatorëve të Transportit Publik në Gjermani

Shkalla e Bashkëpunimit I fortë I dobët	Tipi i Bashkëpunimit	Tarifa e Përbashkët	Planifikim i Linjave të Autobusëve	Orari i Planifikimit	Vërejtje
	Federata e Transportit	Po	Po	Po	Organ ligjërish i pavarur nga të ardhurat
	Aleanca e Transportit	Po	Po	Po	Menaxhues nga operatorët e transportit
	Aleanca e Tarifës	Po	Jo	Bashkëpunim	Ndarja e të ardhurave bazuar në marrëveshjen e mëparshme
	Bashkëpunim i Pjesshëm	Jo	Jo	Bashkëpunim	Bashkëpunime të ndryshme meqë rritet nevoja

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s, bazuar në (Knieps, 2009) dhe (Krause, 2009)

(4) Sipërmarrjet nga Autoriteti i Transportit

1) Zhvillimi i Transportit Publik

Linjat e tramvajit priten të jenë një çelës për sistemin e transportit publik në zonën metropolitane të Tiranës dhe përkrahësi kryesor do të merret po nga jashtë qytetit të Tiranës. Për më tepër, linjat ekzistuese qytetase të autobusëve janë propozuar të ristrukturohen dhe të integrohen me linjat e autobusëve rrethqytetas, duke u zgjeruar përtej kufijve të Tiranës.

Duke pasur parasysh këto rrethana, ndërtimi i infrastrukturës do të marrë kujdesin e Autoritetit Metropolitan të Transportit të Tiranës dhe një ndërmarrje e re publike ose private do të ndërmarrë funksionimin dhe menaxhimin e linjave të tramvajit. Autoriteti i Transportit do të ndajë koston për zhvillimin e infrastrukturës së linjave të tramvajit, ndërsa kostoja për vagonët, funksionimin dhe mirëmbajtjen janë shpenzime për ndërmarrjen.

2) Zhvilli i Rrugëve

Zakonisht, ndërtimi/ rindërtimi i rrugëve urbane dhe zhvillimi i objekteve të tjera të lidhura të tilla, si korsitë e përcaktuara për autobusë dhe korsitë e biçikletave do të zbatohen nën përgjegjësinë e qeverive vendore. Kështu, zbatimi i me përpikmëri i projektit përtej kufirit të administratës është i nevojshëm. Prandaj, Autoriteti i Transportit do të ndërmarrë menaxhimin e zhvillimit për vijueshmërinë e ndërtimit/rindërtimit të rrugëve kryesore, në të cilin DeK e korsive të autobusëve dhe korsitë e biçikletave zakonisht duhet të rezervohen. Puna e mirëmbajtjes së rrugëve do të ndërmerret nga pushteti vendor, edhe pse shpenzimet e nevojshme për korsitë e autobusëve dhe biçikletave ndahen nga Autoriteti i Transportit.

3) MKT (Çmimi i Parkimit)

Politikat e menaxhimit të kërkesës së transportit, si: çmimi i parkimit do të zbatohet për automjetet, që sot shkojnë në ZQB e Tiranës. Megjithatë, një numër i ndjeshëm i automjeteve vijnë nga jashtë qytetit të Tiranës. Në këtë kontekst, zbatimi dhe menaxhimi i politikave MKT duhet të ndërmerren nga Autoriteti i Transportit, duke përfshirë studimet e përgatitjes.

4.10.2 Përfshirja e Sektorit Privat në Zhvillimin e Transportit

Misioni dhe veprimtaria e Hekurudhës Shqiptare (HSH: Hekurudha Shqiptare), një kompani shtetërore hekurudhore, duhet të racionalizohen. Veçanërisht, nëse zhvillimi hekurudhor i udhëtarëve të lartpërmendur hekurudhor do të zbatohet, duhet të krijohet një ndërmarrje e pavarur për zbatimin e tij. Ndonëse privatizimi mbetet ende për t'u diskutuar, racionalizimi dhe suksesi i biznesit hekurudhor janë kushtet për pjesëmarrjen e sektorit privat.

Për më tepër, rregulloret për investimet private në sektorin e transportit duhet të rishikohen dhe të ndryshohen për të siguruar një mjedis të shëndoshë për investimet në sektorin privat të biznesit të transportit. Kjo gjithashtu, përfshin sigurimin e të drejtave të zhvillimit për investitorët privatë në zonën përreth hekurudhës dhe/ose stacioneve të tramvajit, duke mundësuar përvetësimin e njohurive për të mirat e zhvillimit të sistemit të transportit. Kjo mund të lehtësojë barrën financiare të investitorëve dhe mund të nxisë biznesin e transportit me qëllim tejkalimin e problemeve financiare. Kjo, sigurisht duhet të bëhet në një mënyrë të mirëplanifikuar dhe të kontrolluar në përputhje me planin e përdorimit të tokës. Roli dhe përgjegjësia për ndarjen e sistemit ndërmjet sektorëve publikë dhe privatë duhet të përcaktohet qartë.

4.11 Lista e Planveprimeve/Projekteve Parësore

Edhe pse kriteri më i rëndësishëm është fizibiliteti ekonomik i investimit, kjo nuk është detyrë e lehtë për të vlerësuar ekonomikisht të gjitha projektet në nënsektorë të ndryshëm. Kështu, projektet janë vlerësuar nga masa sasiore dhe cilësore, përmes shumë analizave e kriterëve. Në Tabelën 4.11.1 janë paraqitur kriteret e vlerësimit.

Tabela 4.11.1 Kriteret e Vlerësimit

Kriteret e Vlerësimit	Shënim
Koherenca me Vizionet	Edhe pse të gjitha projektet e propozuara duhet të jenë të përshtatshme me vizionet dhe objektivat e planifikimit për zhvillimin e Tiranës duhet tu jepet përparësi, projekteve strategjike të hartuara nga Bashkia për të arritur vizionet.
Të ngutshme	Projektet, të cilat pritet që të ndihmojnë në zgjidhjen e çështjeve të ngutshme të transportit duhet t'u jepet përparësi.
Nevojë	Të gjitha projektet e propozuara janë të bazuara në nevojat e qytetarëve. Megjithatë, projektet që më së shumti u përgjigjen nevojave të njerëzve mund të prioritetizohen. Si ndërmjetës për popullsinë përfituese, mund të përdoret kërkesa e ardhshme për transport për çdo projekt.
Fizibiliteti i nënkuptuar	Fizibiliteti shoqëror-ekonomik, teknik, dhe institucional duhet marrë parasysh për përparësitë, sepse këta faktorë lidhen ngushtë me zbatimin dhe qëndrueshmërinë e një projekti. Ky kriter nuk është domosdoshmërisht i prekshëm, por i nënkuptuar. Për rrugët, projektet, që pritet të lehtësojnë ndjeshëm trafikun e populluar të pranishëm/të ardhshëm mund ti jepet përparësi.
Pranimi Shoqëror	Projektet, të cilat janë pranuar nga të gjithë banorët mund të prioritetizohen. Megjithatë, ka disa projekte, që janë shumë të nevojshme për shoqërinë, por jo të mirëpritur nga qytetarët, për shembull, rristrukturimi i tarifës për shërbimet publike siç janë udhëtimi me autobus. Një përparësi quhet e drejtpeshuar ndërmjet dy anëve të nevojave. Planeve, që janë njohur gjerësisht në Planin Rregullues të 1989 iu është dhënë përparësi.

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Çdo projekt është vlerësuar me një metodë, duke u referuar pesë kriterëve, që tregohen në Tabelën 4.11.2. Projektet me kriteret respektive janë shënuar si ‘+’ dhe duke pasur parasysh një pikë. Kështu, është llogaritur rezultati i përgjithshëm i secilit projekt. Në këtë fazë nuk është zbatuar sistemi i pikës së ponderuar. Në thelb, projektet e zhvillimit të rrugëve me tri pikë ose më shumë dhe projekte të tjera me dy pika ose më shumë kanë përparësi si projekte afatshkurtra.

Kështu, faza e projekteve është bërë në bazë të pikëve të paraqitura në shtyllat në anën e djathtë të Tabelës 4.11.2. Afatet e zhvillimit (afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë) tregojnë periudhën e fillimit të projekteve. Projektet parësore të ardhshme dhe planet e veprimit në sektorin e rrugëve dhe transportit urban janë të shënuara edhe si projekte afatshkurtra. Për më tepër, duke pasur parasysh koston, periudhën e nevojshme të punës, radhën e projekteve, kohën e zbatimit të projekteve janë studiuar dhe paraqiten në Tabelën 4.11.3.

Tabela 4.11.2 Vlerësimi i Pikëzuar i Përparësive për Projektet e Propozuara

Proposed Projects		Coherence with Visions	Urgency	Necessity (Future Demand*)	Implicit Feasibility	Social Acceptance	Total score	Project Schedule		
								Short	Medium	Long
RUT-1	Road Development Plan									
	RUT-1-1 Northern Extension of the Main Boulevard									
	RUT-1-1-1 Northern Extension of the Main Boulevard - Part 1	+	Ongoing	+	6,100	+	0.59	3	●	
	RUT-1-1-2 Northern Extension of the Main Boulevard - Part 2	+	Strategic		900		0.09	1		●
	RUT-1-2 Development of Outer Ring Road									
	RUT-1-2-1 Development of Outer Ring Road - South Section	+	Ongoing	+	2,500		0.25	3	●	
	RUT-1-2-2 Development of Outer Ring Road - North Section (with River Access Road)	+	Strategic	+	6,200	+	0.60	4	●	
	RUT-1-2-3 Development of Outer Ring Road - East Section			+	1,100		0.11	1		●
	RUT-1-3 Development of Inner/Middle Ring Roads									
	RUT-1-3-1 Development of Inner Ring Road			+	18,100		1.31	3	●	
	RUT-1-3-2 Development of Intermediate Ring Road				4,000	+	0.89	2		●
	RUT-1-3-3 Development of Middle Ring Road			+	3,300		0.65	3	●	
	RUT-1-4 Development of Radial Roads									
	RUT-1-4-1 Development of Radial Road: Dibra Road	+	Strategic	+	3,400		0.49	4	●	
	RUT-1-4-2 Development of Radial Road: Hoxha Tahsim & Xhanfize Keko Road			+	4,500	+	0.66	4	●	
	RUT-1-4-3 Development of Radial Road: Komuna e Parisit & Medar Shtylla Road			+	2,100	+	0.31	4	●	
	RUT-1-4-4 Development of Radial Road: Aleksander Moisiu Road	+	Strategic	+	3,100		0.46	4	●	
	RUT-1-4-5 Development of Radial Road: Ali Shetfeti Road				3,200		0.76	2		●
	RUT-1-4-6 Development of Radial Road: Myslym Keta Road				1,900	+	0.33	2		●
	RUT-1-4-7 Development of Radial Road: Kavaja Road	+	Strategic	+	12,700		1.42	4	●	
	RUT-1-5 Development of Other Secondary Roads									
	RUT-1-5-1 Development of Secondary Roads: CBD Area				1,200	+	0.52	2		●
	RUT-1-5-2 Development of Secondary Roads: Northern Area			+	3,000	+	0.71	3	●	
	RUT-1-5-3 Development of Secondary Roads: Eastern Area			+	2,700		0.63	1		●
	RUT-1-5-4 Development of Secondary Roads: Southeastern Area			+	2,100		0.47	1		●
	RUT-1-5-5 Development of Secondary Roads: Southwestern Area			+	2,000		0.54	2		●
	RUT-1-5-6 Development of Secondary Roads: Western Area			+	4,100		0.91	2		●
	RUT-1-5-7 Development of Secondary Roads: Outer Western Area			+	3,300		0.73	2		●
	RUT-1-5-8 Development of Secondary Roads: Northeastern Area				700		0.22	0		●
	RUT-1-6 Improvement of Bottleneck Intersections									
	RUT-1-6-1 Improvement of Bottleneck Intersection: Dibra Road			+	4,000	+	1.18	4	●	
	RUT-1-6-2 Improvement of Bottleneck Intersection: Hoxha Tahsim Road			+	3,000	+	0.88	4	●	
	RUT-1-6-3 Improvement of Bottleneck Intersection: Elbasan Bridge			+	5,400	+	1.04	4	●	
Bashkia e Tiranës ka nisur demonstrimin e ndarjes së mbetjeve të riciklueshme në godinën e bashkisë së qytetit. Tre kosha për rikuperimin e materialeve, si: plastika, alumini, dhe mbetje të tjera janë vendosur brenda hyrjes së bar-kafesë së bashkisë së qytetit. Veç kësaj, projekti pilot i sistemit me tre kosha po parashikohet për t’u zbatuar në Sheshin Skënderbej dhe parqet pranë tij.

Grumbulluesit e mbetjeve rikuperojnë mbetjet e riciklueshme nga kontejnerët e mbetjeve në qytet. Ata grumbullojnë sasi të vogla materialeve të riciklueshme, si kanoçe alumini, kanoçe hekuri, plastikë e fortë, rroba, sende të tjera të riciklueshme dhe i shesin ato në stacionet e përcaktuara nga tregtarët dhe/ose kompanitë e riciklimit. Nuk është kryer ende një vërtetim i

plotë i grumbulluesve të mbetjeve dhe aktiviteteve të tyre, si pasojë mungon informacioni për numrin e saktë të grumbulluesve të mbetjeve, sasi të rikuperuara, dhe të ardhurat.

Ndërmarrja e Menaxhimit të landfillit në varësi të BT-së vlerëson rreth 200 grumbullues mbetjesh që rikuperojnë materiale të riciklueshme në venddepozitimin e Sharrës. Përafërsisht, 60 deri në 70 grumbullues mbetjesh vërehen të veprojnë rregullisht ditën dhe numri i tyre rritet me 100 grumbullues nga mesnata deri në agim, periudhë e shërbimit të pastrimit në qytet. Aktivitetet e tyre nuk janë në grup, por individuale ose familjare. Ata grumbullojnë kryesisht: plastikë, letër, metale dhe qelq. Në Sharrë ka 4 (katër) stacione të ngritura nga blerësit dhe grumbulluesit e mbetjeve, që shesin materialet e rikuperuara në disa pika. Çmimi i blerjes së materialeve të rikuperueshme nga blerësit janë 16 lekë/kg për plastikën e përzierë, 70-80 lekë/kg për aluminin dhe 30 lekë/kg për hekurin.

Informacioni tjetër nga vërtetimi i një OJQ-je², siguroi çmimet e shitjeve të materialeve të rikuperueshme nga Sharra, që tregohen në Tabelën 5.1.10. Informacioni për çmimin e shitjes për artikull është pothuaj njësoj me atë të siguruar nga personeli i Ndërmarrjes së Menaxhimit të Mbetjeve, përveç çmimit të hekurit. Çmimi i shitjes së hekurit në 2010 ishte 15 lekë/kg, por hekuri skrap sot shitet me 30 lekë/kg.

Tabela 5.1.10 Çmimi i Shitjes së Materialeve të Riciklueshme në Venddepozitimin e Mbetjeve Sharrë (2010)

Nr.	Kategoria/Artikull	Çmimi i shitjes (lekë/kg)
1.	Plastika	14
2	Shishe Plastike	18
3.	Qelqi	5 – 25
4.	Karton	3
5.	Bateritë	30
6.	Plumb	30
7.	Bakër	400
8.	Bronzi	100
9.	Hekur	15
10.	Kanoçe Alumini	60
11.	Materiale të tjera Alumini	75

Burimi: Raporti Studimor i Situatës së Romëve, Që Jetojnë dhe Punojnë në Venddepozitimin e Mbetjeve, Sharrë - 2010

Të njëjtat grupe pune të OJQ-së kryen vërtetimin e sasisë së grumbulluar të materialeve të riciklueshme nga 30 grumbullues materialeve në Venddepozitimin e mbetjeve në Sharrë. U intervistuan 39 grumbullues mbetjesh të moshave nga 7 deri në 67 vjeç (me një moshë mesatare prej 32 vjeç), që punojnë 8 orë ditën ose natën. Siç tregohet në Tabelën 5.1.11, ata grumbullojnë 10,3 tonë në ditë ose 265 kg në ditë për person. Duke supozuar një numër prej 160 grumbulluesish, 60 persona ditën dhe 100 persona natën, sasia e materialeve të riciklueshme të rikuperuara në Sharrë kap vlerën 42 tonë në ditë dhe përqindja e rikuperimit të materialeve të riciklueshme në Sharrë do të jetë në 6-7% të sasisë së vlerësuar të mbetjeve të ardhura në fushë prej 622 tonë në ditë, për Shtatorin 2011.

² Raporti Studimor i Situatës së Romëve, që Jetojnë dhe Punojnë në Venddepozitimin e Mbetjeve, Sharrë, financuar nga Kooperacioni Italian dhe zbatuar nga Independent Forum of Albanian Women, World Children Foundation, ARSIS, dhe Shoqata për Mbështetje Sociale të Rinisë

Tabela 5.1.11 Përmbledhja e Sasisë së Materialeve të Riciklueshme në Sharrë (2010)

Emërtim	Plastikë	Metale	Letra	Qelqi	Dru	Gjithsej/M
Nr. i Grumbulluesve të mbetjeve	30	29	1	20	3	39
Sasia e Grumbulluar: Shuma (kg)	8,285	480	1,000	569	3	10,337
Sasia e Grumbulluar për Person (kg)	276	17	1,000	28	1	265

Burimi: Raporti Studimor i Situatës së Romëve, Që Jetojnë dhe Punojnë në Venddepozitim të Mbetjeve, Sharrë - 2010

Një nga blerësit në Tiranë, G-P-R Albania shpk, ka ngritur stacione blerjeje në Venddepozitim të mbetjeve në Sharrë për të blerë plastikë të përzier të rikuperuar nga grumbulluesit e mbetjeve. Sasia e plastikës që blerësi arrin të siguroj arrin rreth 480 tonë në muaj ose 16 tonë në ditë, siç tregohet edhe në informacionin bazë të biznesit, që vijon.

- Kapaciteti i përpunimit : 1,5 – 2,0 tonë/orë i materialeve prej Flex
- Lloji i të riciklueshmeve : Plastika e Përzierë (PET, HDPE, dhe PP)
- Pika grumbullimit : 2 pika (Sharra dhe Selite)
- Punonjësit : 40 punonjës për ndarjen dytësore të plastikës dhe përpunimin
- Sasia e plastikës që eksportohet: PET: 180 tonë/muaj, HDPE : 120 tonë/muaj, PP : 180 tonë/muaj
- Shtetet ku Eksportohet : Kinë, Austri, Gjermani, Itali
- Të tjera : Do të shtohet dhe një linjë e re përpunimi, në dy deri në tre muajt e ardhshëm. Plastika e riciklueshme nuk është e mjaftueshme për të mundësuar zgjerimin e biznesit dhe blerësi do të përpiqet të importoj plastikë nga vendet e rajonit dhe India

3) Ripërdorimi

Ripërdoren shishet e birrës, përveç shisheve të importuara. Edhe shishet e verës rikuperohen dhe ripërdoren nga njerëzit për aktivitete familjare të prodhimit të verës. Rroba të dorës së dytë, të përdorura, orendi shtëpiake, etj., shiten në rrugë ose shitore në zonat e rrethinave të qytetit.

4) Riciklimi

Një grup ricikluesish kanë ngritur Shoqatën Shqiptare të Ricikluesve (ARA). Janë regjistruar rreth tridhjetë e katër (34) kompani riciklimi sipas kategorive të shpjeguara në tabelën e mëposhtme. Midis anëtarëve të ARA-s, vetëm nëntë (9) kompani kanë biznes aktiv, ndërkohë që 3 kompani janë mbyllur ose kanë pezulluar aktivitetin.

Tabela 5.1.12 Numri i Ricikluesve të Riregjistruar

Kategoritë	Nr.	Statusi i Aktivitetit	
		Aktive	Mbyllur ose Joaktiv
Letra	3	2	-
Plastika	13	4	2
Alumini	4	-	-
Hekuri	11	2	-
Tulla	1	-	-
Dru	1	-	1
Tekstile	1	1	-
Shuma	34	9	3

Burimi: Ekipi Studimor i JICA

Një nga ricikluesit më të mëdhenj, në Durrës, Edipack shpk, ka filluar punën në 2003 për kartonin, dhe e zgjeroi atë me përpunimin e letrës në 2009. Kapaciteti i përpunimit të impiantit është 70 tonë/ditë, por sasia e letrës së vlershme është mesatarisht vetëm 10-15 tonë në ditë, kështu që ricikluesi importon pjesën e mbetur nga vendet fqinje.


(3) Trajtimi i Ndërmjetëm

Trajtimi i ndërmjetëm i mbetjeve bashkiake nuk është kryer deri më tani, në Bashkinë e Tiranës. Direktiva e Landfillit 1999/31/EC detyron Vendet Anëtare të ulin sasinë e mbetjeve të biodegradueshme për landfill në 35 % deri në 2016. Plani i Menaxhimit të Zonës së Mbetjeve të Tiranës propozon që të gjitha bashkitë dhe komunat të zbatojnë kompostimin e mbetjeve të biodegradueshme deri në fund të vitit 2012. Sipas kësaj, BT duhet të përgatisë menjëherë planet e zbatimit për kompostimin e mbetjeve të biodegradueshme, sipas planeve kombëtare dhe detyrimeve të Ligjit.

(4) Depozitimi Përfundimtar

1) Vendndodhja e Venddepozitimit të Mbetjeve Sharrë

Venddepozitimi i mbetjeve, Sharrë ndodhet në Komunën e Sharrës, në Jugperëndim të Bashkisë së Tiranës. Largësia nga qendra e Tiranës është rreth 7 km dhe koha për të mbërritur me makinë është rreth 20 minuta. Vendndodhja është ideale në lidhje me largësinë nga qendra e qytetit. Figura 5.1.6 tregon vendndodhjen e Sharrës në referencë me vendndodhjet e zonave të grumbullimit të mbetjeve me një rreze prej 5 km dhe 10 km nga venddepozitimi i mbetjeve. Siç mund të kuptohet lehtësisht, zonat e grumbullimit të mbetjeve P-2 dhe P-3 mbulohen brenda rrezes prej 5 km dhe pjesa e mbetur e zonave të grumbullimit të mbetjeve mbulohet brenda rrezes prej 10 km.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA

Figura 5.1.6 Zonat e Grumbullimit të Mbetjeve dhe Rrezja prej 5km dhe 10km nga Venddepozitimi i Mbetjeve Sharrë


2) Puna për Depozitimin e Mbetjeve

Përpara viteve '90 landfilli është përdorur kryesisht për depozitimin e mbetjeve industriale. Ndërmarrja e Menaxhimit të Mbetjeve, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Qytetit, e ngritur në 1994 ka marrë përgjegjësinë e punës të landfillit. Gjithsesi, funksionimi i landfillit është kryer në mënyrë të pakontrolluar dhe djegiet spontane të mbetjeve kanë ndodhur deri në shtator të 2008 kur u bë mbyllja e venddepozitimit të vjetër dhe zgjerimi i landfillit me teknologji moderne. Figura 5.1.7 tregon ndryshimet e Venddepozitimit të mbetjeve nga 2003 deri në 2011. Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Qytetit, sot kryen menaxhimin e funksionimit të Sharrës. Kjo drejtori ka 34 punonjës duke përfshirë edhe Drejtorin. Siç tregohet në Figurën 5.1.8, në këtë Drejtori ka dy Sektorë, që merren me funksionimin dhe menaxhimin e landfillit, dhe japin mbështetje për mirëmbajtjen mekanike të mjeteve, makinerive dhe pajisjeve, që veprojnë në landfill. Vendi i tanishëm i landfillit, ka një sipërfaqe prej rreth 22,5 ha dhe ndodhet në një territor shtesë pranë landfillit të vjetër që është mbyllur në mënyrë të sigurtë. Projekti është financuar nga një kredi prej 6 milionë Eurosh, dhënë nga Kooperacioni Italian. Ky projekt përfshin gjithashtu prokurimin e makinerive, pajisjeve, trajnimin për ngritje kapacitetesh, etj.



Burimi: Google Map & Ekipi Studimor i JICA

Figura 5.1.7 Ndryshimi në Statusin e Venddepozitimit të Mbetjeve, Sharrë



Burimi: Ekipi Studimor i JICA

Figura 5.1.8 Organigrama e Drejtorisë së Menaxhimit të Mbetjeve

3) Mjetet dhe Makineritë e Landfillit

Për landfillin janë prokuruar katër (4) njësi mjetesh dhe makinerish duke përfshirë kompatator, një buldozer, një ekskavator dhe mjet shkarkimi, sipas projektit kreditues të Qeverisë Italiane. Veç kësaj, janë katër (4) njësi ekzistuese mjetesh dhe makinerish, që mbështesin funksionimin e landfillit. Makineritë e vjetra prishen herë pas here, gjithsesi, mekanikët e Ndërmarrjes së Menaxhimit të Mbetjeve merren me ndreqjet e lehta dhe me mirëmbajtjen e makinerive. Tabela 5.1.13 tregon listën e mjeteve dhe makinerive të landfillit.


Tabela 5.1.13 Lista e Makinerive dhe Mjeteve Ekzistuese në Venddepozitimin e Mbetjeve Sharrë

Nr.	Lloji i Mjetit	Marka	Numri i Modelit	Viti i prodhimit	Fuqia/ Kapaciteti	Data e Prokurimit	Orët e Punës/km	Gjendja
1.	Kompatator	BOMAG	BC572R8-2	2008	227 Hp	16.06.2008	3500	Jo në shërbim (nevojë për ndreqje dhe ndryshim injektorësh)
2.	Kompatator	Caterpillar		2011		31.8.2011		Në gjendje pune
3.	Buldozer	NEWHOLLA ND	D180PSXLT	2008	180 Hp	15.04.2009	3850	Jo në shërbim që nga Prilli 2011 (defekt në impiantin elektrik)
4.	Rul Vibruës	KINEZE	CSS216PA	1998	150 Hp	29.12.2005	Pa të dhëna	Në gjendje pune
5.	Ekskavator Mekanik	HITACHI	4GFZË220	2008	164 Hp	09.04.2008	1070	Në gjendje pune (nevojë për goma të reja)
6.	Ekskavator Mekanik	KINEZE		1998	150 Hp	2005	4000	Në gjendje pune (nevojë për goma të reja)
7.	Ekskavator Caterpillar	JONYHANG		1997	210 Hp	2006	950	Në gjendje pune
8.	Kamion	FIAT IVECO	380T4S	2008	13 ton	09.04.2008	8750 km	Në gjendje pune
9.	Kamionçina	IVECO	4910	1993	2.5 ton	17.12.1993		Në gjendje pune

Burimi: Ekipi Studimor i JICA, 2012

4) Sasia Ditore e Mbetjeve të Depozituara

Ndërmarrja e Menaxhimit të Mbetjeve ka regjistruar të gjitha mjetet hyrëse në venddepozitimin e mbetjeve, Sharrë. Formulari i regjistrimit të të dhënave ka pjesën për të gjithë ofruesit e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve, zonën e shërbimit, targën e mjetit dhe peshën e mjetit sipas numrit të akseve, etj. Figura 5.1.9 tregon analizën e të dhënave nga shtatori 1997 deri në 2011 për mbetjet e ardhura në landfill nga zonat e pastrimit të BT-së. Sasia e mbetjeve të depozituara ishte vetëm 320 tonë/ditë në 1997 dhe sasia e mbetjeve të depozituara u rrit menjëherë mbi 850 tonë/ditë në 2005. Rritja e sasisë së mbetjeve të depozituara në tre vite është e shpejtë, duke kaluar nga 1520 tonë/ditë në 2006, 1690 tonë/ditë në 2007, dhe, 1870 tonë/ditë në 2008. Më tej, sasia e mbetjeve të depozituara bie nga 820 tonë/ditë në 2009, 770 tonë/ditë në 2010 dhe 720 tonë/ditë në 2011. Rritja drastike e ndodhur gjatë periudhës 2006-2008 mund të shpjegohet nga shkakut e disa aktiviteteve shtesë pastrimi gjatë këtyre viteve, përveç rritjes së mprehtë ekonomike, në terma GDP-je. Gjithsesi, rritja e sasisë së mbetjeve të depozituara është përtej arsyes dhe është e nevojshme të rishikohen këto të dhëna si dhe metoda e vlerësimit të sasisë së mbetjeve të depozituara duhet konfirmuar.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA, 2012


Figura 5.1.9 Prirja e Sasisë së Mbetjeve Ditore të Depozituara në Venddepozitim të Mbetjeve Sharrë (1997 - Shtator 2011)

5) Jetëgjatësia e Venddepozitimit të Mbetjeve Sharrë

Informacioni i marrë nga agjencia zbatuese për përmirësimin dhe zgjerimin e Venddepozitimit të Sharrës, TEI Sp. A., Milan, Italy, tregon se vëllimi gjithsej i planifikuar, për landfillin, në 3 faza të zhvillimit të punës është 2,45 milion metër kub, siç tregohet në figurën 5.1.10 për konfigurimin përfundimtar të landfillit.


Sipas raportit të përgatitur nga IFC³ (International Finance Cooperation), jetëgjatësia e landfillit është përafërsisht shtatë (7) vjet. Për këtë arsye, Venddepozitimi i Mbetjeve në Sharrë është vlerësuar të jetë deri në fund të 2015. Figura 5.1.11 tregon sasinë e grumbulluar në landfill sipas peshës që nga 1997 deri në shtator 2001. Duke mbledhur vlerën e peshës së mbushur që nga fillimi i landfillit në zonën e zgjeruar në shtator 2008 deri në shtator 2011, sasia e përgjithshme e mbetjeve të mbushura kap vlerën deri në 1,1 milion ton. Duke supozuar një dendësi mbetjesh prej 0,75 ton/m³, sasia e mbetjeve të grumbulluara në 3 vitet e fundit vlerësohet në 1,5 milion metër kub. Si pasojë, vëllimi i mbetur, i vlefshëm për landfillin është vlerësuar në rreth 1 milion metër kub, deri në vlerat e shtatorit të 2011 dhe vëllimi i mbetur, i vlerëshëm për landfill do të mbushet në tre (3) vitet e ardhshme.

³ Raporti mbi Vlerësimin Paraprak të Venddepozitimit të Mbetjeve të Tiranës, Mars 2010, International Finance Corporation (IFC)



Burimi: TEI SpA., Milan, Italy agjencia zbatuese për përmirësimin dhe zgjerimin e Venddepozitimit të Sharrës

Figura 5.1.10 Konfigurimi Përfundimtar i Landfillit të Sharrës



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s, 2012

Figura 5.1.11 Sasia e Grumbulluar në Landfillin e Sharrës (1997 - Shtator 2011)

(5) Statusi Financiar i Menaxhimit të Mbetjeve

1) Buxheti i Menaxhimit të Mbetjeve

Kostoja e menaxhimit të mbetjeve për periudhën 2000-2010 është treguar në Tabelën 5.1.14. Kostoja është rritur vit pas viti duke filluar që nga 333,6 milionë lekë në 2000 deri në 1 048,1 milionë lekë në 2010; për më tepër vlera e propozuar për vitin 2011 kap vlerën prej 915,3 milionë lekë. Në të njëjtën periudhë, buxheti i BT-së rritet nga 3 830,4 milionë lekë në 2000, në 3 704,1 milionë lekë në 2011. Gjatë kësaj periudhe, rritja e buxhetit të menaxhimit të mbetjeve ishte 3,1 herë, rritja e përqindjes së buxhetit gjithsej ishte rreth 2,0

herë. Në buxhetin e propozuar të vitit 2011, buxheti i menaxhimit të mbetjeve llogaritet në 24,71 % të buxhetit gjithsej të BT-së.

Tabela 5.1.14 Trendi i Buxhetit të Menaxhimit të Mbetjeve 2000-2011

Viti	Buxheti i Bashkisë së Tiranës (lekë)	Buxheti i Mbetjeve, i Bashkisë së Tiranës (lekë)	Përqindja e Buxhetit të Mbetjeve në Buxhetin e Bashkisë së Tiranës (%)
2000	3 830 356 000	333 646 000	8,71
2001	4 320 586 000	300 869 000	6,96
2002	4 059 067 000	353 307 000	8,70
2003	4 766 014 000	342 459 000	7,18
2004	6 511 487 000	421 928 000	6,48
2005	8 272 988 000	447 033 000	5,40
2006	6 750 104 000	445 615 000	6,60
2007	6 417 627 000	475 068 000	7,40
2008	6 318 446 000	947 832 000	15,00
2009	5 390 196 254	995 518 785	18,46
2010	5 085 516 083	1 048 121 817	20,60
2011	3 704 069 258	915 315 000	24,71
Propozuar për 2012	7 049 346 000	850 000 000	12,06

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Administrimit, BT

2) Tarifa e Mbetjeve

Grumbullimi i tarifës së mbetjeve ose tarifës së pastrimit filloi në 2002 për familjet dhe në 2003 për njësitë tregtare dhe të biznesit. Tarifa e mbetjeve që nga faza fillestare është e paraqitur në Tabelën 5.1.15. Tarifa e mbetjeve është rritur çdo vit për të mbuluar koston e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve, nga BT-ja.

Tabela 5.1.15 Tarifa e Mbetjeve e BT

Mbetjet Familjare : Familjet	
2002-2003:	300 lekë/familje/vit;
2004:	300 lekë /familje/vit
2005:	1 000 lekë /familje/vit
2006:	1 400 lekë /familje/vit
2007:	2 100 lekë /familje/vit
2008:	3 600 lekë /familje/vit
2009:	4 500 lekë /familje/vit
2010:	5 000 lekë /familje/vit
Mbetjet tregtare & Biznesit : Sipërmarrje	
2003-2007	1 500 - 150 000 lekë /vit
2008-2010	1 000 - 225 000 lekë /vit

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Administrimit, BT

Përqindja e grumbullimit të tarifës së mbetjeve ishte më shumë se 90% në periudhën 2002-2005, por u ul vit pas çdo viti, siç shihet në Tabelën 5.1.16. Rënia mund të jetë rrjedhim i frenimit të pagesës së tarifës së mbetjeve për shkak të ankesave për shërbimin e pastrimit nga familjet etj. Si rezultat, përqindja e grumbullimit të tarifës së mbetjeve në 2010 ra në rreth 43%.

Tabela 5.1.16 Përqindja e Grumbullimit të Tarifës së Mbetjeve në BT

Vitet	Nr. i Taksa Paguesve		E planifikuar	E tanishme	Përqindja e Grumbullimit (%)
	Familje	Sipërmarrje Private			
2002	10 385	9 301	180 000 000	171 521 000	95,3%
2003	48 016	10 303	250 000 000	232 139 276	92,9%
2004	32 689	12 364	250 000 000	281 009 121	112,4%
2005	53 053	13 686	356 200 000	356 050 245	99,96%
2006	47 827	15 033	396 160 000	316 027 081	79,8%
2007	46 236	16 724	597 000 000	411 030 847	68,8%
2008	71 431	20 827	1 022 600 000	591 209 154	57,8%
2009	43 707	20 457	1 120 000 000	616 909 025	55,1%
2010	21 994	22 284	1 141 000 000	489 809 864	42,9%
2011	29 175	18 500	1 128 000 000	465 399 307	41,3%
2012	29 175	18 500	963 400 000	-	-

Burimi: Sektori i Buxhetit Afatmesëm dhe Vjetor, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, BT

5.2. Problemet dhe Çështjet e Planifikimit

Nga analiza e të dhënave dhe informacioneve, janë identifikuar disa probleme në lidhje me shërbimet e menaxhimit të mbetjeve bashkiake të BT-së. Këto probleme do të studiohen më tej për të zbatuar menjëherë planet dhe projektet, që do të zgjidhin rreziqet mjedisore dhe shëndetësore.

5.2.1. Problemet e Identifikuara dhe Çështjet e Planifikimit

Një kornizë ligjore për menaxhimin e mbetjeve është krijuar me Ligjin e Integruar të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta të miratuar në nëntor të vitit 2011. Megjithatë, rregullat e hollësishme, rregulloret, standardet, kriteret, etj. ende nuk janë përgatitur për zbatimin e tanishëm të aktiviteteve bashkiake të menaxhimit të mbetjeve. Bashkia e Tiranës nuk ka masterplan për administrimin e mbetjeve bashkiake. Zhvillimi i duhur i objekteve, aktivitetet e prokurimit dhe shërbimi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta nuk mund të zbatohet sistematikisht pa një masterplan, planet e veprimit të ndarë në faza dhe planin buxhetor. Prandaj, BT duhet të ndërmarrë masat që vijnë:

- Të formulojë rregulla të hollësishme, rregullore, standardet dhe kriteret për zbatimin e aktiviteteve të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në BT në përputhje me kërkesat e ligjit,
- Të formulojë një plan për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta dhe të zbatojë planet e veprimit dhe projektet parësore të formuluar në masterplan.

5.2.2. Probleme dhe Çështje për Grumbullimin e Mbetjeve

Mbetjet shkarkohen në zonat e rrethinave të bashkisë, veçanërisht në zonat përgjatë skarpateve të lumit Tirana dhe në rrjedhjet e sipërme dhe të poshtme të lumit Lana. Këto zona nuk kanë kontejnerë mbetjesh ose kontejnerët janë shumë larg përdoruesit. Duke marrë parasysh gjendjen,

BT duhet të ndërmarrrë këto masa:

- Të përcaktojë numrin e nevojshëm të kontejnerëve të mbetjeve dhe vendndodhjen e kontejnerëve të mbetjeve të përshtatshëm për përdoruesit;
- Të studiojë sistemin me tre kosha në përputhje me planet kombëtare dhe rajonale për të ndarë materialet e riciklueshme të thata, materialet e riciklueshme të njoma (mbetje të biodegradueshme) dhe mbetje të tjera familjare, të përziera;
- Studimin e alternimit për zbatimin e shërbimit të tanishëm të grumbullimit për shërbimin e grumbullimit me kontejnerët e rinj të mbetjeve;
- Udhëzimi i banorëve për ti depozituar siç duhet mbetjet në kontejnerët e mbetjeve dhe të ndalojë hedhjen e mbetjeve në hapësirat publike; dhe të
- Vrojtjë dhe formulojë planet e ngutshme të zbatimit për të pastruar venddepozitetet e paligjshme të mbetjeve.

5.2.3. Probleme dhe Çështje për 3R dhe Trajtimin e Ndërmjetëm

Deri tani, BT nuk ka marrë nisma për aktivitetet e 3R. Reduktimi i mbetjeve nuk është promovuar ende në shoqëri edhe pse aktivitetet e ripërdorimit dhe riciklimit janë zbatuar nga sektori privat. Veç kësaj, edhe trajtimi i mbetjeve nuk është zbatuar. Në zbatim të Ligjit dhe planeve përkatëse kombëtare dhe rajonale, për të reduktuar vëllimin e mbetjeve në landfill, BT duhet të:

- Përgatisë plane dhe programe për edukimin dhe informimin publik për prodhuesit e mbetjeve, për të rritur ndërgjegjen e publikut për reduktimin e mbetjeve dhe ndarjen e mbetjeve të riciklueshme në burim, dhe zbatimin e menjëhershëm të planeve dhe programeve;
- Studiojë masat për të përmbushur objektivin e riciklimit në masën 25% deri në 2015 përmes riciklimit dhe kompostimit të mbetjeve të biodegradueshme;
- Organizojë aktivitete kompostimi në grup për edukimin dhe udhëzimin për kompostimin në një zonë pilot të qytetit dhe/ose përmes bashkëpunimit me fermat në zonat përreth Tiranës;
- Vendosija e lidhjeve ndërmjet BT dhe industrisë së riciklimit, tregtarëve, grumbulluesve të mbetjeve dhe banorëve për të mbështetur dhe marrë pjesë në rikuperimin e materialeve të riciklueshme dhe kryerjen e riciklimit.

5.2.4. Probleme dhe Çështje të Depozitimit të Mbetjeve

Jetëgjatësia e landfillit ekzistues të mbetjeve në Sharrë, është vlerësuar të jetë nga periudha 2013 deri në 2015 në varësi të kushteve të aktiviteteve për ndryshueshmërinë e mbetjeve bashkiake, nga depozitimi përfundimtar përmes reduktimit dhe riciklimit. Duke marrë parasysh kohën për identifikimin e truallit, projektimin, ndërtimin deri në fillimin funksionimit të landfillit të ri, BT është e ngarkuar në mënyrë të pashmangshme për të kryer si më poshtë vijnë:

- Të fillojë identifikimin e vendit të landfillit, projektimin, ndërtimin e impianteve të venddepozitimit të ri, përpara se venddepozitimi i sotëm i Sharrës të arrij kapacitetin e tij të plotë;
- Të studiojë masat për reduktimin e mbetjeve organike në landfill me më pak se 35% deri në 2016 në përputhje me Direktivën e Landfillit 1999/31/EC

5.2.5. Probleme për Tarifën e Mbetjeve

Grumbullimi i tarifës së pastrimit ka filluar në 2002. Përqindja e grumbullimit në fillim ka qenë mjaft e mirë. Por, përqindja e grumbullimit në 2010 ra në 43%. Parimi Përfituesi Pagan (PPP)

është në ditët tona një parim në shërbimet publike. Për këtë, BT do të duhet të:

- Kryej një vrojtim ndërmjet prodhuesve të mbetjeve për arsyet e mundshme për rënien e pagesës së tarifës së mbetjeve dhe një studim për masat e përmirësimit të cilësisë së shërbimit të grumbullimit të mbetjeve;
- Shtojnë dhe/ose vendosin transparencë mbi llogarinë për menaxhimin e mbetjeve, gjithashtu mbi tarifën e mbetjeve, kontratën e grumbullimit të mbetjeve, shpenzimet e depozitimit të mbetjeve;
- Ngritjen e sistemit llogaritës të vlershëm për të llogaritur koston e grumbullimit të mbetjeve dhe operacionet e depozitimit të mbetjeve.

5.3. Rishikimi i Politikave Ekzistuese dhe Studimeve të Mëparshme

5.3.1. Kuadri Politik Kombëtar i Aktiviteteve të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta

(1) Strategjia Kombëtare (Politikat Kombëtare)

1) E përgjithshme

Strategjia Kombëtare Shqiptare e mbetjeve ishte hartuar në zbatim të Planit Kombëtar për Projektin e Përafrimit të Legjislacionit Mjedisor (Projekti INPAEL), ndihmuar nga BE-ja dhe iu dorëzua Qeverisë Shqiptare më 25 maj 2010. Strategjia kombëtare u shqyrtua nga qeveria dhe u miratua në qershor 2011. Nënseksionet e mëposhtme përmbledhin pikat kryesore të strategjive kombëtare për menaxhimin e mbetjeve bashkiake.

2) Kërkesat e Direktivës Kuadër të mbetjeve

Direktiva Kuadër e Mbetjeve është legjislacioni kryesor nga Bashkimi Evropian, që trajton mbetjet. Direktiva 2008/98/EC për mbetjet, miratuar në nëntor 2008 parasheh një qasje të re për menaxhimin e mbetjeve bazuar në parandalimin e ndikimeve negative të mbetjeve të prodhuara dhe menaxhimit të shëndetit të njeriut dhe mjedisit, si dhe me qëllim të kufizojnë prodhimin e mbetjeve, si edhe nxitjen e përdorimit të mbetjeve si një burim për riciklim dhe rikuperim. Për të arritur këtë qëllim, është ngritur nga Direktiva si një rend parësor një hierarki për menaxhimin e mbetjeve. Ajo merret me:

- Parandalimin
- Përgatitjen për ripërdorim
- Riciklimin
- Rikuperime të tjera, psh. rikuperim të energjisë
- Depozitimin.

3) Niveli i synuar i Ripërdorimit dhe Riciklimit në Direktivën Kuadër të Mbetjeve

Direktiva Kuadër e Mbetjeve e BE-së përcakton nivelet e synuara për ripërdorimin dhe riciklimin, të cilat janë përmbledhur si më poshtë:

- Grumbullimi i ndarë duhet të ngrihet si sistem të paktën për letrën, metalin, plastikën dhe qelqin deri në vitin 2015;
- Përgatitja për ripërdorimin dhe riciklimin e materialeve, të paktën për letër, metal, plastikë dhe qelq nga familjet dhe mundësisht nga burime të tjera deri në vitin 2020, të paktën prej 50 % të sasisë së përgjithshme sipas peshës;

- Përgatitja për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim të materialeve të tjera, përfshirë operacionet mbushëse duke përdorur mbetje për të zëvendësuar materialet e tjera të mbetjeve jo të rrezikshme të ndërtimit dhe prishjes deri në vitin 2020 në një minimum prej 70 % nga pesha.
- Direktiva e Landfill 1999/31/EC detyron Shtetet Anëtare për të ulur sasinë e mbetjeve bio, që asgjësohen në landfill në 35 % nga viti 2016.

4) Përparësitë Strategjike për Menaxhimin e Mbetjeve

Disa aspirata strategjike kombëtare në sektorin e mjedisit, duke përfshirë edhe menaxhimin e mbetjeve ishin përgatitur nga Qeveria në vitet 2006-2008, si për shembull, "Strategjia Kombëtare e Mjedisit (SKM) botuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në emër të Qeverisë së Shqipërisë në nëntor 2006", "Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013 botuar nga Këshilli i Ministrave në mars 2008 ", etj. *Strategjia Kombëtare e Mbetjeve ishte përgatitur si një dokument i vetëm, strategjik, koherent për formulimin dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të mbetjeve duke kombinuar dokumentet e mësipërme strategjike për të siguruar një Strategji të qartë Kombëtare të Mbetjeve. Strategjia mbulon periudhën 2010-2025 si periudhë të rëndësishme para dhe menjëherë pas anëtarësimit në BE. Strategjia është formuluar duke u bazuar në katër shtylla të politikës themeluese të Politikës Kombëtare të mbetjeve: Planifikimi, Arsimi, Burimet, dhe Legjislacioni. Gjatë kësaj periudhe, qeveria shqiptare do të trajtojë menaxhimin e mbetjeve si një çështje parësore dhe do të kryejnë përpjekje të mëdha e aktive për përafrimin e plotë të sektorit të menaxhimit të mbetjeve me ligjet e BE-së dhe të mbështesë integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE).*

5) Përparësitë e Programit Qeverisës në Menaxhimin e Mbetjeve

Kapitulli 2.2.3 përcakton përparësitë e programit qeverisës për:

- Përvetësimin e Standardeve Ligjore të Komunitetit Evropian,
- Forcimin e zbatimit të ligjit për mbetjet,
- Investimet për mbrojtjen e mjedisit,
- Mbështetje financiare për infrastrukturën e mjedisit,
- Administrimin e burimeve mjedisore,
- Përmirësimin e komunikimit e ndërgjegjësimin, dhe,
- Përmirësimin e sistemit monitorues.

6) Nevoja për Përmirësime të Shprehura në Raportet e BE-së për Shqipërinë

Kapitulli 2.3 i Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve përfshin numrin e dokumenteve strategjike të përgatitura nga BE për Shqipërinë. Këto dokumente identifikojnë dhe pranojnë menaxhimin e mbetjeve si një çështje parësore për tu përmirësuar dhe/ose zbatuar sa më poshtë.

- nxit ndërtimin e infrastrukturës për trajtimin e mbetjeve urbane, mbledhjen përzgjedhëse të mbetjeve, riciklimin dhe depozitimin e tyre;
- thekson se hedhja e pakontrolluar dhe djegia e mbetjeve vazhdojnë të jenë rreziqe për shëndetin dhe mjedisin;

- theksojnë se është zhvilluar një strategji e qartë për depozitimin e mbetjeve të rrezikshme.

7) Politika Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve

Në mënyrë që të ketë një ndryshim të suksesshëm dhe për të sjellë një zgjidhje afatgjatë të qëndrueshme për administrimin e mbetjeve në Shqipëri, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave ka përqendruar vëmendjen e saj në katër (4) shtylla kryesore: Planifikimi, Edukimi, Financimi, dhe Legjislacioni. Këto shtylla politike janë zbatuar përmes këtyre fazave planifikuese:

1. Planifikimi në Administrimin e Mbetjeve

1.1 Faza I – Përgatitja e Planit Kombëtar për Administrimin e Mbetjeve

Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve ka për qëllim të siguroj bazat për:

- *Një kuadër kombëtar për zhvillimin e planeve vendore dhe të zonave të mbetjeve, të cilët kanë vendosur parime, kanë zgjidhur çështje me rëndësi kombëtare të tilla si mbetjet e rrezikshme dhe menaxhimin e mbetjeve klinike, veprimet e specializuara të rikuperimit dhe riciklimit (të gomave apo plastikës),*
- *Plane të menaxhimit të mbetjeve vendore të cilat përqendrohen në grumbullimin dhe asgjësimin e mbetjeve urbane, duke përfshirë ndarjen e mbetjeve dhe përgatitjeve për riciklim.*

Plani kombëtar për mbetjet do të krijojë disa struktura që të forcojnë dhe të realizojnë qëllimet dhe objektivat e planifikuara, që janë:

- Komiteti Kombëtar i Mbetjeve (politik)
- Grupi Këshillimor për Mbetjet Kombëtare (teknik)
- Zonat e Mbetjeve

1.2 Faza II – Përgatitja e Planeve për Administrimin e Mbetjeve në Nivel Vendor dhe Rajonal

Përfshin përgatitjen e planeve vendore dhe rajonale në mënyrë që t'u përgjigjen kërkesave afatshkurta dhe afatmesme. Planet në nivel rajonal (zona e mbetjeve) dhe vendor duhet të përfshijnë:

- *Procedura të përshtatshme dhe të frytshme të grumbullimit dhe transportit;*
- *Inventar të vendeve ekzistuese, gjendjen e tyre dhe planet për përmirësimin e tyre;*
- *Standarde të përballueshme për ndërtimin e landfillleve, të cilët zvogëlojnë ndotjen;*
- *Mekanizma për të rritur të ardhurat nga shërbimi i grumbullimit të mbetjeve;*
- *Informimi i publikut për dëmin e shkaktuar nga hedhja e mbetjeve.*
- *Pastrimin e venddepozitimeve të paligjshme;*
- *Rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese.*

Udhëzimi, standardet për grumbullimin, trajtimin, asgjësimin, projektimin dhe mbështetja

teknike autoriteteve vendore do t'u ofrohet në mënyrë që të sigurojnë që planet janë cilësorë dhe rezultatet janë të krahasueshme.

2. Edukimi në Menaxhimin e Mbetjeve

2.1 Fushata për Informimin e Publikut

Fushatat do të kenë për qëllim:

- *Të rritin sasinë e informimit të përgjithshëm për pasojat që do të sjellë hedhja e mbetjeve dhe djegia e hapur;*
- *Të ndryshojë zakonet dhe sjelljet në vende të ndryshme për grumbullimin e mbetjeve, ndarjen, riciklimin dhe asgjësimin;*
- *Përforcimin e fushatës kundër hedhjes të paligjshme të mbetjeve.*

2.2 Trajnimi profesional

Rritja e kapacitetit profesional të autoriteteve vendore dhe rajonale si dhe e punonjësve të sektorit privat në fushën e mjedisit për transferimin e përgjegjësi drejt autoriteteve vendore dhe rajonale. Kompletimi i kurseve të trajnimit individual i lejon ata të aplikojnë për një kualifikim zyrtar në fushën e menaxhimit të mbetjeve.

3. Burimet për Menaxhimin e Mbetjeve

Për zbatimin dhe funksionimin e suksesshëm të menaxhimit të mbetjeve duhet të sigurohen burimet njerëzore dhe financiare.

4. Legjislacioni në Menaxhimin e Mbetjeve

Përveç tri shtyllave politike të mësipërme, legjislacioni është i nevojshëm si themel për të vendosur rregullat dhe rregulloret për zbatimin dhe arritjen e qëllimeve të sistemit të menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Republika e Shqipërisë është angazhuar në një proces për anëtarësimin e plotë në BE dhe për këtë arsye Ministria e Mjedisit ka punuar për transferimin e direktivave kryesore të BE-së në instrumentet legjislative të Shqipërisë. Kjo punë do të vazhdojë deri në vitin 2012.

8) Sfidat për të Siguruar Sistemin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

Katër sfidat e mëposhtme janë parashikuar për ngritjen e një mekanizmi për të siguruar sistemin e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.

a) Sfidat Ekonomike:

- Kostot e impianteve të trajtimit dhe mirëmbajtja
- Ekonomia e shkallës (p.sh. përmasat dhe kapaciteti i impiantit)

b) Sfidat e Mjedisit:

- Mundësia për të reduktuar mbetjet në landfill (duke investuar fillimisht në grumbullimin e ndarë të mbetjeve, Stacionet/Qendrat e Transferimit për një ndarje të mëtejshme të mbetjeve, ripërdorimi, riciklimi/rikuperimi).
- Pakësimi i kërkesës për burimet natyrore për produktet (nëpërmjet riciklimit)

c) Sfidat Shoqërore:

- Kërkesa e komunitetit për programet e riciklimit.
- Kërkesa e komunitetit për shërbime të qëndrueshme brenda kufijve të Qarkut

d) Sfida Ligjore:

- Rritja e kërkesave rregulluese (psh. për landfillet)
- Potencial për kërkesa të reja të parashikuara me ligj (p.sh. Mbrojtja e Mjedisit, Politika e Mbetjeve)

9) Organizimi i Qeverisë Qendrore për të Adresuar Sfidat

Në Qeverinë Qendrore rolin drejtues e luan Ministria e Mjedisit, që duhet ti përgjigjet nevojave dhe shqetësimeve të ministrive të tjera të linjës, Këshillave të Qarqeve, komunitetit dhe grupeve të tjera të interesit. Organizimi i Qeverisë Qendrore duhet të përfshijë qartësimin e roleve të lojtarëve dhe përgjegjësi për menaxhimin e mbetjeve dhe kryerjen e reformave për të rritur performancën e qeverisë.

Veç kësaj, për zbatimin e plotë dhe të frytshëm të politikës së menaxhimit të integruar të mbetjeve janë krijuar grupe pune prej tre nivelesh siç janë:

- Një Komision Ndërmnistror (në nivel qendror dhe politik);
- Një grup Kombëtar Këshillimor (në nivel qendror dhe teknik);
- Grupet e punës së Zonave të Mbetjeve (në nivel vendor dhe teknik në çdo Qark/zonë mbetjesh)

10) Burimet e Financimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta

a) Burimet e Jashtme

Zhvillimi i një menaxhimi të integruar të mbetjeve të ngurta është planifikuar të bëhet në 2 faza, psh. Faza 1 para pranimit në BE dhe Faza 2 pas pranimit në BE. Në Fazën e 1-rë financimet do të sigurohen nëpërmjet programit të financimit të Qeverisë Qendrore si dhe nëpërmjet financave të premtuara nga bashkësia kolektive e donatorëve ndërkombëtarë, qoftë si donacione, apo si marrëveshje të posaçme financiare kredie. Në Fazën e 2-të fondet do të vijnë kryesisht nga programi i fondeve të qeverisë qendrore dhe nga programet e infrastrukturës së fondeve të BE. Kapitali privat për Partneritetin Publik Privat (PPP) është quajtur si një burim alternativ financimi.

b) Tarifat e Mbetjeve

Tarifa për mbetjet aplikohet nga njësitë e qeverive vendore si mbi rezidentët, konsumatorët tregtarë, ashtu edhe mbi institucionet shtetërore. Përcaktimi i taksave gjendet në Ligjin Nr. 9632, 30.10.2006, “Për Taksat Vendore” Kapitulli VII, Artikulli 35 dhe Ligji nr.8652, 31.07.2000. Në parim, Këshilli Bashkiak ose Komunal përcakton tipin e taksës, rregullat e vjeljes dhe administrimin e tyre. Sot, nuk ka asnjë autoritet qendror rregullator të veçantë, që shqyrton dhe miraton tarifat apo ndryshimet në tarifa. Të ardhurat e krijuara nëpërmjet mbledhjes së taksave për pastrim janë larg nga buxheti i kërkuar për menaxhimin e mbetjeve dhe shumica e komunave/bashkive kanë nevojë për burime të tjera financimi që të sigurojnë pastrimin e qytetit dhe administrimin e mbetjeve. Tarifat e menaxhimit të mbetjeve do të rriten në mënyrë që të mbulojnë kostot në përputhje me legjislacionin e BE-së.

c) Fondi Mjedisor

Fondi Mjedisor do të vendoset në një linjë me Programin e Qeverisë. Qëllimi kryesor i Fondit Mjedisor është që të veprojë si një grumbullues qendror dhe si një pikë

shpërndarjeje për disa apo për të gjitha të ardhurat nga tarifat mjedisore, gjobat, taksat dhe burime të tjera, duke përfshirë edhe donatorët. Shpërndarja e fondeve të projektet mund të bëhet në bazë të kritereve të qarta dhe transparente.

11) Raportimi, Monitorimi dhe Vlerësimi

Për të ndërmarrë hapat për kalimin në një sistem menaxhimi modern të menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri, Strategjia Kombëtare e Mbetjeve, paraqet çështjet kyç, që duhet të trajtohen nga Qeveria Qendrore, qeveria vendore, banorët, sektori privat dhe të gjitha grupet e interesit. Ato janë:

- Përfshirja e Aktorëve Kryesore për sigurimin e informacionit dhe bashkëpunimit;
- Koordinimi i politikave kombëtare, rajonale dhe vendore e planeve të veprimit;
- Monitorimi i zbatimit përmes treguesve mjedisorë, performancës financiare dhe administrative,
- Ngritja e një sistemi raportimi për performancën e përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve.

(2) Plani Kombëtar

1) E Përgjithshme

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve u formulua në bazë të Projektit INPAEL me pjesëmarrjen e BE-së dhe i është dorëzuar qeverisë shqiptare më 19 gusht 2010. Plani u shqyrtua nga Qeveria dhe u miratuar më 19 janar të 2011. Plani është një projekt me objektivat reale, drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Pikat kyçe të planit për menaxhimin e mbetjeve bashkiake janë reflektuar në programin e qeverisë.

2) Përparësitë në Programet Qeveritare

Programet qeveritare në fushën e mjedisit janë formuluar që të veprojnë në përputhje me legjislacionet e Komunitetit Evropian gjatë dhjetëvjeçarëve të ardhshëm për të mbështetur anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Në këtë drejtim, Programi i Qeverisë së 2005 - 2009 përcakton përparësitë për mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Në zbatimin e planeve dhe programeve, çështjet kyçe, që lidhen me menaxhimin e mbetjeve janë përcaktuar si vijon:

- Zbatimi i ligjeve sidomos për parimin ndotësi paguan përmes reformës së agjencive mjedisore dhe institucioneve për të rritur masat ndëshkimore ndaj çdo ndotësi dhe dëmtuesi të pasurive mjedisore;
- Neutralizimi dhe/ose rehabilitimi i të gjitha "pikave të nxehta mjedisore", të shkaktuara nga industritë e vjetra dhe të braktisura. Në raste të veçanta, familjet e ekspozuara ndaj rreziqeve nga këto vende do të zhvendosen;
- Nxitës ekologjikisht miqësorë për operatorët ekonomikë dhe individët do të adoptohen në përputhje me parimet e tregut të lirë nëpërmjet nxitësve fiskalë për të reduktuar ndotjen nga bizneset dhe individët, investimet në teknologji të pastra, ruajtjen e energjisë, etj. Qeveria do të krijojë një të Fond të veçantë mjedisor, që do të financohet nga taksat dhe gjobat mjedisore, si edhe nga donacionet,
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për njerëzit në situata mjedisore dhe rreziqe. Shoqëria civile dhe organizatat e pavarura do të jenë pjesëmarrëse për të ofruar ndihmesën e tyre në hartimin dhe zbatimin e politikave mjedisore, dhe në veçanti për monitorimin e gjendjes së mjedisit në vend.

Programi Qeveritar 2009-2013 është në zbatim. Programi thekson:

- Rritja e investimeve për mbrojtjen e mjedisit përmes fondeve nga Qeveria Qendrore, buxheti vendor, donatorët, sektori privat;
- Zhvillimi i menaxhimit modern të mbetjeve të ngurta dhe ndërtimi i landfilleve rajonale sanitare sipas standardeve të BE-së;
- Përmirësimi i mbledhjes së mbetjeve dhe trajtimi në qarqet: Tiranë, Durrës, Fier, Korçë, Elbasan dhe Vlorë, si dhe qendrat e vogla urbane brenda periudhës 4-vjeçare;
- Përgatitja dhe zbatimi i politikave nxitëse dhe mbështetëse për fuqizimin e sektorit të riciklimit të mbetjeve
- Rehabilitimi i vendeve të ndotura nga industritë e kaluara dhe pikat kryesore të nxehta, si PVC Vlorës, Kombinati Metalurgjik i Elbasanit, Patos-Marinzë, Gjanicë, Rubik, etj.;
- Përafrimi i legjislacionit me BE-në në fushën e mjedisit do të synohet në 80%,
- Përmirësimi dhe fuqizimi i monitorimit të mjedisit duhet të mbulojë të gjithë përbërësit, që lidhen me mjedisin për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Për të realizuar vizionet e Qeverisë, politikat dhe strategjitë, përparësitë strategjike dhe politikat janë përqendruar në këto fusha:

- Përshtatja e standardeve ligjore të Komunitetit Evropian;
- Zbatimi i legjislacionit mjedisor;
- Investimi në mbrojtjen e mjedisit;
- Mbështetje financiare për infrastrukturën mjedisore;
- Përmirësimi i komunikimit dhe ndërgjegjësimit;
- Përmirësimi i sistemit të monitorimit.

3) Politika dhe Strategjia Kombëtare e Mbetjeve

Në mënyrë që të realizohet vizioni i qeverisë shqiptare për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, MMPAU për zbatimin e menaxhimit të mbetjeve dhe strategjisë përmes Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve parashikon katër shtylla të politikës.

- Planifikimi
- Arsimi
- Burimet
- Legjislacioni

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve është baza për një kuadër kombëtar për zhvillimin e planeve vendore të zonave të mbetjeve. Pra, planet në nivel rajonal (zonat e mbetjeve) dhe vendor duhet të përfshijnë:

- Grumbullimin e përshtatshëm dhe të frytshëm dhe procedurat e transportit;
- Inventarin e vendeve ekzistuese, gjendjen e tyre dhe planet e rehabilitimit;
- Standardet e përballeshme për ndërtimin e landfilleve, që pakësojnë ndotjen;
- Mekanizmat për të ardhura në rritje nga grumbullimi i mbetjeve,
- Hapat për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për dëmet e shkaktuara nga depozitimet e mbetjeve.

Në zbatimin e politikës kombëtare, nivelet e synuara të prodhimit dhe të riciklimit të mbetjeve janë vendosur për të:

- ndaluar rritjen e prodhimit të mbetjeve bashkiake deri në vitin 2020;

- arritur riciklimin 25% dhe kompostimin e mbetjeve bashkiake deri në vitin 2015;
- arritur riciklimin 55% dhe kompostimin e mbetjeve bashkiake deri në vitin 2020;
- rikuperuar energji nga 15% e mbetjeve bashkiake;
- ulur depozitim në landfill të mbetjeve bashkiake nga 90% në rreth 30%;
- siguruar përhapjen e këshillimit masiv për pakësimin e mbetjeve për bizneset,
- për të zhvilluar tregjet për materialet e riciklueshme, për të ndihmuar rritjen e industrisë së riciklimit.

4) Objektivat e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve

Qëllimet e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve janë përcaktuar për të zvogëluar ndikimin e mbetjeve në mjedis dhe për të korrigjuar dëmtimin mjedisor dhe padrejtësitë e pësuar nga ata, që kanë jetuar në një shoqëri të pakujdesshme.

Plani do të nxjerrë në pah arritjen e objektivave të synuar të Bashkimit Evropian për pakësimin e landfilleve në vitet 2015, 2020 dhe 2025. Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve gjithashtu parashikon dy objektiva të ndërmjetëm të përqendruar në mbetjet bashkiake:

- për të rritur sasinë e mbetjeve të grumbulluara nga autoritetet vendore, që është ricikluar ose kompostuar në 25 % deri në vitin 2015;
- për të rritur sasinë e mbetjeve të grumbulluara nga autoritetet vendore, që është ricikluar ose kompostuar në 55 % deri në vitin 2020;

Është përcaktuar që plani do të arrijë këto objektiva përmes zbatimit të hierarkisë mbetjeve - Parandalimi, Përgatitja për Ripërdorim, Riciklim, Rikuperim dhe Depozitim. Në praktikë, kjo do të kryhet nga organizatat nën një mekanizëm të koordinuar për t'u formuluar dhe zbatuar nga planet dhe programet sipas:

- Komitetit Ndërministror për Mbetjet (KNM);
- Grupit Kombëtar Këshillimor për Mbetjet (GKKM);
- Grupet e Zonave të Mbetjes (GZM),
- Përfshirja e Grupeve të Interesit dhe Angazhimi i Komunitetit.

Veç kësaj, janë aplikuar edhe parimet e mëposhtme strategjike për planin:

- Afërsia dhe vetëmjaftueshmëria;
- Ndotësi paguan;
- Opsioni më i mirë mjedisor i praktikueshëm (OMMP).

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve është realizuar përmes Planeve Zonale të Mbetjeve, më të detajuar, për t'u formuluar dhe zbatuar nga dymbëdhjetë autoritete rajonale. Plani duhet të jetë subjekt aprovimi nga Ministri. Plani duhet gjithashtu të ngrejë një sistem ligjor të lejimeve në landfill në mënyrë që autoritetet vendore të forcojnë reduktimin e sasisë së mbetjeve të depozituara në landfill, kryesisht të mbetjeve të biodegradueshme. Ndryshimet e mëdha përmes zbatimit të Planit Kombëtar të Mbetjeve priten të kenë një ndërrim domethënës nga prodhuesi i mbetjeve dhe kultura e konsumatorit. Plani përfshin edukimin e vijueshëm vendor dhe kombëtar dhe fushatat ndërgjegjësuere për komunitetin vendas.

5) Objektivi Shqiptar për Parandalimin e Mbetjeve

Parandalimi i mbetjeve në Shqipëri ka si objektiv prodhimin zero të mbetjeve deri në 2020 dhe të vazhdojë këtë përpunim, pas pakësimit të mbetjeve të tanishme.

6) Rezultatet e planifikuara

Nga 2011-2020 të 12 Planet e Zonale të Mbetjeve do të përcaktojnë një ndryshim rrënjësor në rikuperimin e burimeve nëpërmjet:

- parandalimit të mbetjeve;
- riciklimit të materialeve;
- kompostimit;
- kthimit të mbetjeve në energji
- mbetjeve familjare të depozituara në landfill.

Në përgjithësi, Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve parashikon një rritje në rikuperimin e burimeve të mbetjeve bashkiake nga niveli i sotëm në:

- 25% deri në vitin 2015;
- 55% deri në vitin 2020,
- 75% deri në vitin 2025.

7) Zbatimi i Planeve të Veprimit të Mbetjeve Bashkiake

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve është zbatuar përmes tri fazave vijuese:

- Faza-1: 2010-2015;
- Faza-2: 2016-2020;
- Faza-3: 2021-2025.

8) Përmbledhja e Zbatimit të Planeve të Veprimit për Mbetjet Bashkiake

Tabela 5.3.1 përmbledh të gjitha planet e veprimit, duke përfshirë mbetjet bashkiake, mbetjet rrezikshme dhe mbetjet jobashkiake.

Tabela 5.3.1 Planet e Veprimit dhe Afatet Kohore sipas Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve

Veprimet	Përfunduar
Ngritja e një Grupi Kombëtar Këshillimor të Mbetjeve nga Ministri i Mjedisit	Fundi 2010
Ngritja e një grupi të mbetjeve të rrezikshme, që punojnë nën mbikëqyrjen e Grupit Këshillues Kombëtar të Mbetjeve për të kryer një inventar të mbetjeve të rrezikshme	Fundi 2010
Krijimi i një ekipi fushate sensibilizuese për mbetjet nën mbikëqyrjen e Grupit Këshillues Kombëtar të Mbetjeve	Fundi 2010
Zhvillimi i një Strategjie Kombëtare të të Dhënave të Mbetjeve	Fundi 2010
Zhvillimi i një programi për përthithjen e Direktivave	Fundi 2010
Zhvillimi i Projektfishave për programin e përthithjes së legjisllacionit	Fundi 2010
Përfundimi i draftit të Politikës Kombëtare dhe Strategjisë së Mbetjeve	Fillimi 2011
Përfundimi i draftit të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Profileve të Zonës së Mbetjeve të lidhura me të	Fillimi 2011
Shpërndarja e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve të miratuar	Fillimi 2011
Përgatitja e Planit të Zonës së Mbetjeve për Tiranën, Durrësin dhe Elbasanin	Fillimi 2011
Takimi përurues i Grupit Kombëtar Këshillues të Mbetjeve i kryesuar nga Ministri i Mjedisit	Mesi 2011
Zhvillimi i përshkrimeve të projekteve për menaxhimin e mbetjeve të kujdesit shëndetësor dhe automjeteve në fund të jetës	Mesi 2011
Studimi i fizibilitetit për krijimin e kompostimit si një mjet për trajtimin e fraksioneve të mbetjeve organike brenda mbetjeve bashkiake të Shqipërisë	Mesi 2011

Veprimet	Përfunduar
Studimi i fizibilitetit për konceptin e një sistemi tri-koshësh duke u zbatuar në gjitha zonat e mbetjeve për t'i grumbulluar më vete: 1. Të riciklueshme e thatë, 2. Të riciklueshme e lagësht, dhe 3. Mbetje të tjera	Mesi 2011
Zhvillimi i një programi fushate aktiviteteve ndërgjegjëse për mbetjet në lidhje me linjat kohore të zhvillimit të infrastrukturës dhe operacioneve të menaxhimit të mbetjeve në terren	Mesi 2011
Të krijojë një Grup Pune Ligjvënës nën mbikëqyrjen e Grupit Këshillues Kombëtar	Fundi 2011
Takimi i 2 i Grupit Kombëtar Këshillues i kryesuar nga Ministri i Mjedisit	Fundi 2011
Zhvillimi i një Planveprimi të ri për mbetjet e rrezikshme në bazë të elementeve të mbetjeve të rrezikshme në planin për mbetjet dhe në rezultatin e inventarit për mbetjet	Fundi 2011
Studimi i fizibilitetit për bashkëpunimin e shumë zonave të mbetjeve për mbetjet për energji në uzinën e Elbasanit	Fundi 2011
Zhvillimi i fushatave ndërgjegjëse për mbetjet mbi projektet parësore për rrjedhat e mbetjeve	Fundi 2011
Të kryejë dhe qarkullojë për shqyrtim një propozim buxhetor për aktivitetet e lartpërmendura nga Grupi Kombëtar Këshillimor	Fundi 2011
Është projektuar një landfill për mbetjet e rrezikshme joorganike, VNM është kryer dhe janë përgatitur dokumentet e tenderit	Mesi 2012
Vendosja e laboratorit kombëtar referencë për grumbullimin e MRr dhe shërbimet e transportit	Fundi 2012
Të sigurojë nxitje për prodhuesit e mbetjeve për të pakësuar mbetjet e krijuara nga operacionet e tyre	Fundi 2012
Regjistrimi i prodhuesve MRr dhe regjistrimin e sasive të MRr	Fundi 2013
Krijimi i një projekti të Fondit Mjedisor	Fundi 2013
Ministria të sigurojë mbikëqyrjen dhe një pikë kontakti për ekipin e projektit të përfundimit të Direktivave	Fundi 2013
Përgatitja e Planeve të Zonës së Mbetjeve për Lezhën, Shkodrën, Kukësin, Dibrën, Korçën, Beratin, Gjirokastrën, Vlorën	Fundi 2014
Ndërtimi i landfill MRr pajisur me shërbimet e nevojshme për stabilizimin kimik të acideve, bazave, zgjidhjet me metalet e rënda dhe sasive të moderuara të tokës lehtësisht të kontaminuar me elementë të tretshme.	Fundi 2015
Krijimi i një entiteti publik për ofrimin e grumbullimit të MRr dhe shërbimet e transportit me qendrat e pritjes rajonale	Fundi 2015
Informacion publik dhe fushatë ndërgjegjësimi në të gjitha fushat e mbetjeve të planifikuara dhe të zbatuara	Fundi 2015
Futja e qasjes së mbulimit të plotë të kostos	Fundi 2015
Zbatimi i Fondit të Mjedisit	Fundi 2015
Përgatitja e një Guide Kombëtare Teknike për mbetjet e veçanta me grupe mbetjesh me përparësi të lartë, në vëmendje	Fundi 2015
Forcimi i fushatave në industrinë kimike dhe transportin e kimikateve	Mesi 2016
Zbatimi i sistemit të grumbullimit me tre-kosha në të gjitha zonat e mbetjeve	Fundi 2018
Përditësimi i sistemeve të grumbullimit të mbetjeve në të gjitha zonat e mbetjeve	Fundi 2018
Zbatimi i projekteve ndarëse të kompostimit të mbetjeve në të gjitha zonat e mbetjeve	Fundi 2018
Studim Fizibiliteti për sistemimin e djegies së mbetjeve organike familjare	Fundi 2018
Përgatitja dhe zbatimi i projekteve të investimit për krijimin dhe/ose rehabilitimin e landfilleve rajonale të MRr në industrinë e minierave dhe metalurgji	Fundi 2019
Mbyllja dhe monitorimi i venddepozitimeve të mbetjeve në të gjitha zonat e mbetjeve	Fundi 2020
Zhvillimi i landfilleve rajonale sipas planeve të zonave të mbetjeve	Fundi 2020
Zbatimi i projekteve rehabilituese për pikat e nxehta mjedisore	Fundi 2020
Ndërtimi i impiantit të djegies për mbetjet organike familjare	Fundi 2020
Paraqitja e Skemës së Taksës së Landfillit/ Hyrjes në Landfill	Fundi 2021
Zbatimi i masave për t'u marrë me disa rryma parësore të mbetjeve	Fundi 2022
Përgatitja dhe zbatimi i projekteve për rikuperimin e territoreve të ndotura nga mbetjet	Fundi 2023

Shënim: Planet e veprimeve, të tjera nga mbetjet bashkiake, janë të hijezuara me gri në tabelë

Burimi: Plan i Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve, Projekti INPAEL

9) Burimet e financimit

Plan i Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve propozon se burimet financiare për zbatimin e planeve dhe projekteve të ndahet në dy faza, si më poshtë:

Faza financiare 1: 2010-2015,

- Buxheti i Shtetit, bashkiak apo komunal
- Para-Anëtarësimi në BE: Instrumenti për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA),
- Grantet nga donatorët e tjerë ndërkombëtarë.

Faza financiare 2: 2015-2025,

- Pas pranimit në BE: grante nga fondet strukturore ERDF dhe QS
- Kredi nga një institucion financiar ndërkombëtar (IFI), si Banka Botërore apo BERZH.
- Kredi nga një bankë tregtare
- Obligacionet e lëshuara nga organet e qeverisjes vendore
- Kapitali privat PPP nëpërmjet marrëveshjeve.

10) Kostot e Sistemit të Menaxhimit të Mbetjeve Bashkiake

Bazuar në projektimin e kostos së prodhimit të mbetjeve në të ardhmen, shuma për zbatimin e menaxhimit të mbetjeve në vend është vlerësuar në:

- Kostot themelore në 264 milionë Euro
- Kostot mesatare F&M në 64 milionë Euro në vit
- Kostot gjithsej të sistemit vjetor të mbetjeve në 101 milionë Euro në vit, (e barasvlershme me 31,6 Euro për person)

11) Rikuperimi i kostos, parimi ndotësi paguan dhe përballueshmëria

Alokimi i buxhetit në të ardhmen për menaxhimin e mbetjeve fillon me parimin ndotësi paguan. Neni 14 i Direktivës 2008/98/EC e 19 nëntorit 2008 për mbetjet dhe shfuqizimi i disa Direktivave parashikon kostot e menaxhimit të mbetjeve prodhuar nga:

- prodhuesi origjinal i mbetjeve,
- mbajtësit e tanishëm ose të mëparshëm të mbetjeve,
- prodhuesi apo distributori i produktit nga e cila erdhi mbetja.

Megjithatë, shpenzimet themelore do të kërkohen për objektet e grumbullimit, transportit dhe depozitimit, dhe QeSH (qendror, rajonal dhe vendor) do të marrë nismën për të ngritur objektet.

12) Partneritetet dhe Rolet e Grupeve të Interesit

Rolet e Grupeve të Interesit në shpërndarjen e Planit Kombëtar të Mbetjeve janë paraqitur më poshtë:

Qeveria do të:

- Sigurojë udhëheqjen, vendos drejtimin e politikës;
- Zhvilloj kuadrin rregullator dhe ligjor;
- Ofrojë financim për zbatimin e planeve të qeverive vendore që arrijnë qëllimin e këtij plani dhe të strategjisë “Deliver Value for Money”;
- Punojë në bashkëpunim me Agjencitë Mjedisore, autoritetet vendore, industrinë e mbetjeve dhe të tjera për shpërndarjen e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve;
- Nxitë me shembuj përfitimet e blerjes së produkteve të riciklueshme.

Agjencitë e Mjedisit do të:

- Ruajë kuadrin për pjesëmarrjen efektive dhe të integruar të grupeve të interesit, të vendosur nga Strategjia Kombëtare e Mbetjeve, duke përfshirë Grupet e Zonave të Mbetjeve;
- Nxitë dhe lehtësojë partneritetin midis aktiviteteve përkatëse;
- Sigurojë asistencë teknike dhe të ofrojë projekte ku është e nevojshme;
- Rregullojë, ku është e mundur, shpërndarjen e planit.

Zonat Vendore të Planit duhet të:

- Shpërndajnë Planet Zonale të Mbetjeve, duke bashkëpunuar, ku është e mundur me anëtarët e tjerë të Grupeve Zonale të Strategjisë së Mbetjeve dhe grupe të tjera;
- Alokoj burimet e nevojshme për menaxhimin e mbetjeve dhe komunikimin publik;
- Nxitë me shembuj përfitimet e blerjes së produkteve të riciklueshme, dhe
- Përgatisë Planet Zonale të Mbetjeve;

Familjet dhe objektet tregtare duhet të:

- Pakësojnë prodhimin e mbetjeve familjare, të blejnë mallra të riciklueshme dhe të shmangin mallrat e depozitueshme dhe të paketuara, kur është e mundur;
- Marrin përgjegjësinë për mbetjet e tyre dhe të njohin nevojën për objektet për administrimin e mbetjeve;
- Raportojnë për mallrat e paketuara në zyrat vendore të standardeve tregtare;
- marrin pjesë në skemat e riciklimit të autoriteteve vendore, për të veçuar, ricikluar dhe kompostuar mbetjet e tyre kur është e mundur;
- Përdorin, skemat e ngritura të furnizimit me materiale të ripërdorueshme duke përfshirë dyqanet e bamirësisë për mallrat në fund të skadencës së tyre,
- Kompostojnë materialet e duhura në shtëpi.

Prodhuesit dhe industrinë duhet të:

- Njihen me Planet Kombëtare dhe Vendore të Mbetjeve dhe sfidat dhe mundësitë që paraqiten;
- Fillojnë parandalimin e mbetjeve dhe nismat për uljen dhe të trajtojnë personelin siç duhet;
- Përmblushin detyrimet për të menaxhuar mbetjet e tyre dhe rikuperimin e burimeve, psh.,
- Kërkojnë të përdorin materiale të riciklueshme kudo ku është e leverdishme të bëhet,
- Para-trajtojnë mbetjet kur është e nevojshme, para depozitimit.

Industria e mbetjeve duhet të:

- Punojë me dhe në mbështetje me Planet Kombëtare dhe Rajonale të Mbetjeve;
- Sigurojë llojet e impianteve të nevojshme, të përshtatshme nga Planet Zonale të Mbetjeve kur punohet në bashkëpunim me autoritetet vendore;
- Punojë në bashkëpunim me të tjerët për të zhvilluar shërbime të përmirësuara dhe infrastrukturë për menaxhimin e mbetjeve jobashkiake,
- Kërkojnë përmirësime të vazhdueshme në teknologjitë që ata përdorin për menaxhimin dhe trajtimin e mbetjeve.

OJQ-të dhe sektori komunitar duhet të:

- Punojnë në bashkëpunim me autoritetet vendore, bizneset dhe industrinë e mbetjeve për të rritur përfitimet e bashkëpunimit të këtyre sektorëve duke punuar së bashku;
- Mbështesin komunitete të udhëhequra nga nisma për të rritur rikuperimin e vlerave dhe përfitimeve shoqërore nga produktet dhe materialet në fund të kohës së përdorimit të tyre;
- Ndihmojnë nxitjen e praktikave të mira në publik.

13) Marrëdhëniet me Publikun dhe Monitorimi

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve duhet t'i informohet publikut përmes:

- Seminareve Vjetore të Grupeve të Interesit;
- Publikimeve në faqe elektronike të aktiviteteve.

Planet Zonale të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve duhet të monitorohet dhe rishikohet duke përdorur këta tregues:

- Treguesit e Performancës së Infrastrukturës mjedisore,
- Treguesit financiarë,
- Treguesit Administrativë.

(3) Çështjet Ligjore dhe Institucionale në Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta

1) Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta

a) E Përgjithshme

Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta u miratua nga Qeveria Shqiptare në fund të qershorit 2011. Ligji u dërgua për miratim në Parlament në 16 shtator 2011. Presidenti i Shqipërisë komentoi Ligjin, veçanërisht për Artikullin 49, i cili është i lidhur me importin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe Ligji u dërgua përsëri në Parlament. Miratimi i Ligjit përfundimisht u bë në nëntor 2011

Ligji është përafëruar plotësisht me Direktivën e BE 2008/98/EC të menaxhimit të mbetjeve. Kjo, më pas përthith pjesërisht shumicën e direktivave të BE, vendimet dhe rregulloret, dhe siguron bazën ligjore për transferimin e saktë të të gjithë legjislacionit të BE-së në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Përveç kësaj, shumica e rregullave dhe rregulloreve të përcaktuara drejtpërdrejt dhe tërthorazi në bazë të ligjeve ekzistuese janë shkruar gjithashtu në këtë ligj. Paragrafët e mëposhtëm përshkruajnë disa nga nenet e rëndësishme, që duhet të përmbushen brenda kohës së hartimit të planit të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta për Bashkinë e Tiranës.

b) Qëllimi

Qëllimi i këtij Ligji është përshkruar në Nenin 1, në Kreun 1 si vijon:

“Neni 1 Qëllimi

1. “Të mbrojë mjedisin e shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet: a) parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve; b) përmirësimit të efikasitetit të përdorimit të tyre; c) pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.”

c) Përkufizimi i Termave

Neni 2 përcakton përkufizimet e përdorura në Ligj. Për shembull, mbetje, mbetje familjare, mbetje të rrezikshme, janë përcaktuar, por për mbetjet bashkiake, që grumbullohen nga njësitë e qeverisjes vendore nuk ka përkufizim.

d) Përparësitë e menaxhimit të mbetjeve dhe Hierarkia

Neni 6 në Kreun 1 përshkruan përparësitë e përparësive ose hierarkisë për menaxhimin e mbetjeve si më poshtë:

“Neni 6 Prioritetet e Menaxhimit të Mbetjeve

1. Ligjet e menaxhimit të mbetjeve, politikat dhe programet duhet të ndjekin hierarkinë e prioriteteve të mëposhtme:

- a) parandalimin e mbetjeve;*
- b) përgatitjen për ripërdorim;*
- c) riciklimin;*
- d) rikuperime të tjera;*
- e) asgjësimin.*

2. Për përcaktimin e kësaj hierarkie mbahen parasysh parimet e përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit, të përcaktuara në nenet 6-14 të ligjit ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe kërkesat e tjera të këtij ligji.

3. Në rastet e zbatimit të hierarkisë së menaxhimit të integruar të mbetjeve, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ministria dhe të gjitha autoritetet përkatëse marrin masa për të nxitur opsionet me rezultatet e përgjithshme më të mirat në mjedis.

4. Aktet nënligjore të veçanta për rryma të veçanta mbetjesh bazohen në hierarkinë e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, kur një gjë e tillë justifikohet nga analiza e ciklit të kohëzgjatjes së ndikimeve të përgjithshme, që vijnë nga krijimi dhe menaxhimi i këtyre mbetjeve, në mënyrë që të përftohet rezultati i përgjithshëm më i mirë për mjedisin.

Hierarkia e mbetjeve të mësipërme nuk i referohet afatit të grumbullimit të mbetjeve dhe as trajtimit të mbetjeve ose trajtimin e ndërmjetëm. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve është shërbimi më themelor në pastrimin e qytetit dhe ajo do të kryhet në kombinim me depozitimin e mbetjeve. Ndërkohë, trajtimi i mbetjeve realizuar me mbetjet për energji mund të quhet si projekt i grupuar në hierarkinë e katërt, duke

përfshirë projektin e djegies, në shkallë të vogël, vetëm me rikuperim termik për të furnizuar me ujë të nxehtë.

e) Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve

Neni 10 në Kreun 2 përshkruan se Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve duhet të veprojë në përputhje me objektivat e mbrojtjes së mjedisit dhe parimet e vendosura në Ligjin e Mbrojtjes së Mjedisit të Rajonit (Qark) dhe Planet Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve.

Në Shqipëri, vendi është ndarë në 12 Qarqe (rajone). Për të zbatuar menaxhimin e mbetjeve në vend, Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve miratoi strategjinë për zbatimin e menaxhimin e mbetjeve në 12 zona të mbetjeve bazuar në kufirin ekzistues të qarqeve. Neni 12 i Ligjit përshkruan kornizën e Planit Zonal të Menaxhimit të Mbetjeve, si dhe kuadrin e Planit për Administrimin e Mbetjeve për Bashkitë dhe komunat e veçanta.

f) Kërkesat e Përgjithshme për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve

Nenet në Kapitullin 3 përshkruajnë kërkesat e përgjithshme për zbatimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve në vend. Parimi themelor në kërkesat e përgjithshme parasheh themelimin e një Shoqërie të orientuar drejt rikuperimit të materialeve, për ruajtjen e burimeve natyrore dhe përgjegjësinë e prodhuesit të mbetjeve (prodhuesi). Ato nene në Kapitullin 3 janë:

- Neni 16; Përgjegjësia e zgjeruar e Prodhuësit,
- Neni 17; Rikuperimi i Mbetjeve,
- Neni 18; Ripërdorimi dhe Riciklimi i Mbetjeve,
- Neni 19; Asgjësimi i Mbetjeve,
- Neni 20; Kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

g) Përgjegjësia e Menaxhimit të Mbetjeve

Nenet 21 dhe 22 sipas Kapitullit 4 Menaxhimi i Mbetjeve përcaktojnë përgjegjësitë e vetë prodhuesve të mbetjeve, mbajtësit, tregtarit, operatorit ose çdo personi, që kryen trajtimin e mbetjeve. Sipas neneve, Qeveria përcakton kushtet e përgjegjësisë dhe në cilat raste prodhuesi mban përgjegjësi për trajtimin në tërësi dhe ndan edhe përgjegjësinë me mbajtësit e mbetjeve apo të deleguar ndërmjet aktorëve të ndryshëm të zinxhirit të trajtimit. Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta parashihet edhe për krijimin me instalime të mjaftueshme dhe të përshtatshme dhe të sistemit mbulon të gjitha proceset nga koleksioni në depozitimin përfundimtar.

h) Menaxhimi i Mbetjeve të Rrezikshme

Kapitulli 5 i Ligjit mbulon administrimin e mbetjeve të rrezikshme nga prodhimi, grumbullimi, ruajtja, kontrolli, përzierja, etiketimi, transferimi, etj. për t'u marrë me mbetjet e rrezikshme të krijuara nga familjet. Gjithashtu, Kapitulli 5 nuk është marrë parasysh në studimin e JICA përveç rasteve të mbetjeve të rrezikshme të tilla si bateri, llambat fluoreshente, etj. përgjithësisht të shkarkuara si mbetje të përziera nga familjet.

i) Rrjedhat e Veçantë e Mbetjeve

Nenet në Kapitullin 6 përshkruajnë mbetjet e veçanta, duke përfshirë biombetjet, mbetjet e paketimit, asgjësimin e PCB-ve, baterive dhe akumulatorëve, automjetet në

fund të jetës, mbetjet elektrike dhe elektronike, llumrat nga ujërat e zeza, të mbetjeve shëndetësore, nënproduktet e kafshëve, të mbetjeve inerte, të mbetjeve nga industritë nxjerrëse, mbetjet nga industritë e dioksidit të titaniumit, mbetjet të prodhuara nga anijet dhe mbetjet e ngarkesave, shumica e të cilave janë të krijuara ose të depozituara prej prodhuesve të tjerë të mbetjeve shtëpiake. Mbetja bio është një nga shqetësimet pasi përzihet në mbetjet shtëpiake dhe Ligji përcakton kornizën për ndarjen, kthimin dhe riciklimin për të ulur sasinë e mbetjeve bio nga vendgroposjet. Neni 28 përshkruan mbetjet bio.

j) Landfillet e Mbetjeve

Landfill është përshkruar nga Neni 43 në Nenin 46 në Kapitullin 7. Landfillet janë kategorizuar në tri (3) lloje i. e. a) landfillet për mbetjet e rrezikshme, b) landfillet për mbetjet jo të rrezikshme, dhe c) landfillet për trajtimin e mbetjeve inerte. Sipas ligjit, vetëm mbetjet subjekt i trajtimit mund të depozitohen në landfill dhe landfillet për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme mund të përdoren vetëm për mbetjet bashkiake dhe mbetjet të tjera jo të rrezikshme apo të qëndrueshme. Landfillet për trajtimin e mbetjeve inerte mund të përdoren vetëm për trajtimin e mbetjeve inerte. Ajo, gjithashtu përshkruan mbetjet që nuk mund të përdoren për landfillet të tilla, si: mbetjet e lëngshme, eksplozivë, kimike, gomat, bateri të automobilave etj.

k) Incinerimi i mbetjeve

Kusht i djegies së mbetjeve nuk është dhënë në detaje dhe Qeveria do të përshtatë rregullat dhe rregulloret me propozimin e Ministrit. Neni 47 siç citohet nga ligji e përshkruan kështu:

“Neni 47 Incinerimi i mbetjeve”

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për incinerimin e mbetjeve, përfshirë:

- a) specifikimin e kërkesave për incineratorët dhe bashkincineratorët e mbetjeve;*
- b) procedurat e pranimit të mbetjeve në incineratorë dhe bashkincineratorë;*
- c) kushtet operationale të tyre;*
- d) procedurat e kontrollit dhe të monitorimit të tyre;*
- e) procedurat e mbylljes dhe të kujdesit të mëtejshëm;*
- dh) kërkesa të tjera që duhen plotësuar kur kërkohet leje mjedisi;*
- e) kushte të tjera që duhen përfshirë në një leje mjedisi.*

l) Importi dhe Eksporti i Mbetjeve

Nga Neni 48 deri në Nenin 51 në Kapitullin 9 parashikohen kushtet për importin dhe eksportin e mbetjeve. Në vijim janë dhënë çështjet e rëndësishme nënnetet, që kanë të bëjnë me importin dhe eksportin e mbetjeve.

- Ndalohej në të gjitha rastet importimi i mbetjeve të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë.
- Vetëm mbetjet jo të rrezikshme apo mbetjet inerte mund të importohen në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Vetëm mbetjet jo të rrezikshme apo mbetjet inerte mund të kalojnë tranzit përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.

- Eksporti i mbetjeve nga Republika e Shqipërisë lejohet vetëm me autorizim të ministrit.

m) Standardet Teknike për Trajtimin e Mbetjeve

Neni 52 në kapitullin 10 përshkruan kuadrin e standardeve për trajtimin e mbetjeve që do të kryhet nga qeveria me propozim të ministrit. Normat teknike minimale, për tu miratuar:

- jepen për ndikimet kryesore në mjedis të shkaktuara nga impiantet e trajtimit të mbetjeve;
- sigurojnë që mbetjet të trajtohen në përputhje me këtë ligj dhe në veçanti me nenin 5 të tij;
- marrin në konsideratë teknikat më të mira të disponueshme;
- në rast se është e përshtatshme përfshijnë elemente, që lidhen me cilësinë e trajtimit dhe kërkesat e procesit.

n) Leje Mjedisore për Trajtimin e Mbetjeve

Neni 53 në Kapitullin 11 përshkruan kërkesat për marrjen e një leje mjedisore për trajtimin e mbetjeve. Ai thekson se çdo person, që ka qëllim të kryejë aktivitetet e trajtimit të mbetjeve duhet të marrë lejen përkatëse mjedisore në përputhje me Ligjin për Lejet e Mjedisit.

o) Leja e Veprimtarive për Menaxhimin e Mbetjeve

Nenet 58 dhe 59 përshkruajnë lejen dhe kërkesat e tij nga çdo person, që dëshiron të transportojë mbetjet ose të veprojë si tregtar dhe agjent i mbetjeve. Këto kërkesa janë:

- Licenca duhet të jetë e vlershme për një periudhë trevjeçare;
- Licenca lëshohet nga Qendra Kombëtare e Licencimit pas miratimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit,
- Qeveria, me propozim të Ministrit, miraton rregullore për zbatimin e këtij neni.

p) Të tjera

Ligji, gjithashtu përshkruan nxjerrjen e raportit të statistikave të mbetjeve, ndalimin, sanksionet, ndëshkimet dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare në nenet nga kapitujt 13-16.

2) Konfigurimi institucional përcaktuar në Ligjin për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta

Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta përcakton funksionet, rolet dhe përgjegjësitë e organizatave përkatëse siç është përmbledhur në Tabelën 5.3.2.

Tabela 5.3.2 Funksionet e Organizatave, që lidhen me Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta

Organizatave	Autoritetet, Funksionet, Rolet, Përgjegjësitë
Këshilli i Ministrave	- mund të miratoj masat për të përcaktuar kriteret për lëndë specifike ose objekteve, që duhen quajtur si një produkt dhe jo si mbetje, - duhet të miratoj Katalogun e mbetjeve,

Organizatrat	Autoritetet, Funksionet, Rolet, Përgjegjësitë
	- Miraton Planin Kombëtar, Rajonal dhe vendor të Menaxhimit të Mbetjeve dhe të miratojë masa të hollësishme për zbatimin, - Miraton masat për programet e parandalimit të mbetjeve, - Duhet të miratojë masat për të siguruar përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit, - Mund të vendosë nëse kostot e menaxhimit të mbetjeve duhet të përballohen pjesërisht ose plotësisht nga prodhuesit e mbetjeve, shpërndarësit dhe prodhuesit për të ndarë këto shpenzime. - Miraton rregullat për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme, duke përfshirë kërkesat për informacionin, që duhet të përfshihen në një raport të transferimit të mbetjeve, - Miraton objektivat dhe afatet për të përmbushur këto objektiva për të ulur sasinë e mbetjeve bio, që shkojnë në landfill, - Do të miratojë masat për të parandaluar prodhimin e mbetjeve të paketimit me anë të ndërtimit të sistemeve për ripërdorim ose ripërpunimin e mbetjeve të paketimit, - Miraton kërkesat për llojet e mbetjeve, që mund të pranohen në landfille të klasave ndryshme, - Me propozim të Ministrit, miraton kërkesat për operimin e landfilleve, duke përfshirë procedurat e pranimit të mbetjeve; kontrollit dhe procedurave të monitorimit , etj. - Do të zbatojë role të tjera të përcaktuara me ligj.
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (Ministri)	- Duhet të përgatisë dhe publikojë një projekt të Planit për Menaxhimin e Mbetjeve, në faqen e internetit të Ministrisë dhe të bëjë atë të zotërueshme nga publiku dhe gjithashtu të shpërndajë projektin e Planit Kombëtar për Administrimin e Mbetjeve , me ministritë përkatëse për komente. Projekti përfundimtar i Planit Kombëtar për Administrimin e Mbetjeve është dorëzuar në Këshillin e Ministrave për miratim. - Raporton çdo vit në Këshillin e Ministrave për zbatimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve, - Duhet të nxitë ripërdorimin e produkteve dhe të përgatitet për aktivitetet e ripërdorimit - Duhet të përshtatë masat për zbatimin e ligjit në veçanti të rikuperimit të kostove nga prodhuesi origjinal i mbetjeve ose nga mbajtësi i tanishëm ose i mëparshëm i mbetjeve - Ndalon ose kufizon importin e mbetjeve të paracaktuara tek incineratorët, që janë klasifikuar si rikuperim - Duhet që, çdo 3 vjet, të përgatisë një raport për gjendjen e zbatimit të ligjit, duke përfshirë aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.
Ministria e Financës	- Duhet të përshtatë masat për zbatimin e politikave të menaxhimit të mbetjeve të përballohen nga prodhuesi origjinal i mbetjeve ose nga mbajtësi i tanishëm ose i mëparshëm i mbetjeve
Ministria e Bujqësisë	- Miraton kërkesat për përdorimin e llumrave nga ujërat e zeza në bujqësi në mënyrë që të parandalojnë efektet e dëmshme në tokë, bimësisë, kafshëve dhe njerëzve, - Miraton kërkesat për menaxhimin e nënprodukteve të kafshëve jo të destinuara për konsum njerëzor,
Ministria e Shëndetësisë	- Duhet të përshtatë kërkesat për menaxhimin e Mbetjeve Mjekësore;
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit	- Duhet të përshtatë kërkesat për menaxhimin e Mbetjeve Inerte - Duhet të përshtatë kërkesat për të parandaluar ose ulur shkarkimet e mbetjeve nga anijet ose mbetjet nga ngarkesat në det
Agjencia Kombëtare e Mjedisit	- Mund të kërkojë nga secili transferues dhe marrës të dhënat e transfertave të mbetjeve jo të rrezikshme, - Duhet të marrë nga çdo transferues dhe marrës, një herë në vit, informacion për transfertat e mbetjeve jo të rrezikshme, - Lëshon autorizimin për kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme apo të mbetjeve inerte, - Të kundërshtojë të japë një leje mjedisore nga pikëpamja e mbrojtjes së mjedisit, - Të kryejë inspektime të instalimeve në përputhje me dispozitat e Ligjit "Për Mbrojtjen e Mjedisit", - Miraton lejen e transportit të mbetjeve, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, - Miraton lejen e transportit të mbetjeve për tregtarin ose agjentin e mbetjeve lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, - Duhet të mbajë dhe përditësoj deri në datën e statistikave mbi gjenerimin, rikuperimin, dhe asgjësimin e mbetjeve
Qarku	- Harton planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

Organizatrat	Autoritetet, Funksionet, Rolet, Përgjegjësitë
	- Miraton rregullat për kontrollin e menaxhimit të rrymave të veçanta të mbetjeve bashkiake - Raporton çdo vit ministrisë për zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe të planeve rajonale apo vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin nën juridiksionin e vet - Publikojnë projektplanet përkatëse në faqet zyrtare të internetit dhe i vënë ato në dispozicion të publikut - Miraton planet përkatëse rajonale apo vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Këshilli i qarkut apo i njësisë së qeverisjes vendore, kur miraton planin përkatës, merr në shqyrtim rezultatet e vlerësimit strategjik mjedisor - Miraton Planet Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve
Njësitë e Qeverisjes Vendore (NjQV) /Grupe të NjQV-ve	- Duhet të përshtatin planin e menaxhimit të mbetjeve në përputhje me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve, - Mund të përshtatin rregullat, që kontrollojnë menaxhimin e mbetjeve të veçanta duke përfshirë letrën & kartonin, qelq, kontejnerët e ushqimit dhe pijeve, metale, plastike, ose gjethë sipas miratimit nga Qarku. - Duhet të raportoj çdo vit në Qarqet përkatëse për zbatimin e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve; - Duhet të publikoj një projekt të Planit dhe ta bëj të mundshëm për publikun përmes faqes elektronike të qeverisë vendore; - Duhet të miratoj planin përkatës, por duhet të marrë parasysh rezultatet e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM), përpara miratimit të tij

Burimi: Ligji mbi Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2011

5.3.2. Gjetje nga Studime dhe Kërkime të Mëparshme

(1) Plani i Menaxhimit të Mbetjeve për Zonën e Tiranës

1) Zonat e Synuara për Planin e Menaxhimit të Mbetjeve për Tiranën

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve për Tiranën u formulua në kuadrin e projektit INPAEL ndihmuar nga BE-ja dhe iu dorëzua qeverisë shqiptare më 2 korrik 2010. Zona e mbetjeve e Tiranës përfshin vetëm dy rrethe; Tiranën dhe Kavajën. Qarku i Tiranës ka tri bashki, Tiranë, Kamëz dhe Vorë dhe 16 komuna. Qarku i Kavajës ka dy bashki: Kavajën dhe Rogozhinën, dhe 8 komuna. Popullsia rezidente në këtë zonë të mbetjeve është vlerësuar në rreth 1 milion.

2) Objektivat e Veçanta të Zonës së Mbetjeve

Raporti shpjegon dhe propozon objektivat e veçantë të mëposhtëm për t'u përfshirë në formulimin e Planit të Menaxhimit të Mbetjeve për Zonën e Tiranës.

- Përshtatja e standardeve ligjore të Komunitetit Evropian.
- Forcimi i Legjislacionit Mjedisor.
- Investime në mbrojtjen e mjedisit.
- Mbështetja Financiare dhe Infrastruktura Mjedisore.
- Menaxhimi i burimeve mjedisore.
- Përmirësimi i komunikimit dhe i ndërgjegjësimi
- Përmirësimi i sistemit të monitorimit
- Menaxhimi i mbetjeve
- Mbetjet dhe të dhënat për mbetjet

3) Plan i Veprimit, Masat për Arritjen e Objektivave

a) Përshkrimi i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve për Zonën e Tiranës

Raporti i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve për Tiranën përsërit planet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta duke ju referuar pjesës më të madhe të sektorëve të Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve. Planit për Zonën e Mbetjeve të Tiranës përshkruhet specifikisht vetëm në Kapitullin 3. Tabela 5.3.3 përshkruan veprimet e Planit të Menaxhimit të Mbetjeve për Tiranën për Zonën e Mbetjeve të Tiranës për të qenë në përputhje me objektivat e vendosur në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve.

Tabela 5.3.3 Plan i Menaxhimit të Mbetjeve për Tiranën në Përputhje me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve

Nr.	Plan i Veprimit	Përshkrimi	Afatet kohore
1.	Vlerësim i prodhimit të Gazit në Landfillin Sharra I	Vlerësim i prodhimit të gazit nga landfilli Sharra I dhe projektim i metodologjisë së kapjes së gazit në retrospektivën e mbledhjes dhe përdorimit të gazit, që prodhohet tani.	Mbaron në 2010
2.	Planet vendore për menaxhimin e mbetjeve	Në të gjitha bashkitë dhe komunat duhet të zhvillohet dhe publikohet një plan vendor për menaxhimin e mbetjeve, që përshkruan veçantitë e operacioneve të menaxhimit të mbetjeve dhe kërkesat e infrastrukturës për të përmbushur normat e planit Kombëtar të menaxhimit të mbetjeve. Duhet të ngrihet një Grup i Zonës së Mbetjeve dhe duhet të ndërmerret një auditim për menaxhimin ose performancën dhe sasinë e mbetjeve	Mbaron në 2011
3.	Studim i fizibilitetit për variantin e trajtimit përfundimtar	Zona e mbetjeve, nëpërmjet Këshillit të Qarkut ose Bashkisë së Tiranës, duhet të zhvillojë strukturën e një projekti pilot për studimin e fizibilitetit për një zgjidhje përfundimtare për trajtimin e mbetjeve. Ky mund të jetë një përafrim i kësaj zone të mbetjeve ose i shumë zonave të mbetjeve siç përshkruhet në këtë plan. Në të gjitha rastet duhet të përfshijë një studim fizibiliteti të qëndrueshëm për përdorimin e fabrikës ekzistuese të çimentos në Fushë – Krujë.	Mbaron në 2011
4.	Zbatim i sistemit me tre kosha	Të gjitha bashkitë duhet të fillojnë zbatimin e sistemit të grumbullimit me tre kosha që duhet të paraprihet nga një fushatë e qartë njoftuese për publikun përfshirë burimet e edukimit.	Mbaron në 2012
5.	Ngritje e impianteve të riciklimit të mbetjeve për mbetjet e thata të riciklueshme	Të gjitha bashkitë duhet të ngrënë infrastrukturën për të lehtësuar riciklimin e pjesës së thatë të riciklueshme të mbetjeve të mbledhura dhe të riciklueshme	Mbaron në 2012
6.	Ngritje e impianteve të kompostimit në nivel bashkiak (qendror) dhe komunal (vendor)	Të gjitha bashkitë dhe komunat duhet të zbatojnë kompostimin e të gjitha mbetjeve të biodegradueshme të mbledhura me anë të sistemit të tre koshave. Impiantet në nivel komune mund të jenë të bazuara në nivel rajonal ose vendor, dhe bashkitë duhet të ofrojnë gjithmonë të njëjtat variante. Nisma duhet të paraprihet nga një fushatë e qartë informative për publikun përfshirë burimet e edukimit.	Mbaron në 2012
7.	Identifikim i projekteve parësore për rrymat e mbetjeve	Bashkitë dhe qarku duhet të identifikojnë së bashku dhe të zhvillojnë projekte për tu marrë me rrymat parësore të mbetjeve siç përshkruhet në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve.	Mbaron në 2013

b) Sistemi i Grumbullimit

Plani propozon për të futur mbledhjen e ndarë të mbetjeve bashkiake nëpërmjet sistemit me tre kontejnerë të vendosur në zonën e grumbullimit për shkarkimin e llojeve të ndryshme të mbetjeve në çdo kontejner me ngjyrë të caktuar si më poshtë:

- Kosh ngjyrë kafe ose të gjelbër për materialin e kompostueshëm organik,
- Kosh blu për materialet e thata te riciklueshme,
- Kosh i zi për mbetjet e tjera bashkiake.

c) Impiantet e Menaxhimit të Mbetjeve

Plani përshkruan se çdo autoritet i zonës së grumbullimit të mbetjeve do të shërbehet nga impiantet e riciklimit, kompostimit dhe pikat e mjaftueshme të grumbullimit të mbetjeve duke përshtatur sistemin me tre kontejnerë. Hollësitë e impianteve të menaxhimit të mbetjeve do të përshkruhet në planet e mbetjeve vendore.

d) Përgjegjësitë e Çdo Organizate Vendore

Plani i Zonës së Mbetjeve të Tiranës përshkruan përgjegjësitë e këshillave të bashkive, komunave dhe Qarqeve për zbatimin e aktiviteteve të menaxhimit të mbetjeve siç propozohet në rolet e mëposhtme:

Shërbimet dhe/ose Impiantet nga Bashkitë dhe Komunitat

- Autoritet i grumbullimit të mbetjeve,
- Impiantet e riciklimit dhe kompostimit.

Impiantet Rajonale

- Vendet e landfillit,
- Impiantet e mbetjeve në energji.

Qarku

- Organ koordinues për aktivitetet e grupit të zonës së mbetjeve,
- Raportimi i të dhënave të mbetjeve nga bashkitë dhe komunitat në Ministrinë e Mjedisit, çdo vit.

e) Kostot Ekonomike dhe Financimi

Kostoja për zbatimin e Planit të Zonës së Mbetjeve të Tiranës nuk është vlerësuar në Raport, por kostot e mëposhtme në Tabelën 5.3.4 tregojnë një referencë për koston e një zone mesatare të mbetjeve me një popullsi prej 300 000 banorësh.

Tabela 5.3.4 Kostoja e Menaxhimit të Mbetjeve për një Bashki me Popullatë 300 000 banorë

Komponenti	Kostot e përgjithshme(€)	Kostot F&M(€)	Kostot vjetore të përgjithshme (€/v)
Grumbullim i veçuar i të riciklueshmeve	3,308,533	1,791,703	2,247,540
Grumbullim i mbetjeve Bio	982,490	687,201	816,295
Grumbullim i mbetjeve	982,490	1,051,817	1,180,910
Stacionet e transferimit	1,350,000	127,800	106,611
Transporti në landfill	0	262,186	262,186
Landfill	7,800,000	500,000	1,659,985
Impiantet e veçimit	1,500,000	250,000	515,192
Impiantet e kompostimit	8,120,000	1,124,000	2,383,649
TA, fushatat e njoftimit dhe ndërgjegjësimi (5%)	2,404,351		
Shuma për një zonë "mesatare" të mbetjeve	24,043,512	5,794,707	9,172,368

Burimi: Plan i Menaxhimit të Mbetjeve për Zonën e Tiranës, Projekti INPAEL

Plani propozon një alokim të buxhetit të menaxhimit të mbetjeve në të ardhmen përmes parimit: ndotësi paguan me referencë Nenin 14 të Direktivës së Mbetjeve 2008/98/EC të 19 nëntorit 2008 dhe shfuqizimi i disa Direktivave. Ai siguron kostot e menaxhimit të mbetjeve, lindur nga:

- prodhuesi origjinal i mbetjeve,
- mbajtësi aktual ose i mëparshëm i mbetjeve, dhe
- prodhuesi ose shpërndarësi i produktit nga vijnë mbetjet.

(2) Vlerësimi Paraprak i Depozitimit të Mbetjeve të Ngurta në Tiranë

1) E përgjithshme

Raporti është përgatitur dhe dorëzuar në BT në mars 2010 nga IFC (Korporata Financiare Ndërkombëtare), një nga organizatat e Grupit të Bankës Botërore. Raporti përmbledh gjetjet kryesore dhe rekomandimet e propozuara për aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta të BT për këto çështje:


- Për kuadrin ligjor dhe regjimin rregullator, legjislacionin e paplotë, rregulloret dhe përkufizime jokonsistente;
- Mungesa e standardeve mjedisore për grumbullimin e mbetjeve, transportimi dhe depozitimi;
- Mungesa e planit kombëtar, planet vendore dhe strategjitë kombëtare për mbetjet;
- Vlerësimi i jetës së mbetur operative të Sharrës me opsione për kapacitete të reja depozitimi;
- Përcaktimi i venddepazitimit të ri;
- Pjesëmarrja e Sektorit Privat: Nevoja për Ristrukturimin dhe reformë sektoriale.

Deri më sot, që nga paraqitja e raportit nga IFC, shumica e çështjeve dhe rekomandimeve janë marrë parasysh në Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve, Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve, dhe Ligjin për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta. Gjithsesi, një nga çështjet kyç të BT, si depozitimi përfundimtar, nuk është zhvilluar ende në një plan konkret për të zgjidhur fundin e jetëgjatësisë së Sharrës, në të ardhmen. Paragrafët në vijim pasqyrojnë

gjetjet dhe rekomandimet për depozitimin e mbetjeve në raportin IFC.

2) Vlerësimi i Jetës së Venddepozitimit të Mbetjeve, Sharrë

Raporti i IFC-së ka kryer vlerësimin e jetëgjatësisë së Landfillit të Sharrës bazuar në lakoren e prirjes së projektuar në periudhën 2009-2030. Faktorët për projektimin janë: sasia e prodhimit/grumbullimit vjetor të mbetjeve si rezultat i popullsisë në të ardhmen, sasia e prodhimit/grumbullimit për person në ditë dhe vëllimi i vlefshëm i landfillit afërsisht në 1,65 milionë metër kub (m^3). Popullsia e vlerësuar, sasia e mbetjeve të prodhuara/grumbulluara për person dhe sasia ditore e mbetjeve të prodhuara/grumbulluara janë 791,800 tonë/ditë, 0,85kg, 673 tonë/ditë në 2009 dhe 1,172,000 tonë/ditë, 1,0 kg dhe 1,172 ton/ditë në 2030, respektivisht. Sipas kësaj llogaritjeje, Venddepozitimi i Sharrës do të ketë jetë deri në fund të 2015 siç tregohet në Figurën 5.3.1.



Burimi: Figure 11, Vlerësimi Paraprak i Depozitimit të Mbetjeve të Ngurta në Tiranë, Mars 2010, IFC

Figure 5.3.1 Jetëgjatësia e mbetur e Venddepozitimit të Mbetjeve Sharrë

3) Opsionet për Kapacitetet e Reja të Depozitimit

Raporti i IFC-së paraqet propozimet për venddepozitimet alternative, në të ardhmen listuar si më poshtë:

- zgjerimi i landfillit të tanishëm të Sharrës;
- përcaktimi i një vendi të ri për impiantin e ri bashkiak të depozitimit të mbetjeve;
- pjesëmarrja në një impiant depozitimi nën një bashkëpunim rajonal.

4) Pjesëmarrja e Sektorit Privat dhe Tarifimi për Mbetjet

Raporti i IFC-së këshillon zbatimin e projektit të landfillit përmes partneritetit publik-privat dhe paraqitja e një tarifimi të mbetjeve të përfituesit bazuar në parimin e mbulimit të kostos, dhe me zëra të ndarë për shërbimin e grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve.

(3) Projekti i Landfillit të Sharrës

Gjashtë (6) milionë euro është financuar nga Koperacioni Italian në formë kredie për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Tiranë. Ky projekt synon largimin e gazeve të landfillit nga Sharra dhe mënjanimin e ndotjes

shkaktuar nga shllami në venddepozitimin e mbetjeve, përveç zgjerimit të Landfillit të Sharrës. Prandaj, projekti përfshin studimet paraprake dhe të fizibilitetit, projektimin e detajuar, zgjerimin e Venddepozitimit të Sharrës, furnizimi me pajisje dhe mjete për funksionimin dhe menaxhimin e landfillit dhe një seri trajnimesh për forcuar kuadrin ligjor dhe organizativ të menaxhimit të mbetjeve të ngurta të BT. Landfilli i Sharrës ka zgjeruar qelizat e reja dhe ka filluar punën, që nga 2009, edhe pse disa nga objektet si peshorja e mjeteve dhe impiantet e djegies së biogazit janë ende në proces ndërtimi, që prej nëntorit 2011. Landfilli në qelizën e re pritet të zgjasë deri në 2015/2016.

(4) Plani Rregullues Urban

Plani Rregullues Urban i Tiranës i përgatitur në dhjetor 2008 tregon Venddepozitimin e Sharrës për vendin e objekteve publike, por nuk paraqet një plan për menaxhimin e mbetjeve të ngurta.

5.3.3. Aktivitetet e Donatorëve të Tjerë për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta

Sa i përket menaxhimit të mbetjeve të ngurta, agjencitë donatore ndërkombëtare po ndihmojnë në zbatimin e planit kombëtar për përafrimin e legjislacionit mjedisor me direktivat e BE për projektet e landfillit. Tabela 5.3.5 tregon studimet apo projektet, që lidhen me menaxhimin e mbetjeve të ngurta kryer me ndihmën e agjencive donatore ndërkombëtare.

Tabela 5.3.5 Përmbledhje e Aktiviteteve të Donatorëve në MMN

Organizata	Projekti	Statusi
BE	Strategjia Kombëtare e Mbetjeve (2010)	Strategjia Kombëtare e Mbetjeve është miratuar nga Qeveria
BE	Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve (2010)	Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve është miratuar nga Qeveria
BE	Plani i Zonës së Mbetjeve të Tiranës (2010)	Plani i Zonës së Mbetjeve të Tiranës nuk miratuar ende.
IFC	Vlerësimi Paraprak i Depozitimit të Mbetjeve të Ngurta në Tiranë (2010)	IFC kërkon të nxitë projektin e propozuar në raport.
KfW	Studimi i Fizibilitetit dhe Projektimi i Detajuar për Ndërtimin e Landfillit Rajonal	600 000 Euro për S/F dhe një tjetër 600 000 Euro janë alokuar për projektin. TeR janë përgatitur në fund të dhjetorit 2011 dhe pritet të punësohet një firmë konsulente në mars 2012.
Kooperacioni Italian	Mbyllja e Venddepozitimit të vjetër të Sharrës dhe Zgjerimi i Qelizave të Reja të Landfillit (2008 – 2011)	Venddepozitimi i vjetër i mbetjeve ishte mbyllur dhe zgjerimi i qelizës së re ka përfunduar pothuaj dhe filluar landfilli i ri. Instalimi i objekteve përkatëse si peshorja e mjeteve dhe impiantet e djegies së biogazit janë ende në proces me kredinë 6 milionë Euro nga Kooperacioni Italian.

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

5.4. Analiza e Kërkesës Sasiore për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta

5.4.1. Vlerësimi i Sasisë së Mbetjeve të Ngurta

(1) Zona e Shërbimit Objektiv i Studimit


Vlerësimi i popullsisë dhe sasisë së mbetjeve të ngurta për zonën e shërbimit të përcaktuar, janë parimet bazë për planifikimin e çdo strukture të lidhur me mbetjet. Vlerësimi rezultues, prek në mënyrë domethënëse përmasën e strukturave dhe pajisjet, projektimin, fazat e projektit dhe kostot e projektit. Bashkia e Tiranës është e ndarë në 12 minibashki dhe shërbimi i tanishëm i grumbullimit i kryer për 6 zona të grumbullimit të mbetjeve, mbulon pothuaj gjithë zonën administrative. NjQV-a është përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve brenda zonës së tij të juridiksionit ose zonës administrative, sipas ligjeve përkatëse. Prandaj, zona objektive për vlerësimin e sasisë së mbetjeve të prodhuara është përcaktuar brenda zonës administrative të BT-së.

(2) Ecuaria e Vlerësimit të Sasisë së Mbetjeve të Ngurta

Në mënyrë që të vlerësohet sasia e prodhimit të mbetjeve, të dhënat e popullsisë, të dhënat e GIS dhe të dhënat e marra nga vërtetimi i sasisë së mbetjeve dhe përbërja, kryer nga ekipi i studimit JICA janë shfrytëzuar dhe vlerësimi ka ndjekur procedurat e paraqitura në Figurën 2.2.1. Sasia e mbetjeve është vlerësuar së pari, për sasinë e mbetjeve në familje përveç vlerësimin e mbetjeve nga qendrat tregtare duke përfshirë: biznesin, institucionet dhe burime të tjera të prodhimit të mbetjeve. Hollësitë e vlerësimit të sasisë së mbetjeve janë shpjeguar më poshtë.

1) Popullsia e Planifikuar e BT

Bazuar në të dhënat e tanishme të popullsisë së vitit 2011, të marra nga Grupi Teknik i Planit Rregullues të BT, popullsia në të ardhmen në BT dhe minibashkitë përkatëse janë vlerësuar dhe pasqyruar në Tabelën 5.4.1. Rritja vjetore e popullsisë ishte supozuar në 3,0%, 2,5% dhe 2,0% për çdo pesë vite, duke filluar nga 2011. Si rezultat i parashikimit të popullsisë, popullsia e përgjithshme e BT rritet nga 562 439 në vitin 2011 në 841 361 në 2027. Popullsia e vlerësuar dhe planifikuar zakonisht është përdorur si bazë për planifikimin e infrastrukturës urbane duke përfshirë rrugët dhe trafikun, furnizimin me ujë, kanalizimet, dhe menaxhimin e mbetjeve të ngurta.



Burimi: Ekipi studimor i JICA-s

Figura 5.4.1 Procedurat për Vlerësimin e Sasisë së Mbetjeve Bashkiake

Tabela 5.4.1 Popullsia e Planifikuar në Minibashkitë (2011-2027)

Minibashkitë	Popullsia e Parashikuar në Minibashkitë																
	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Minibashkia -1	35 678	36 855	38 102	39 348	40 594	41 840	43 087	44 285	45 483	46 681	47 879	49 077	50 154	51 232	52 309	53 386	54 464
Minibashkia -2	83 619	86 379	89 007	91 634	94 262	96 890	99 518	101 942	104 367	106 792	109 217	111 642	113 749	115 857	117 965	120 073	122 181
Minibashkia -3	36 496	37 700	38 900	40 101	41 301	42 501	43 701	44 846	45 991	47 136	48 281	49 426	50 448	51 471	52 494	53 517	54 540
Minibashkia -4	47 013	48 564	49 798	51 032	52 266	53 500	54 734	55 881	57 028	58 176	59 323	60 470	61 474	62 478	63 481	64 485	65 489
Minibashkia -5	76 268	78 785	80 390	81 995	83 600	85 204	86 809	88 271	89 732	91 194	92 655	94 117	95 374	96 631	97 889	99 146	100 403
Minibashkia -6	59 506	61 470	63 684	65 897	68 111	70 325	72 538	74 685	76 831	78 977	81 124	83 270	85 213	87 157	89 100	91 044	92 987
Minibashkia -7	62 365	64 423	66 746	69 069	71 392	73 715	76 038	78 291	80 543	82 796	85 049	87 302	89 342	91 382	93 422	95 462	97 503
Minibashkia -8	36 856	38 073	39 275	40 478	41 681	42 884	44 087	45 233	46 379	47 526	48 672	49 818	50 842	51 865	52 889	53 912	54 935
Minibashkia -9	48 041	49 626	51 979	54 331	56 684	59 036	61 389	63 770	66 151	68 532	70 913	73 295	75 528	77 761	79 995	82 228	84 461
Minibashkia -10	23 520	24 296	24 816	25 335	25 855	26 374	26 894	27 369	27 844	28 319	28 794	29 269	29 679	30 089	30 499	30 909	31 319
Minibashkia -11	53 077	54 828	56 812	58 795	60 778	62 761	64 744	66 668	68 592	70 516	72 439	74 363	76 106	77 849	79 592	81 335	83 078
Shuma	562 439	581 000	599 509	618 015	636 524	655 030	673 538	691 241	708 941	726 645	744 346	762 047	777 909	793 772	809 635	825 497	841 361

Burimi: Ekipi studimor i JICA-s

2) Popullsia e Planifikuar e Zonave të Shërbimit të Grumbullimit të Mbetjeve

Zona e minibashkisë dhe zona e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve janë mbivendosur me njëra-tjetrën pra, një zonë shërbimi e grumbullimit është e ndarë nga rrjeti rrugor dhe mbulon zonat e disa minibashkive. Tabela 5.4.2 tregon matricën e sipërfaqes së katit të banimit të minibashkive dhe zonat e grumbullimit. Tabela 5.4.3 tregon raportin e llogaritur nga Tabela 5.4.2. Popullsia, të cilës i shërbehet në secilën zonë të grumbullimit nga popullsia e minibashkive është llogaritur në Tabelën 5.4.1 dhe raporti i sipërfaqes së katit të banimit për familjet/jo familjet në Tabelën 5.4.3 dhe treguar në Tabelën 5.4.4 dhe Figurën 5.4.2. Popullsia e planifikuar për grumbullim në gjashtë zonat e shërbimit luhet nga 77 000 në 138 000 në 2012. Kjo rritet në nivelin e 111 000 në 190 000 në 2027, e ndiqet nga zona Lindore 3 e grumbullimit, që tregon 106 000 dhe 151 000, respektivisht në 2012 dhe 2027.

Tabela 5.4.2 Sipërfaqja e Katit Rezidencial dhe jo-Rezidencial në Zonën e Grumbullimit të Mbetjeve

Mini-bashkia	Zona e Grumbullimit Lindore-1		Zona e Grumbullimit Lindore-2		Zona e Grumbullimit Lindore-3		Zona e Grumbullimit Perëndimore-1		Zona e Grumbullimit Perëndimore-2		Zona e Grumbullimit Perëndimore-3		Totali	
	Zona e Rezidenciale	Zona jo-Rezidenciale	Zona e Rezidenciale	Zona jo-Rezidenciale	Zona e Rezidenciale	Zona jo-Rezidenciale	Zona e Rezidenciale	Zona jo-Rezidenciale	Zona e Rezidenciale	Zona jo-Rezidenciale	Zona e Rezidenciale	Zona jo-Rezidenciale	Zona e Rezidenciale	Zona jo-Rezidenciale
No.1	0	0	109,195	2,107	1,194,902	186,402	0	0	0	0	0	0	1,304,097	188,509
No.2	0	0	563,205	207,738	2,624,662	565,159	0	0	0	9,492	1,553	8,892	3,189,420	791,281
No.3	2,027	5,559	1,345,637	238,377	19,349	0	0	0	0	0	0	0	1,367,013	243,936
No.4	1,519,906	247,730	360,656	149,631	0	0	0	0	0	0	0	0	1,880,562	397,361
No.5	0	0	0	0	5,154	1,814	0	0	17,897	4,997	2,639,330	565,697	2,662,381	572,508
No.6	0	0	0	0	0	0	0	0	47,871	149	1,419,971	433,334	1,467,842	433,483
No.7	0	0	0	0	0	0	9,850	7,267	2,377,962	516,948	736	0	2,388,548	524,215
No.8	831,984	213,463	496,228	69,578	0	0	0	0	0	0	0	0	1,328,212	283,041
No.9	531,268	138,005	3,176	19,530	0	0	1,373,842	375,854	57	0	0	0	1,908,343	533,389
No.10	0	0	0	0	0	0	119,555	19,917	731,038	203,280	0	0	850,593	223,197
No.11	0	0	0	0	0	0	1,887,479	427,518	0	0	0	0	1,887,479	427,518
Total	2,885,185	604,757	2,878,097	686,961	3,844,067	753,375	3,390,726	830,556	3,174,825	734,866	4,061,590	1,007,923	20,234,490	4,618,438

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Tabela 5.4.3 Raporti i Katit Rezidencial dhe Jo-Rezidencial në Zonën e Grumbullimit të Mbetjeve


Mini-bashkia	Zona e Grumbullimit Lindore-1		Zona e Grumbullimit Lindore-2		Zona e Grumbullimit Lindore-3		Zona e Grumbullimit Perëndimore-1		Zona e Grumbullimit Perëndimore-2		Zona e Grumbullimit Perëndimore-3		Totali	
	Zona e Rezidenciale	Zona jo-Rezidenciale	Zona e Rezidenciale	Zona jo-Rezidenciale	Zona e Rezidenciale	Zona jo-Rezidenciale	Zona e Rezidenciale	Zona jo-Rezidenciale	Zona e Rezidenciale	Zona jo-Rezidenciale	Zona e Rezidenciale	Zona jo-Rezidenciale	Zona e Rezidenciale	Zona jo-Rezidenciale
No.1	0.00%	0.00%	8.37%	0.05%	91.63%	4.04%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	4.08%
No.2	0.00%	0.00%	17.66%	4.50%	82.29%	12.24%	0.00%	0.00%	0.00%	0.21%	0.05%	0.19%	100.00%	17.13%
No.3	0.15%	0.12%	98.44%	5.16%	1.42%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	5.28%
No.4	80.82%	5.36%	19.18%	3.24%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	8.60%
No.5	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.19%	0.04%	0.00%	0.00%	0.67%	0.11%	99.13%	12.25%	100.00%	12.40%
No.6	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	3.26%	0.00%	96.74%	9.38%	100.00%	9.39%
No.7	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.41%	0.16%	99.56%	11.19%	0.03%	0.00%	100.00%	11.35%
No.8	62.64%	4.62%	37.36%	1.51%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	6.13%
No.9	27.84%	2.99%	0.17%	0.42%	0.00%	0.00%	71.99%	8.14%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	11.55%
No.10	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	14.06%	0.43%	85.94%	4.40%	0.00%	0.00%	100.00%	4.83%
No.11	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	9.26%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	9.26%
Total	-	13.09%	-	14.87%	-	16.31%	-	17.98%	-	15.91%	-	21.82%	-	100.00%

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Tabela 5.4.4 Popullsia e Planifikuar e Zonave të Grumbullimit të Mbetjeve

Zona e Grumbullimit	Të Dhënat e 2011				Popullsia e Parashikuar në Zonën e Grumbullimit																
	Sip. (Km ²)	Popullsia 2011	Densiteti Popullsisë (për Km2)	Përqindja e Popullsisë së Zonës së Grumbullimit (%)	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	
Lindore-1	5.41	74,511	13,773	13.25%	76,970	79,378	81,785	84,193	86,600	89,008	91,317	93,627	95,937	98,247	100,557	102,632	104,708	106,784	108,859	110,935	
Lindore-2	4.04	76,544	18,947	13.61%	79,070	81,510	83,950	86,390	88,829	91,269	93,577	95,885	98,192	100,500	102,808	104,856	106,904	108,952	111,000	113,048	
Lindore-3	11.74	102,167	8,703	18.17%	105,539	108,864	112,188	115,513	118,837	122,161	125,274	128,386	131,498	134,610	137,722	140,461	143,200	145,938	148,677	151,416	
Perëndimore-	7.04	91,225	12,958	16.22%	94,236	97,995	101,754	105,514	109,273	113,032	116,746	120,460	124,175	127,889	131,603	135,020	138,437	141,853	145,270	148,687	
Perëndimore-	4.33	84,775	19,579	15.07%	87,573	90,416	93,259	96,101	98,944	101,787	104,519	107,250	109,982	112,713	115,445	117,901	120,357	122,813	125,269	127,725	
Perëndimore-	6.87	133,216	19,391	23.69%	137,612	141,346	145,080	148,813	152,547	156,281	159,807	163,333	166,860	170,386	173,912	177,040	180,168	183,295	186,423	189,550	
Totali	39.43	562,439	14,264	100.00%	581,001	599,508	618,016	636,523	655,031	673,538	691,240	708,942	726,643	744,345	762,047	777,910	793,772	809,635	825,498	841,360	

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 5.4.2 Prija e Popullsisë së Planifikuar në Zonat e Grumbullimit të Mbetjeve

3) Sasia e Planifikuar e Mbetjeve Familjare

Sasia e mbetjeve familjare është vlerësuar bazuar në sasinë e mbetjeve të prodhuara për frymë në ditë nga Vrojtimi i Sasisë së Përbërjes së Mbetjeve (VSPMN) kryer nga Ekipi Studimor i JICA-s. Rezultati i VSPM për sasinë e mbetjeve të prodhuara nga familjet tregon raportin mesatar të prodhimit të mbetjeve për frymë në ditë me 357 g. në 2011. Përqindja e prodhimit të mbetjeve synon të rritet në përputhje me rritjen e të ardhurave vetjake dhe rritjes ekonomike. Prija e përqindjes së rritjes nuk është e vlershme falë programeve të pakësimit ose të 3R-ve, zbatuar kudo në botë. Përqindja e prodhimit të mbetjeve për frymë po bie në vendet ku zbatohen aktivisht programet e pakësimit të mbetjeve. Gjithsesi, supozimi është bërë me 1% për vit për përqindjen e rritjes të mbetjeve të prodhuara për frymë në ditë në BT, përse kohë rezultati i VSPM për mbetjet familjare është ende në një

nivel të ulët dhe një rritje e mëtejshme ekonomike pritet të ndodhë. Tabela 5.4.5 tregon rezultatin e vlerësimit të sasisë së mbetjeve familjare llogaritur nga popullsia në Tabelën 5.4.4 dhe përqindjen e sasisë së mbetjeve të prodhuara për frymë në 357 g. në 2011 me një rritje vjetore të përqindjes së mbetjeve të prodhuara me 1%. Si rezultat, sasia e mbetjeve të prodhuara nga familjet në BT është vlerësuar në 210 tonë/ditë në 2012 dhe rritet në 353 tonë/ditë në 2027 siç tregohet në Tabelën 5.4.5.

Tabela 5.4.5 Sasia e Mbetjeve Familjare të Planifikuara (t/d)

Zona e Grumbullimit	Sasia e Mbetjeve Familjare (t/ditë)															
	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Lindore-1	28	29	30	31	33	34	35	36	38	39	40	41	43	44	45	46
Lindore -2	29	30	31	32	33	35	36	37	38	40	41	42	43	45	46	47
Lindore -3	38	40	41	43	45	46	48	50	51	53	55	57	58	60	62	63
Perëndimore-1	34	36	37	39	41	43	45	47	49	50	52	54	56	58	60	62
Perëndimore-2	32	33	34	36	37	39	40	42	43	45	46	47	49	50	52	54
Perëndimore-3	50	52	53	55	57	59	61	63	65	67	69	71	73	75	77	79
Prodhimi Mesatar i Mbetjeve për Frymë (g/f/d)	361	365	368	372	376	379	383	387	391	395	399	403	407	411	415	419
Sasia e Mbetjeve Familjare (t/d)	210	219	228	237	246	256	265	274	284	294	304	313	323	333	343	353

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

4) Vlerësimi i Mbetjeve Tregtare, të Biznesit dhe Institucioneve

Sipas sasisë së mbetjeve të grumbulluara nga 6 zonat e grumbullimit, sasia gjithsej e mbetjeve bashkiake nga mbetjet familjare, burime tregtare, nga bizneset dhe institucionet është vlerësuar në 683 tonë/ditë në mars 2012. Sasia e mbetjeve familjare e vlerësuar në Tabelën 5.4.5 tregon 210 ton/ditë. Duke supozuar se ndryshimi midis sasisë së grumbulluar dhe sasisë së mbetjeve familjare është nga burime të tjera, si rrjedhim sasia e mbetjeve tregtare, nga bizneset dhe institucionet është llogaritur në 473 tonë/ditë në 2012. Prandaj, mbetja tregtare, nga bizneset dhe institucionet llogaritet në 69% të shumës së mbetjeve bashkiake në BT. Sasia e mbetjeve të prodhuara në të ardhmen nga burime tregtare, të bizneseve dhe institucioneve është vlerësuar bazuar në raportin e sipërpërmendur dhe rezultati tregohet në Tabelën 5.4.6. Si rezultat, sasia e mbetjeve tregtare, të biznesit dhe institucioneve rritet nga 473 tonë/ditë në 2012 në 796 tonë/ditë në 2027, e cila tregon përqindjen e rritjes prej 168% në 15 vite.

Tabela 5.4.6 Sasia e Mbetjeve të Planifikuara Tregtare, të Bizneseve dhe Institucioneve (t/d)

Zona e Grumbullimit	Sasia e Mbetjeve Tregtare, të Bizneseve dhe Institucioneve (t/ditë)															
	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Lindore-1	62	65	67	70	73	76	78	81	84	87	90	93	95	98	101	104
Lindore -2	70	73	76	79	83	86	89	92	95	99	102	105	108	112	115	118
Lindore -3	77	80	84	87	91	94	97	101	105	108	112	115	119	122	126	130
Perëndimore-1	85	89	92	96	100	104	107	111	115	119	123	127	131	135	139	143
Perëndimore-2	75	78	82	85	88	92	95	99	102	106	109	112	116	119	123	127
Perëndimore-3	103	108	112	117	121	126	130	135	140	145	150	154	159	164	169	174
Sasia e Mbetjeve Tregtare & të Tjera (t/d)	473	493	514	534	555	577	598	619	641	663	686	707	729	751	773	796

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s


5) Sasia e Përgjithshme e Mbetjeve Bashkiake

Sasia e mbetjeve bashkiake është përfutur nga shuma e mbetjeve familjare dhe mbetjeve tregtare, nga biznesi dhe mbetjet institucionale. Tabela 5.4.7 dhe Figura 5.4.3 tregojnë sasinë e mbetjeve të vlerësuar për periudhën 2012-2027, e cila do të jetë e dhëna bazë për planifikimin e MMN. Sasia e mbetjeve bashkiake rritet nga 683 ton/ditë në 2012 në 1 148 tonë/ditë në 2027. Duke numëruar mbrapsht përqindjen e prodhimit të mbetjeve, norma e prodhimit të mbetjeve bashkiake për frymë rritet nga 1 176 g/ditë në 2012 në 1 365 g/ditë në 2027, e cila tregon pothuaj të njëjtën normë ose më lartë, krahasuar me qytetet e mëdha në botë.

Tabela 5.4.7 Sasia e Mbetjeve Bashkiake (t/d)

Zona e Grumbullimit	Sasia Gjithsej e Mbetjeve (t/ditë)															
	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Lindore-1	90	94	97	101	105	109	113	117	121	126	130	134	138	142	146	151
Lindore -2	99	103	107	112	116	120	125	129	134	138	143	147	152	156	161	166
Lindore -3	115	120	125	130	135	140	146	151	156	161	167	172	177	182	188	193
Perëndimore-1	119	124	130	135	141	147	152	158	164	170	176	182	187	193	199	205
Perëndimore-2	107	111	116	121	126	130	135	140	145	150	155	160	165	170	175	180
Perëndimore-3	153	159	165	172	178	185	192	198	205	212	219	226	232	239	246	253
Sasia Gjithsej e Mbetjeve Bashkiake (t/ditë)	683	712	741	771	801	832	863	894	925	957	990	1,020	1,051	1,083	1,115	1,148

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 5.4.3 Prirja e Sasisë së Planifikuar të Mbetjeve Bashkiake të Depozituara

5.4.2. Vlerësimi i Përbërjes së Mbetjeve të Ngurta në të Ardhmen

Përbërja e mbetjeve është një e dhënë themelore për të kryer planifikimin e 3R. Vrojtimi i përbërjes së mbetjeve nga VSPM kryer nga Ekipi Studimor i JICA-s u bë për kategoritë e mbetjeve, veçanërisht për kategoritë e mbetjeve të riciklueshme, siç paraqitet në seksionin 5.1.1 të këtij raporti. Rezultatet janë treguar këtu për kategoritë e mbetjeve të riciklueshme dhe kategoritë e mbetjeve të tjera jo të riciklueshme për mbetjet familjare dhe mbetjet e ardhura në Sharrë janë në Tabelën 5.4.8 për arsye të vlerësimit të përbërjes së ardhme të mbetjeve bazuar në kategoritë në tabelë.

Tabela 5.4.8 Përmbledhja e Përbërjes së Mbetjeve të VSPM (2011)

Kategoritë e Mbetjeve	Mbetjet Familjare	Mbetjet e Ardhura
Nr. i Mostrave	32	60
Mbetje Ushqimi	46,32%	34,94%
Letër (Të riciklueshme-Letër e Pastër)	9,88%	9,10%
Letër (Jo-të riciklueshme, Letër e Ndotur)	10,91%	8,94%
Plastikë (Të riciklueshme-Plastikë e Pastër)	8,25%	8,29%
Plastikë (Jo të riciklueshme-Plastikë e Ndotur)	9,13%	8,31%
Mbetje organike të tjera	7,70%	10,55%
Qelqi	3,25%	3,53%
Metale	2,17%	1,22%
Mbetje joorganike të tjera	1,97%	14,97%
Mbetje të Rrezikshme Familjare	0,41%	0,15%
Totali	100.0%	100.0%


Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Përbërja e mbetjeve në të ardhmen është vlerësuar në bazë të supozimit të një ndryshimi të stilit të jetës dhe pasojat, që do të sjellin ndryshimin e përbërjes së mbetjeve. Supozimi tjetër është bërë nga norma e mbetjeve të ushqimit me vlerë 40% në mbetjet familjare dhe mbetje të tjera organike me 7,5% për mbetjet e ardhura në venddepozitimin e mbetjeve. Përbërja e mbetjeve të ardhura në venddepozitimin e mbetjeve është bërë në kushtet kur sistemi i MMN të grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Tabela 5.4.9 dhe Figura 5.4.4 tregojnë rezultatin e vlerësimit të përbërjes së mbetjeve të planifikuara të mbetjeve familjare dhe mbetjeve të ardhura në venddepozitimin e mbetjeve. Përbërësit kryesorë në të ardhmen janë: mbetjet e ushqimit në 40%, letra në 23,2%, dhe plastika në 19,4% në mbetjet familjare. Përbërja e mbetjeve të ardhura është vlerësuar në pothuaj në njëjtën normë, por mbetjet e tjera joorganike janë: rërë, papastërti, dhëra dhe materiale të tjera inerte, është vlerësuar të ulet në krahasim me normën e tanishme nga 15% në gjysmën e vlerës, në 7,5%.

Tabela 5.4.9 Përbërja e Mbetjeve në të Ardhmen

Kategoritë e Mbetjeve	Mbetjet Familjare	Mbetjet e Ardhura
Mbetje Ushqimi	40,0%	38,0%
Letër (Të riciklueshme - Letër e Pastër)	11,0%	9,9%
Letër (Jo-të riciklueshme - Letër e Ndotur)	12,2%	9,7%
Plastikë (Të riciklueshme - Plastikë e Pastër)	9,2%	9,0%
Plastikë (Jo të riciklueshme - Plastikë e Ndotur)	10,2%	9,0%
Mbetje organike të tjera	8,7%	11,6%
Qelqi	3,6%	3,8%
Metale	2,4%	1,3%
Mbetje joorganike të tjera	2,2%	7,5%
Mbetje të rrezikshme familjare	0,5%	0,2%
Gjithsej	100,0%	100,0%

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 5.4.4 Përbërja e Mbetjeve e Planifikuar në të Ardhmen

5.5. Koncepti i Planifikimit dhe Drejtimit e Masterplanit të MIMN

Ky seksion paraqit kuadrin kombëtar për të formuluar menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta të Bashkisë së Tiranës duke përfshirë kuadrin kombëtar në sistemin ligjor, funksionet e NjQV-ve në menaxhimin e mbetjeve, strategjinë e përgjithshme kombëtare, planin kombëtar, kuadrin e formulimit të masterplanit duke përfshirë zërat e planeve të propozuara dhe planveprimet për planin e ngutshëm dhe atë afatshkurtër, planin afatmesëm dhe planin afatgjatë, i cili duhet formuluar sipas kuadrit kombëtar për menaxhimin e mbetjeve të ngurta. Rrjedhimisht, kjo pasqyron objektivat, strategjitë e planifikimit ose bazën logjike për të formuluar planin vendor të menaxhimit të mbetjeve dhe prioritizimin e planeve të veprimit të propozuar për grumbullimin e mbetjeve, trajtimin e ndërmjetëm, largimin e mbetjeve, pakësimin e mbetjeve, rikuperimin e burimeve, ripërdorimin dhe riciklimin, rritjen e aftësive

financiare, etj. Këto janë për t'u integruar për themelimin e sistemit të frytshëm të menaxhimit të mbetjeve të ngurta për bashkinë. Trajtimi 3R dhe ai i ndërmjetëm do të jenë si elementet kryesore, që ndihmojnë për krijimin e një shoqërie të orientuar drejt riciklimit të burimeve, në Shqipëri nëpërmjet aktiviteteve të menaxhimit të mbetjeve të ngurta.

5.5.1. Përgjegjësitë e Njësive të Qeverisjes Vendore (NjQV-ve) mbi MMN

Ligjet ekzistuese përshkruajnë detyrimet e njësive të qeverisjes vendore (NjQV) për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta. Neni 10 në Ligjin nr.8652, dt.31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" përcakton aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve për grumbullimin, transportimin, trajtimin dhe asgjësimin, në nivel vendor me funksionet e veta në fushën e investimeve dhe shërbimeve publike (ndryshuar me ligjin Nr. 9208, datë 18.03.2004). Ligji nr. 10.431, datë 06.09.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", parashikon se NjQV janë përgjegjës për formulimin e rregullave vendore të menaxhimit të mbetjeve në bazë të rregulloreve kombëtare të miratuara nga Qeveria Qendrore, planeve vendore të menaxhimit të mbetjeve, etj.; për përcaktimin e mbledhjes dhe zhvillimit të venddepozitimit të mbetjeve, në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit për të siguruar të dy llojet e venddepozitimit si të mbetjeve ashtu dhe të lëndëve të rrezikshme. Neni 22 i Ligjit parasheh që komunat do të kenë sektorin/ët e pastrimit të qytetit dhe menaxhimit të mbetjeve. Për më tepër, Ligji Nr. 8094, datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbetjeve" neni 20, parashikon që NJQV do të kenë përgjegjësinë për organizimin e depozitimit të mbetjeve dhe do të ketë autoritetin të lidhin kontratë me kompaninë (të) për pastrimin e qyteteve . I njëjti ligj "Për largimin publik të mbetjeve në" nenet 31 dhe 34 të saj, gjithashtu parashikon se bashkitë dhe komunat caktojnë tarifat për heqjen e mbetjeve në juridiksionin territorial dhe caktojnë personat për mbledhjen e mbetjeve.

5.5.2. Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve

Qëllimi i këtij ligji është të mbrojë shëndetin e njeriut dhe mjedisin përmes (i) parandalimit ose zvogëlimit të ndikimeve negative nga prodhimi i mbetjeve dhe menaxhimi i mbetjeve, (ii) uljes së ndikimeve të përgjithshme të përdorimit të burimeve; (iii) rritjes së efikasitetit të këtij përdorimi, dhe (iv) sigurimit të menaxhimit të mbetjeve, kujdesit për mjedisin. Për këtë qëllim, Ligji përafron plotësisht Direktivën 2008/98/EC të BE, disa nga direktivat e BE-së, vendimet dhe rregulloret dhe shumicën e rregullave dhe rregulloreve të përcaktuara drejtpërdrejt dhe tërthorazi në bazë të disa ligjeve ekzistuese në këtë ligj. Prandaj, parimet apo kuadri për formulimin dhe zbatimin e një menaxhimi të mirë të mbetjeve të ngurta janë përshkruar në nenet e këtij ligji. Pikat kryesore të këtyre artikujve janë përmbledhur si më poshtë.

(1) Përparësitë e Menaxhimit të Mbetjeve

Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve në këtë ligj është paraparë të ndjekë parimet e përgjithshme të "Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit". Ministria dhe të gjitha autoritetet përkatëse do të marrin masa për të dhënë rezultatin më të mirë mjedisor. Kjo hierarki sugjeron se pakësimi i mbetjeve ose 3R quhet si rryma kryesore në formulimin dhe zbatimin e planit të menaxhimit të mbetjeve, të NJQV-ve. Kjo mbulon:

- parandalimin e mbetjeve;
- përgatitjen për ripërdorim;

- riciklimin;
- rikuperime të tjera, për shembull duke rikuperuar energjinë;
- depozitim.

(2) Përgatitja e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve nga NjQV-të

NjQV duhet të miratojnë një plan menaxhimi të mbetjeve të quajtur Plan Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve brenda zonës të saj administrative. Plan duhet të jetë në përputhje me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planin e Prefekturës (Qarku) për Menaxhimin e Mbetjeve në përputhje me përcaktimet në nenet 10 dhe 12 të Ligjit. Sipas neneve, NjQV ia mundëson publikut njohjen me planin nëpërmjet faqes së vet të internetit. Ligji, gjithashtu përcakton se para miratimit të planit nga ana e NjQV-së, Prefektura (Qarku) Qeveria duhet të marrin parasysh rezultatet e çdo Vlerësimi Strategjik Mjedisor, nëpërmjet komenteve nga publiku dhe nga autoritetet e tjera përkatëse.

(3) Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit

Përgjegjësitë e prodhuesit 'ose gjeneruesit të mbetjeve' janë të përcaktuara në nenin 16 të Ligjit, që kërkon që ata të marrin parasysh elementet kyç të 3R-ve për Planin e MIMN të Bashkisë së Tiranës, që janë:

- Çdo person, i cili profesionalisht zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte (prodhuesi i produktit) ka përgjegjësi të zgjeruar prodhuesi.
- Prodhuesit kanë përgjegjësinë për zbatimin e masave, që forcojnë parandalimin e mbetjeve, ripërdorimin, riciklimin dhe masa të tjera të rikuperimit të mbetjeve.
- Prodhuesit kanë përgjegjësinë për masat, që mund të nxisin projektimin e produkteve, për të ulur ndikimin e tyre në mjedis dhe për të pakësuar prodhimin e mbetjeve gjatë prodhimit dhe përdorimit të produkteve
- Prodhuesit kanë përgjegjësinë për marrjen dhe zbatimin e masave, që nxisin zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e mallrave, të përshtatshme për përdorim të shumëfishtë, teknikisht të qëndrueshme dhe të përshtatshme për rikuperimin e duhur dhe të sigurt si dhe depozitim.

(4) Kostot e Menaxhimit të Mbetjeve

Për koston e menaxhimit të mbetjeve, ligji përcakton se kostoja e menaxhimit të mbetjeve do të përballohen sipas parimit: ndotësi paguan, siç përcaktohet në nenin 12 të Ligjit "Për Mbrojtjen e Mjedisit". Në veçanti, shpenzimet e menaxhimit të mbetjeve, do të përballohen nga prodhuesi origjinal i mbetjeve ose nga mbajtësi i tanishëm ose i mëparshëm i mbetjeve.

(5) Përgjegjësia e Menaxhimit të Mbetjeve

Nenet 21 dhe 22 të Ligjit përcaktojnë përgjegjësitë e prodhuesve origjinalë të mbetjeve, mbajtësit, tregtarët, operatorët ose çdo person, që kryen trajtimin e mbetjeve. Sipas neneve, Qeveria specifikon kushtet e përgjegjësisë si dhe rastet kur prodhuesi origjinal mban përgjegjësi për trajtimin në tërësi dhe gjithashtu, ndan përgjegjësinë me mbajtësit e mbetjeve apo të deleguar ndërmjet aktorëve të ndryshëm të zinxhirit të trajtimit të mbetjeve. Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta kërkon edhe ngritjen e instalimeve adekuata dhe të përshtatshme të sistemit të mbulimit të të gjitha proceseve që nga grumbullimi deri në depozitim përfundimtar.

(6) Incenerimi dhe Landfilli i Mbetjeve

Përsa kohë shmangia e mbetjeve pakëson vëllimin e mbetjeve për depozitim përfundimtar,

djegia e tyre është teknika më efektive për të zvogëluar vëllimin e mbetjeve. Gjithashtu, djegia zgjat jetën e impianteve të depozitimit të mbetjeve, si dhe efektet e stabilizimit të mbetjeve, si hiri. Ligji parashikon djegien e mbetjeve dhe landfillin si më poshtë.

- Neni 47 i Ligjit përcakton se djegia e mbetjeve duhet të përshtatë rregullat dhe rregulloret, duke përfshirë kërkesat e inceneratorit, bashkëincenerimit, procedurat e pranimit të mbetjeve, kushtet e funksionimit, kontrollin dhe monitorimin, etj.
- Landfilli është trajtuar në nenet 43 dhe 46 të Ligjit. Sipas ligjit ato ndahen në tre lloje: landfill për mbetjet e rrezikshme, landfill për mbetjet jo të rrezikshme, dhe landfill për mbetjet inerte. Sipas ligjit, vetëm mbetjet, që trajtohen mund të depozitohen në landfill. Landfilli për mbetjet e rrezikshme mund të përdoret vetëm për mbetjet e rrezikshme, landfilli për mbetjet jo të rrezikshme mund të përdoret vetëm për mbetjet bashkiake dhe mbetje të tjera jo të rrezikshme apo të qëndrueshme natyrore, landfilli për mbetjet inerte mund të përdoret vetëm për mbetjet inerte. Ligji gjithashtu, përshkruan mbetjet, që nuk janë të pranueshme për landfill, si: mbetje të lëngshme, eksplozive, kimikate, goma, bateri të automobilave, etj.

5.5.3. Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve përgatitur nga Projekti INPAEL (Implementation of the National Plan for Approximation of Environmental Legislation) me pjesëmarrjen e BE, është miratuar nga qeveria në qershor 2011. Çështjet kyç të strategjisë të lidhura me hartimin e Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës janë trajtuar në paragrafët e mëposhtëm.

(1) Hierarkia e Menaxhimit të Mbetjeve

Hierarkia kombëtare e menaxhimit të mbetjeve përputhet me Direktivën e BE-së 2008/98/EC. Ajo është përshtatur në nëntor 2008 si një sfidë e re, e vështirë për menaxhimin e mbetjeve bazuar në parandalimin e ndikimeve negative të prodhimit dhe menaxhimit të mbetjeve në shëndetin njerëzor dhe mjedis. Ajo synon të limitoj prodhimin e mbetjeve si dhe nxitjen e përdorimit të mbetjeve si një burim nga riciklimi dhe rikuperimi. Për të arritur këtë qëllim, hierarkia e menaxhimit të mbetjeve është përcaktuar nga renditja e përparësive, si vijon:

- Parandalimi
- Përgatitja për ripërdorim
- Riciklimi
- Rikuperime të tjera p.sh. rikuperimi i energjisë
- Depozitimi

(2) Niveli i Synuar për Ripërdorimin dhe Riciklimin

Niveli objektiv i ripërdorimit dhe riciklimit është gjithashtu në përputhje me nivelet objektive të Direktivat të BE-së si më poshtë:

- Grumbullimi i ndarë duhet të bëhet të paktën për: letrën, metalin, plastikën dhe qelqin deri në 2020.
- Përgatitja për ripërdorim dhe riciklim të materialeve të paktën për: letrën, metalin, plastikën dhe qelqin nga familjet dhe mundësisht nga origjina të tjera deri në 2020 të paktën deri në 50% sipas peshës;

- Përgatitja për ripërdorim, riciklim dhe rikuperime të tjera materiale, duke përfshirë veprime mbushëse duke përdorur mbetje për të zëvendësuar materialet e tjera jo të rrezikshme të ndërtimit dhe nga prishjet deri në 2020 deri në 70% sipas peshës;
- Direktiva e Landfillit 1999/31/EC detyron Vendet Anëtare të ulin sasinë e mbetjeve të biodegradueshme në landfill në 35% të nivelit të 1995 deri në 2016.

(3) Përparësitë e Programit Qeverisës për Menaxhimin e Mbetjeve

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve përcakton rendin e përparësive të programit qeverisës për menaxhimin e mbetjeve si vijon:

- Përvetësimi i Standardeve Ligjore të Komunitetit Evropian,
- Forcimi i zbatimit të ligjit për mbetjet,
- Investimet për mbrojtjen e mjedisit,
- Mbështetje financiare për infrastrukturën e mjedisit,
- Administrimi i burimeve mjedisore,
- Përmirësimi i komunikimit e ndërgjegjësimi,
- Përmirësimi i sistemit monitorues.

(4) Politika Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve

Për të bërë ndryshimin dhe për të sjellë një menaxhim të mbetjeve të qëndrueshëm e afatgjatë të Shqipërisë, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave u përqendruar në përmirësimin e 4 shtyllave të politikës, që janë.

- Planifikimi për Menaxhimin e Mbetjeve
- Edukimi për Menaxhimin e Mbetjeve
- Burimet për Menaxhimin e Mbetjeve
- Legjislacioni për Menaxhimin e Mbetjeve

(5) Sfidat për të Siguruar Sistemin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

Për ngritjen e një mekanizmi për të siguruar sistemin e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri janë parashikuar katër sfida:

1) Sfidat Ekonomike:

- Kostot e impianteve të trajtimit dhe mirëmbajtjes;
- Ekonomia e shkallës (p.sh. përmasat dhe kapaciteti i impiantit)

2) Sfidat e Mjedisit:

- Mundësia për të zvogëluar sasinë e mbetjeve, që shkojnë në landfill (investimi fillimisht në grumbullimin e ndarë të mbetjeve, Stacionet/Qendrat e Transferimit për një ndarje të mëtejshme të mbetjeve, ripërdorimi, riciklimi/rikuperimi);
- Ulja e kërkesës për financimet natyrore për produktet (nëpërmjet riciklimit)

3) Sfidat Shoqërore:

- Kërkesa e komunitetit për programet e riciklimit;
- Kërkesa e komunitetit për shërbime të domosdoshme brenda kufijve të Qarkut

4) Sfida Ligjore:

- Rritja e kërkesave rregulluese (p.sh. për landfillet);
- Potenciali për kërkesa të reja të parashikuara me ligj (p.sh. Politika e Mbrojtjes së Mjedisit në lidhje me mbetjet)

(6) Burimet Financiare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta

Zhvillimi i një menaxhimi të integruar të mbetjeve të ngurta duhet të bëhet në 2 faza, sipas këtyre burimeve financiare:

Burimet e Financimit

1) Faza 1: para pranimit në BE

- Programit të financimit të Qeverisë Qendrore;
- financave të premtuara nga bashkësia kolektive e donatorëve ndërkombëtarë, qoftë si donacione apo si marrëveshjeve financiare kredie.

2) Faza 2: pas pranimit në BE

- Kryesisht nga programi i fondeve të qeverisë qendrore;
- Programet e infrastrukturës së fondeve të BE;
- Kapitali privat për Partneritet Publik Privat (PPP)

Tarifa e Mbetjeve

Tarifa për mbetjet ose e quajtur ndryshe Tarifa e Pastrimit bashkitë ose komunat ua ngarkojnë banorëve, konsumatorëve tregtarë dhe industrive. Në parim, Këshilli Bashkiak ose Komunal përcakton tipin e taksës, rregullat e grumbullimit dhe administrimin e tyre. Të ardhurat e krijuara nga mbledhja e taksave për pastrim janë larg nga buxheti i kërkuar për menaxhimin e mbetjeve dhe shumica e komunave/bashkive kanë nevojë të shtojnë burime të tjera financimit që të sigurojnë pastrimin e qytetit dhe administrimin e mbetjeve.

Fondi i Mjedisit

Fondi Mjedisor vendoset në një linjë me Programin e Qeverisë. Qëllimi kryesor i Fondit Mjedisor është të veprojë si një grumbullues qendror dhe si një pikë shpërndarjeje për disa apo për të gjitha të ardhurat nga tarifat mjedisore, si gjjobat, taksat dhe burime të tjera, duke përfshirë edhe donatorët. Shpërndarja e fondeve të projektet duhet të bëhet sipas kriterëve të mirëpërcaktuara dhe në mënyrë transparente.

(7) Raportimi, Monitorimi dhe Vlerësimi

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve, përmban çështje kryesore, që duhet të trajtohen nga Qeveria Qendrore, Qeveria Vendore, banorët, sektori privat dhe të gjitha grupet e interesit, të cilat janë:

- Përfshirja e aktorëve kryesorë për sigurimin e informacionit dhe bashkëpunimit;
- Koordinimi i politikave, plane kombëtare, plane rajonale, plane vendore dhe planveprimi;
- Monitorimi i zbatimit të saj përmes treguesve mjedisorë, të performancës, financiarë dhe administrativë;
- Ngritja e një sistemi raportimi për cilësinë e përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve.

5.5.4. Plan i Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve

Plan i Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve përgatitur nga Projekti INPAEL, me pjesëmarrjen e BE u miratua në 19 janar 2011. Për të zbatuar menaxhimin e integruar të mbetjeve, njësitë e qeverisë vendore duhet të kenë parasysh këto çështje kryesore, e veçanërisht për nivelin e synuar dhe kohën e zbatimit.

(1) Strategjia dhe Politika Kombëtare e Mbetjeve

Qeveria e Shqipërisë nënvizon 4 shtylla politike: planifikimin, edukimin, burimet dhe legjislacionin, për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve përmes Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU). Plan i Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve vendos bazën për kuadrin kombëtar për zhvillimin e planeve vendore dhe rajonale të menaxhimit të mbetjeve për të përfshirë:

- Grumbullimin e përshtatshëm dhe efektiv dhe procedurat e transportit;
- Inventar e vendeve ekzistuese, gjendjen e tyre dhe planet e rehabilitimit;
- Standardet për ndërtimin e landfilleve, që ulin ndotjen;
- Mekanizmat për rritjen e të ardhurave nga grumbullimi i mbetjeve,
- Hapat për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për dëmet, që shkaktojnë depozitimet e mbetjeve.

Në zbatim të politikës kombëtare, nivelet e synuara të prodhimit dhe riciklimit të mbetjeve janë vendosur për të:

- ndaluar rritjen e prodhimit të mbetjeve bashkiake deri në vitin 2020;
- arritur riciklimin 25% dhe kompostimin e mbetjeve bashkiake deri në vitin 2015;
- arritur riciklimin 55% dhe kompostimin e mbetjeve bashkiake deri në vitin 2020;
- rikuperuar energji nga 15% e mbetjeve bashkiake;
- ulur depozitim në landfill të mbetjeve bashkiake nga 90% në rreth 30%;
- siguruar masivisht përhapjen e këshillimit për pakësimin e mbetjeve për bizneset,
- zhvilluar tregjet për materialet e riciklueshme për të ndihmuar rritjen e industrisë së riciklimit.

(2) Mekanizmi i Koordinimit dhe Organizimit

Plan i përcakton edhe organizmat dhe mekanizmat e koordinimit për të arritur objektivat sipas zbatimit të hierarkisë së mbetjeve - Parandalimit, Përgatitjes për ripërdorim, Riciklimin, Rikuperimin dhe Depozitim. Organizmat dhe mekanizmat e koordinimit janë:

- Komiteti Ndërmnistror për Mbetjet (KNM);
- Grupi Kombëtar Këshillimor për Mbetjet (GKKM);
- Grupet e Zonave të Mbetjeve (GZM),
- Përfshirja e Grupeve të Interesit dhe e Komunitetit.

Veç kësaj, për planin janë pasur parasysh edhe këto parime strategjike:

- Afërsia dhe vetëmjaftueshmëria;
- Ndotësi pagan;
- Opsioni më i mirë mjedisor i praktikueshëm (OMMP)

(3) Zbatimi i Planeve të Veprimit për Mbetjet Bashkiake

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve përcakton afatin kohor për zbatimin e skemës në 3 faza:

- Faza-1 : 2010-2015
- Faza-2 : 2016-2020,
- Faza-3 : 2021-2025

(4) Burimet e Financimit

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve propozon që burimet financiare për zbatimin e planeve dhe projekteve të jenë të ndara në dy faza, si më poshtë:

Faza financiare 1: 2010-2015,

- Buxheti i Shtetit, i bashkisë apo komunës,
- Para anëtarësimit në BE: Instrumenti për Paraanëtarësim (IPA),
- Grantet nga donatorët e tjerë ndërkombëtarë.

Faza financiare 2: 2015-2025,

- Pas pranimit në BE: grante nga fondet strukturore ERDF dhe QS
- Kredi nga një institucion financiar ndërkombëtar (IFI), si Banka Botërore apo BERZH.
- Kredi nga një bankë tregtare
- Obligacionet e lëshuara nga organet e qeverisjes vendore
- Kapitali privat PPP nëpërmjet marrëveshjeve.

(5) Marrëdhëniet me Publikun dhe Monitorimi

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve duhet t'i njoftohet publikut përmes;

- Seminareve Vjetore të Grupeve të Interesit;
- Publikimeve të aktiviteteve në faqe elektronike.

Planet Zonale të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve duhet të monitorohet dhe rishikohet duke përdorur këta tregues:

- Treguesit e Performancës së Infrastrukturës mjedisore
- Treguesit financiarë
- Treguesit Administrativë

5.5.5. Plani i Menaxhimit të Mbetjeve për Zonën e Tiranës

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve për Zonën e Tiranës është përgatitur nga Projekti INPAEL, me pjesëmarrjen e BE në qershor 2010 dhe iu dorëzua Prefekturës së Tiranës. Prefektura është në proces miratimi nga Këshilli i Prefekturës. Më pas do të dorëzohet në MMPAU për miratim nga Qeveria Qendrore për zbatim.

5.5.6. Direktivat e BE-së për MMN

Shumica e Direktivave të BE-së janë të përfshira në Ligj, Strategjitë Kombëtare dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Projektplanin e Menaxhimit të Mbetjeve për Zonën e Tiranës. Nivelet e synuara për çështjet kyç të përcaktuara në Direktivat e BE-së për planifikimin dhe zbatimin e MIMN nga BT-ja janë në vijim.

<u>Direktivat kyç për MIMN</u>		<u>2015</u>	<u>2020</u>
- 2008/98/EC-Ripërdorimi dhe Riciklimi Nen 11	:	50 %	70 %
- 1999/31/EC- Mbetjet e Biodegradueshme në landfill, Nen 5.2	:	35% deri në 2016	

5.5.7. Koordinimi me Planet Përkatese të Zhvillimit

(1) Marrëdhënia me Planin Rregullues të Bashkisë së Tiranës

Bashkia e Tiranës ka rishikuar Planin e Rregullues të përgatitur nga administrata e mëparshme dhe vendosi të hartonte një plan të ri duke përfshirë komunat fqinje. Plan i menaxhimit të mbetjeve urbane në Planin Rregullues nuk është konfiguruar ende dhe as planet e veprimit për zhvillimin në të ardhmen. Ky Plan i MIMN i përgatitur nga projekt asistencë e JICA-s pritet të përfshihet në Planin Rregullues të BT-së.

(2) Marrëdhënia me Planin Rajonal të Depozitimit të Mbetjeve

Projektplan i Mbetjeve për Zonën e Tiranës është përfunduar në 2010 nga Projekti INPAEL. Por, dokumenti nuk është miratuar ende dhe nuk është gati për zbatim për Rajonin e Tiranës. Gjithsesi, Plan i MIMN për Bashkinë e Tiranës, që po përgatitet nga projekti i asistencës i JICA, ka marrë parasysh dhe ka përfshirë propozimet dhe orientimet e paraqitura në këtë material, për menaxhimin e ardhshëm të mbetjeve në Bashkinë e Tiranës. Ndërkohë, KfW, me kërkesë të Ministrisë së Mjedisit do të kryejë Studimin e Fizibilitetit dhe Projektin e Detajuar për ndërtimin e landfillit rajonal Durrës-Tiranë-Kavajë. Përsa kohë ky projekt nuk ka asnjë zhvillim deri më tani, nuk ka asnjë orientim ose propozim, që mund të merret parasysh nga Plan i MIMN i Bashkisë së Tiranës.

5.5.8. Kuadri për Planin e MIMN të Bashkisë së Tiranës

Ky seksion paraqet kuadre të ndryshme për të formuluar masterplanin e mbetjeve të ngurta të BT-së të njohur si Plan i MIMN i Bashkisë së Tiranës. Këto kuadre kanë të bëjnë me: i) misionin dhe objektivat e menaxhimit të mbetjeve të ngurta, ii) gjashtë politikat planifikuese, iii) objektivin e vitit të synuar, iv) objektivin e llojit të mbetjeve, v) objektivin për zonën e planifikimit, dhe vi) përbërësit dhe strategjitë e Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës.

(1) Misioni dhe Objektivat e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta

Në formulimin e Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta (MIMN) misioni i menaxhimit të mbetjeve është përcaktuar për tu përmbushur si më poshtë:

- Mbajtja e pastërtisë dhe higjienës publike për t'i mbajtur hapësirat publike estetikisht të pranueshme dhe të sigurojë kushte jetese të shëndetshme për qytetarët;
- Ndihmesë në ngritjen e një shoqërie të shëndoshë të orientuar te riciklimi i burimeve;
- Ruajtja e mjedisit si një trashëgimi për të ardhmen.

Këto misione janë shtylla kurrizore për planifikimin dhe zbatimin e planeve të veprimit, që do të propozohen në Planin e MIMN të Bashkisë së Tiranës. Këto objektiva duhet të materializohen përmes menaxhimit të mbetjeve të ngurta bazuar në ecurinë e rrjedhës së mbetjeve, që janë

qëllim, kontrolli sistematik i elementëve funksional të grumbullimit, transportit, ndarjes së mbetjeve në burim, rikuperimi i materialeve të riciklueshme, ripërdorimi, riciklimi, trajtimi i ndërmjetëm dhe depozitimi përfundimtar i lidhur me menaxhimin e mbetjeve të ngurta nga burimet e prodhimit të mbetjeve deri në depozitimin përfundimtar.

(2) Politikat e Planifikimit

Qëllimi i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta të Bashkisë së Tiranës për të ngritur sistemin e menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta, i përbërë nga plane praktike veprimi, i nisur dhe zbatuar fillimisht nën përgjegjësinë e BT-së me përgjegjësi dhe role të ndara midis grupeve të interesit.

Me këtë qëllim, koncepti i ngritjes së Shoqërisë së Shëndoshë Orientuar te Riciklimi (ShShOR) do të merret parasysh në formulimin e masterplanit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta, e njohur ndryshe si Plani i MIMN së Bashkisë së Tiranës. Masterplani do të këtë objektiv mbetjet e ngurta bashkiake dhe mbetjet jo të rrezikshme, të cilat sot depozitohen në kontejnerët e mbetjeve dhe në venddepozitimin e tanishëm të mbetjeve.

Në strukturimin e planit të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta, të mëtejshmet janë politikat bazë të planifikimit, që duhet materializuar në formulimin e planit.

- Pjesëmarrja e grupeve të interesit në menaxhimin e mbetjeve të ngurta;
- Paraqitja e aktiviteteve 3R;
- Rritja e aktiviteteve të ofruesve të shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve;
- Pakësimi i shkallës së zhvillimit të trajtimit të ndërmjetëm dhe impianteve të depozitimit të mbetjeve;
- Lehtësimi i barrës fiskale të MMN të Bashkisë së Tiranës;
- Shtimi i burimeve njerëzore dhe i aftësive.

Politikat e mësipërme të planifikimit janë të rreshtuara në seksionet e mëposhtme.

1) Pjesëmarrja e Grupeve të Interesit në Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta

Ndër artikujt, që kanë nevojë për diskutim më të thellë janë rolet e ndryshme të palëve të interesuara në procesin përkatës të aktiviteteve të menaxhimit të mbetjeve të ngurta për ndarjen e tyre në burim, rikuperimin e materialeve të riciklueshme, mbledhjen e ndarë të mbetjeve, kompostimin e mbetjeve të biodegradueshme, depozitimin përfundimtar, etj. Për të rritur suksesin e një sistemi të integruar të menaxhimit të mbetjeve të ngurta do të jetë e nevojshme nxitja e normave shoqërore midis aktorëve në zbatimin e përgjegjësisë të tyre përkatëse. Për shembull, në vend të identifikimit të banorëve/komunitetit si përfituesit e shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve, vetë banorët duhet të përmbushin detyrimet e tyre për të rikuperuar materialet e riciklueshme të mbetjet dhe ti derdhin siç duhet mbetjet në vendin e caktuar. Me fjalë të tjera, vetë përfituesi duhet të jetë një qytetar i përgjegjshëm në bazë të kësaj norme shoqërore dhe ai duhet të mbajë barrën e përshtatshme, detyrë e tij, për mbështetjen e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta në Bashkinë e Tiranës. Për zbatimin e planeve të veprimit, BT ka nevojë për mbështetje nga palët përkatëse të përfshira në menaxhimin e mbetjeve të ngurta. Në formulimin e planit, përgjegjësitë primare të palëve të interesuara në çdo proces të menaxhimit të aktivitetit të

mbetjeve janë të përcaktuara siç tregohet në Tabelën 5.5.2 për diskutim, ekzaminim dhe pëlqimin përpara institucionalizimit.

Tabela 5.5.1 Përgjegjësitë Bazë të Grupeve të Interesit në Aktivitetet e Menaxhimit të Mbetjeve

Palët e Interesuara	Përgjegjësitë & Rolet
1. Qeveria Qendrore	1) forcimi i Ligjit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe institucionalizimi 2) zbatimi i Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve për të përballuar gjendjen sot dhe në të ardhmen 3) përcaktimi i standardeve teknike 4) futja e teknologjisë së përparuar për menaxhimin e mbetjeve të ngurta 5) siguron për zbatimin e rregullave dhe rregulloreve 6) të sigurojnë udhëzime për NjQV-të 7) për miratimin, zbatimin e sistemit të përgjithshëm të ligjit për të instaluar sistemin për krijimin e një shoqërie të shëndoshë drejt riciklimit të burimeve (ShShRB) në Shqipëri 8) të studiojnë dhe zbatojnë masat për stabilizimin/kompensimin e çmimit të materialeve të riciklueshme
2. Bashkia e Tiranës	1) të formulojë politika vendore dhe përgatisë strategjitë dhe planet vendore (të ngutshme, afatshkurtra, afatmesme, afatgjata) 2) të financojnë investimet e MMN dhe të mbështesë funksionimin dhe mirëmbajtjen 3) përcaktimi i një sistemi të drejtë të tarifimit të mbetjeve dhe ta mbledhë atë 4) të formulojë rregullat dhe rregulloret, 5) të formulojë guida në shërbim të: a) metodës së depozitimit të mbetjeve (llojit të kontejnerëve, ndarjes, dhe ditës së grumbullimit për lloje të mbetjeve të ndara, etj.), b) ngritja e qendrave/vendeve për rikuperimin e burimeve (përcaktimi i llojeve të mbetjeve për rikuperim, ripërdorim dhe riciklim) c) raportimi i kërkesave të tregtarëve, bizneseve, dhe prodhuesve të mbetjeve industriale dhe institucionale për mbetjet e rrezikshme), i) nxitja dhe edukimi i qytetarëve për të siguruar mbështetjen/bashkëpunimin në zbatimin e skemave të MMN të bashkisë. ii) të nxitë/mbështesë sektorin privat për ngritjen e një korporate rikuperimi dhe riciklimi eskluzivisht për letrën dhe plastikën përmes PPP iii) nxitja/mbështetja e aktorëve të industrisë së riciklimit duke kryer rikuperimin e burimeve, grumbullimin e ndarë, aktivitetet e ripërdorimi dhe riciklimit
3. Qytetarët dhe Grupet Komunitare	1) për të përmbushur rregullat e veçimit të mbetjeve në burim, shkarkimin e mbetjeve, mbledhja e veçantë dhe procedurat e rikuperimit të burimeve të vendosura nga qeveria e komunës 2) për të ulur sasinë e mbetjeve të prodhuara përmes jetesës miqësore me mjedisin 3) për të rikuperuar të riciklueshmet dhe për ti sjellë ato në qendrat e rikuperimit të burimeve ose pika të rikuperimit 4) të pranojë parimin: ndotësit paguajnë dhe të paguajnë pagesat e mbetjeve 5) për të ripërdorur, blerë dhe përdorin produktet / mallrat e riciklimit
4. Qendrat (Tregtare, e biznesit dhe institucionale)	1) të përputhen rregullat, udhëzimet, standardet, etj. të përcaktuara nga qeveria bashkiake për zbatimin e planit të uljes së mbetjeve 2) të mbledhin, trajtojnë dhe magazinonë mbetjet e veta me përjashtim të mbetjeve të përgjithshme të pranuar nga BT si mbetje bashkiake 3) për të kryer ndarjen e mbetjeve të riciklueshme në vendet e punës së tyre dhe t'i ruajnë përkohësisht 4) të pranojnë sistemin progresiv të normës së tarifimit të mbetjeve për sasinë e shkarkimit të mbetjeve 5) të paraqesin raporte për mbetjet e tyre (llojet, sasinë, paratrajtimin dhe njoftime të tjera) që kërkohen nga qeveria e bashkisë

5. Qendrat (prodhuesit industrialë të mbetjeve)	1) të përputhen rregullat, udhëzimet, standardet, etj. të përcaktuara nga qeveria bashkiake për zbatimin e planit të pakësimit të mbetjeve 2) të mbledhin, trajtojnë dhe magazinon mbetjet e veta me përjashtim të mbetjeve të përgjithshme të pranuar nga BT si mbetje bashkiake 3) për të kryer ndarjen e mbetjeve të prodhuara nga proceset prej mbetjeve të përgjithshme 4) për të kryer ndarjen e mbetjeve të riciklueshme në vendet e punës së tyre dhe t'i ruajnë përkohësisht 5) të pranojnë sistemin progresiv të normës së tarifimit të mbetjeve për sasinë e shkarkimit të mbetjeve 6) të paraqesin raporte për mbetjet e tyre (llojet, sasinë, paratrajtimin dhe informata të tjera) që kërkohen nga qeveria e bashkisë
6. Riciklimi-lidhur me Industrinë (fabrikat e riciklimit/korporatat, grumbulluesit e mbetjeve, tregtarët dhe ofruesit e shërbimit të grumbullimit të ndarë)	1) të zbatojnë mbledhjen e veçantë në pajtim me rregullat dhe udhëzimet e përcaktuara nga qeveria e bashkisë (ofruesi i shërbimit të mbledhjes së ndarë) 2) të rikuperojnë materiale të riciklueshme dhe ti dërgojë në vendet e caktuara (mbledhësit e mbeturinave dhe tregtarët), 3) të përdorin materiale të riciklueshme në prodhimin e mallrave (fabrika e riciklimit / korporata riciklimi) 4) të krijojnë një shoqëri për të rikuperuar dhe të ricikluar ekskluzivisht për letrën dhe plastikën përmes PPP (fabrika e riciklimit / ofruesi i shërbimit të grumbullimit të veçantë)

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

2) Paraqitja e Aktiviteteve 3R

Sot, aktivitetet 3R janë baza për të ngritur një sistem të suksesshëm të menaxhimit të mbetjeve për njësitë e qeverisjes vendore. Ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve e përfshin këtë koncept për aktivizimin e ligjit për të zgjidhur çështjet e menaxhimit të mbetjeve. Prandaj, aktivitetet 3R duhet të quhen si një nga kuadret kyç në formulimin e planit të menaxhimit të mbetjeve nga njësia e qeverisjes vendore. Zbatimi i aktiviteteve 3R kërkon ngritjen e një sistemi të MMN bazuar në përqasjet e integruara duke përfshirë sistemet e përparuara dhe konvencionale. Për të krijuar një shoqëri të rikuperimit të materialeve në Shqipëri, formulimi i Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës për uljen e sasisë së mbetjeve në landfill dhe ruajtjen e burimeve natyrore të fundme duhet të marrë parasysh këto çështje të rëndësishme:

- Të jetë në përputhje me nivelet e synuara të përcaktuara në ligje dhe plane e strategji kombëtare,
- Të përfshijë në aktivitetet 3R prodhuesit e mbetjeve, grupet e interesit dhe shoqërinë përmes programeve të rritjes së ndërgjegjes së publikut;
- Përdorimi i aktorëve ekzistues si grumbulluesit e mbetjeve dhe industritë e riciklimit në shtrirjen sa më të gjerë përmes mbështetjes dhe asistencës nga BT-ja dhe Qeveria Qendrore,
- Të ngrejë sistemin 3R duke përmblusur rolet dhe përgjegjësitë e prodhuesve të mbetjeve, prodhuesve, BT-së dhe Qeverisë Qendrore për aktivitetet e kontrollit të burimit të prodhimit të mbetjeve, kontrollit të shkarkimit të mbetjeve dhe kontrollit të rikuperimit dhe riciklimit të mbetjeve,
- Aktivitetet e para të 3R duhet të zbatohen në një zonë pilot studimi përfaqësuese dhe modelet e praktikave të mira të zgjerohen në zonat fqinje dhe më tej në gjithë qytetin.

3) Rritja e Aktiviteteve të Ofruesve të Shërbimit të Grumbullimit

Sot, pesë kompanitë private, të cilat kanë kontratë pesëvjeçare, ofrojnë shërbimin e

grumbullimit të mbetjeve në gjashtë zonat e grumbullimit të BT. Në planin e MIMN, që merret me drejtimin e punës për të rritur rikuperimin e burimeve të vlershme në mbetjet, Qeveria Bashkiake do të marrë parasysh masat për të rritur normën e rikuperimit nga shtimi i kontratës së shërbimit për grumbullimin e mbetjeve ku përfshihet futja e shërbimit të grumbullimit të ndarë të mbetjeve Megjithatë, plani për të përfshirë masat kërkon mbështetjen dhe forcimin e sektorit privat (duke përfshirë mbledhësit e mbetjeve) për rikuperimin e burimeve të vlershme.

Zbatimi i grumbullimit të veçantë nga ofruesit e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve private do të thotë një ndryshim nga termat dhe kushtet e sotme. Ofruesit e shërbimeve do të detyrohen të ndryshojnë sistemin e mbledhjes së mbetjeve si pjesë e ndryshimeve të metodës së shkarkimit të mbetjeve. Ofruesit e shërbimeve duhet të përshtaten me rritjen e sasisë së mbetjeve në të ardhmen duke mobilizuar një numër më të madh automjeteve të grumbullimit të mbetjeve dhe punonjësish. Prandaj, për këtë qëllim do të kryhet planifikimi për futjen e grumbullimit të mbetjeve të ndara. Në formulimin e planit të grumbullimit të mbetjeve, në parim do të ndiqet ndarja e gjashtë fushave të grumbullimit të mbetjeve. Numri i automjeteve të nevojshme të grumbullimit në çdo zonë të grumbullimit të mbetjeve do të përcaktohet nga sasia e parashikuar e mbetjeve në secilën zonë të grumbullimit të mbetjeve për të marrë parasysh aftësinë e ofruesve të shërbimeve të grumbullimit, përveç studimit të kushteve shtesë dhe modifikimit të nevojshëm për përmbajtjen e kontratave të reja të shërbimit të grumbullimit të mbetjeve, në të ardhmen.

Plani i grumbullimit të mbetjeve të ndara do të formulohet bazuar në kategoritë e llojeve të ndryshme të mbetjeve, duke marrë parasysh rrymën e mbetjeve të trajtimit të ndërmjetëm dhe depozitimit të mbetjeve, të cilat janë:

Kategorizimi i Llojeve të Mbetjeve për Grumbullimin e Ndarë

- Mbetjet e Riciklueshme të Thata (letër, plastikë, qelq dhe metale)
- Mbetje Organike (Mbetje ushqimi dhe mbetje kopshtarie pa përzierë mbetjet e biodegradueshme të forta)
- Mbetjet e Djegshme (Në të ardhmen: Të gjithë mbetjet e tjera organike duke përfshirë letrën/plastikën e ndotur/të papastër)
- Mbetjet e Padjegshme/Inerte (përfshirë letrën e papastër dhe plastikën në fazën paraprake)
- Mbetjet me vëllim të madh,
- Mbetjet e Rrezikshme Familjare (llamba fluoreshente, etj.)

4) Pakësimi i Shkallës së Zhvillimit të Trajtimit të Ndërmjetëm dhe Impianteve të Depozitimit të Mbetjeve

Pakësimi i mbetjeve ose 3R-të duke ulur sasinë e prodhimit të mbetjeve dhe rritjen e rikuperimit të materialeve të riciklueshme në burimin e shkarkimit të mbetjeve do të rezultojë në një ulje të sasisë së mbetjeve për t'u grumbulluar, trajtimin e ndërmjetëm dhe depozitimin përfundimtar. Kjo do të korrespondojë me një ulje të kostos së menaxhimit të mbetjeve. Zbatimi i suksesshëm i minimizimit të mbetjeve do të jetë çështja kyç për të arritur një performancë të mirë të kostos për tërë sistemin e MMN. Me fjalë të tjera, zhvillimi i impianteve të ndërmjetme dhe atyre të depozitimit përfundimtar, në përmasa të vogla dhe me kosto funksionimi dhe mirëmbajtje sa më të ulët, nuk mund të arrihet pa

rezultatit e suksesshëm të planit të pakësimit të mbetjeve.

Me qëllim uljen e shkallës së impianteve të MMN, përqasjet strategjike për formulimin e planeve përfshijnë, por nuk kufizohen në sa vijon:

- Sigurimi i përputhshmërisë me kërkesat dhe afatin kohor të përcaktuar në ligjet, planet dhe strategjitë kombëtare, si dhe planet rajonale të MMN;
- Përdorimi i metodës miqësore me mjedisin për të rritur rikuperimin dhe riciklimin e materialeve të riciklueshme në mbetje dhe vëllim mbetjesh përmes uljes së sasisë të mbetjeve të prodhuara, ndarjes së materialeve që në burim, grumbullimin e ndarë, ndarjen e dytë dhe sisteme të tjera duke përfshirë dhe sistemin e MIMN,
- Mbajnë përgjegjësinë kryesore për zbatimin me BT-në dhe aktivitetet bashkëpunuese midis grupeve të interesit duke përfshirë agjencitë e Qeverisë Qendrore, sektorin privat, banorët, OJQ-të, industrinë e riciklimit etj.
- Ngritjen e sistemit institucional dhe forcimin e aftësive dhe sigurimin e një numri të mjaftueshëm aktorësh për të kryer aktivitetet në përputhje me planet dhe afatin kohor,
- Sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare dhe transparencë të llogarisë së MMN për zbatimin e planeve vjetore dhe projekteve sipas planifikimit kohor,
- Nxitja dhe forcimi i integritetit në publik dhe edukimi në shkollë për rritjen e ndjeshmërisë së banorëve dhe të gjitha grupeve të interesit për menaxhimin e mbetjeve të ngurta.

5) Lehtësimi i Barrës Fiskale të MMN të Bashkisë së Tiranës

Në vitin fiskal 2010, tarifimi për mbetjet familjare është 5 000 lekë/familje/vit ndërkohë që tarifa për bizneset është përcaktuar në nivelet 1 000 deri në 225 000 lekë/vit. Të ardhurat nga tarifa e mbetjeve arrin në 490 milionë lekë në 2010. Në vitin e mëparshëm fiskal 2009, të ardhurat e përgjithshme nga tarifimi i mbetjeve ishin 617 milionë lekë edhe pse në atë kohë tarifa e mbetjeve për familjet ishte 4 500 lekë/vit dhe tarifimi i mbetjeve për bizneset ishin në të njëjtën përqindje me atë të 2010. Shpenzimet për mbetjet, të lidhura me shërbimet ishin 1 048 milionë lekë në 2010. Përkatesisht, të ardhurat nga tarifa e mbetjeve ishin më të ulëta se 50% e të ardhurave në 2010. Ky sistem tarifash nuk përkon mjaftueshëm me mbulimin e kostos së shërbimeve të MMN. Përmirësimi i shërbimeve të MMN përmes zbatimit të planeve të veprimit të MIMN do të ketë nevojë për kosto më të mëdha, për të përballuar shpenzimet për ngritjen e shërbimeve moderne të MMN në BT. Përcaktimi i tarifës së mbetjeve lidhet me nivelin e të ardhurave dhe dëshirën për të paguar nga përfituesi dhe në këtë fazë paraqitja e tarifimit të rikuperimit të plotë të koston do të jetë një realitet. Përgjithësisht, faza e tarifimit të zgjuar, në vijim, është paraqitur për tarifën e shërbimit publik:

Tarifimi Standard në Faza i Tarifës së Shërbimeve Publike

- Faza e Parë: Mbulimi i kostove të funksionimit dhe mirëmbajtjes,
- Faza e Dytë: Mbulimi i pagave të personelit, përveç kostove të mësipërme,
- Faza e Tretë: Mbulimi i koston së amortizimit, përveç kostove të mësipërme (mbulimi i plotë i koston)

Formulimi i planit do të fillojë me vlerësimin e kostove njësi për ton-mbetje për secilin

proces të shërbimeve të MMN. Kjo do të përfshijë koston për njësi të grumbullimit të mbetjeve, trajtimet e ndërmjetme dhe depozitimin përfundimtar si kosto bazë për të përcaktuar tarifën e mbetjeve dhe për përgatitjen e tarifës së mbetjeve.

6) Shtimi i Burimeve Njerëzore dhe Aftësive

Rekrutimi i numrit të mjaftueshëm të personelit të aftë do të jetë një element i rëndësishëm për të zbatuar planet e veprimit për modernizimin e shërbimit të MMN në BT. Planet e propozuara, programet dhe projektet do të kryhen në bazë të afatit kohor të përcaktuar në Planin MIMN për të arritur nivelin e synuar të secilit aktivitet nga grupet zbatuese. Krijimi i një Task-Team të Projekteve për MMN do të propozohet për të marrë rolin kryesor midis grupeve zbatuese për nxitjen e zbatimit të planeve të veprimit. Personeli do të ketë program orientimi për të kuptuar plotësisht konceptet dhe përmbajtjen e planeve të veprimit dhe kuadrin kohor për zbatim. Personeli i Ekipit të Projekteve për MMN si dhe personeli dhe drejtuesit e sektorëve përkatës dhe Drejtorive duhet të marrin pjesë në kurset e trajnimit të shpeshtë për ngritjen e aftësive të tyre në çështjet teknike dhe menaxheriale. Formulimi i planit për rritjen e aftësive të personelit do të përfshijë një përcaktim të qartë të roleve dhe përgjegjësi të personelit.

(3) Viti i Synuar i Planifikimit

Plani i MIMN të Bashkisë së Tiranës duhet të zbatohet në përputhje me hapat e planeve të veprimit formuluar për planet, programet dhe projektet për zhvillimin e impianteve dhe prokurimit të përcaktuar në këto afate:

- Planet e Ngutshme dhe Afatshkurtra : 2013-2017
- Planet Afatmesme : 2018-2022
- Planet Afatgjata : 2023-2027

(4) Llojet e Synuara të Mbetjeve të Ngurta

BT është përgjegjëse për administrimin e mbetjeve bashkiake të përcaktuara si mbetje të ngurta, që mund të rikuperohen, të mblidhen, trajtohen dhe asgjësohen me metoda të zakonshme. Në formulimin e Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës, llojet e mbetjeve bashkiake janë përcaktuar si më poshtë.

- Mbetjet në familje, duke përfshirë mbetjet vëllimore dhe mbetjet të rrezikshme familjare të krijuara zakonisht nga aktivitetet e jetës së përditshme,
- Mbetjet tregtare dhe të biznesit në sasi të vogël me pak se 30 kg për shkarkim,
- Mbetjet e prodhuara nga ndërtesat publike / institucionale dhe vendet publike,
- Mbetjet e tregjeve,
- Fshirja e rrugës,
- Kafshë të ngordhura të hedhura dhe jashtëqitjet,
- Toka, rrëre, materiale inerte,
- Mbetjet të tjera të pranuar nga BT-ja si mbetje bashkiake

Mbetjet jobashkiake, që nuk janë të listuara më sipër, si mbetjet mjekësore dhe mbetjet industriale të rrezikshme do të depozitohen me përgjegjësi nga prodhuesit e mbetjeve.

(5) Zona e Synuar për Planifikim

BT-ja është përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve për të gjithë zonën e qytetit që mbulon 11 minibashki, si një shërbim themelor publik. Megjithatë, zonat e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve do të jenë përparësi duke përdorur faktorin bazë të përzgjedhjes së dendësisë së popullsisë. Prandaj, zona e shërbimit e synuar do të zgjerohet gradualisht në zonat ngjitur pa shërbim, ku dendësia e popullsisë është në rritje apo dendësia e mbetjeve të shkarkuara është rritur në një nivel të paracaktuar.

5.5.9. Objektivat e Planifikuar dhe Strategjitë e Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës

Midis masave të ndryshme, planet dhe programet e mëposhtme janë zgjedhur për përbërësit e projektit si të mundshëm dhe efektiv për të përmirësuar dhe rritur aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta drejt krijimit të një sistemi të integruar të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në BT:

Përqasja Teknike

- Plani i Grumbullimit dhe Transportimit të mbetjeve,
- Plani i Pakësimit të Mbetjeve (Plani 3R),
- Plani i Trajtimit të Ndërmjetëm,
- Plani i Depozitimit të mbetjeve.

Përqasja institucionale dhe financiare

- Plani i Zhvillimit të Kapaciteteve Institucionale,
- Plani i Fuqizimit Financiar,
- Plani i Rritjes së Ndërgjegjësimit të Publikut.

Në formulimin dhe zbatimin e planeve të paraqitura më lart, objektivi dhe strategjia e planeve përkatëse është përcaktuar si më poshtë:

(1) Plani i Grumbullimit dhe Transportimi i mbetjeve

1) Objektivat e Planifikimit

- Objektivi kryesor i grumbullimit të mbetjeve është për të ruajtur pastër të gjithë zonën në juridiksionin administrativ në mënyrë që të përmirësojë higjienën dhe shëndetin publik dhe për të mbrojtur mjedisin gjithashtu, të ndalojë hedhjen e paligjshme të mbetjeve në zonat publike
- Objektivi i zonave të shërbimit të grumbullimit të ndarë të mbetjeve është për të rritur rikuperimin e materialeve burimore të mbetjet për të ndihmuar për krijimin e shoqërisë së shëndoshë drejt riciklimit të burimeve.

2) Strategjitë e Planifikimit

- Së pari, Bashkia e Tiranës do të mbajë zonat e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve, që ka tani;
- Së dyti, Bashkia e Tiranës duhet të sigurojë zonat e pastrimit në zonat e rrethinave ku dendësia e mbetjeve të shkarkuara është e lartë dhe kontejnerët e mbetjeve nuk janë vendosur ende;
- Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve duhet të ofrohet në zonat e largëta ku/kur mbetjet e shkarkuara arrijnë një dendësi të lartë;

- Siç kërkohet nga prodhuesit e mbetjeve, Bashkia e Tiranës duhet të sigurojë shërbimet e grumbullimit të mbetjeve për mbetjet bashkiake vëllimore dhe lloje të tjera të mbetjeve si mbetjet bashkiake duke përcaktuar tarifë të veçantë mbetjesh;
- Bashkia e Tiranës duhet të ristrukturojë, përditësojë dhe kryejë shërbimin e grumbullimit të mbetjeve nga ofruesit e shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve drejt përcaktimit të grumbullimit dhe transportimit të ndarë të mbetjeve, nën mbikëqyrjen e Bashkisë së Tiranës;
- Grumbullimi i ndarë i mbetjeve fillimisht duhet të paraqitet me sistemin me 3 kontejnerë dhe të ndërrohet në sistemin me 4 kontejnerë, para paraqitjes së sistemit të mbetjeve në energji në të ardhmen.

(2) Plani i Pakësimit të Mbetjeve (3R Plan)

1) Objektivat e Planifikimit

- Objektivi parësor i pakësimit të mbetjeve, duke përfshirë uljen e sasisë, riciklimin dhe ripërdorimin është pakësimi i shkarkimit të ndotësve të mundshme (mbetjet) në mjedis dhe për të zvogëluar barrën e kostos për ruajtjen e mjedisit krahas lehtësisë të barrës së kostos të Bashkisë së Tiranës duke ulur sasinë e mbetjeve të ngurta për grumbullimin, trajtimin e ndërmjetme dhe depozitim,
- Objektivi i rikuperimit të burimeve, ripërdorimit dhe riciklimit është të përdorin materiale të riciklueshme burimore të mbetjet për ruajtjen e burimeve natyrore të fundme për brezat e ardhshëm.

2) Strategjitë e Planifikimit

- Pakësimi i mbetjeve, rikuperimi i burimeve dhe riciklimi do të kryhen fillimisht me sistemin e 3-kontejnerëve dhe do të fillojë me ndarjen e mbetjeve në burim si një sistem themelor sipas kushteve për të kryer përgjegjësitë dhe rolet e aktorëve të përfshirë në gjithë sektorët e qeverisë, Bashkisë Tiranë, banorët dhe institucionet;
- Rikuperimi i të riciklueshmeve do të ndërrohet në sistemin me 4-kontejnerë për sa kohë sistemi i mbetjeve në energji është funksional në të ardhmen;
- Funksionet e grupeve të komunitetit, si grupeve të besimtarëve në xhami/kishë, shkollave, organizatave për të rinjtë etj. duhet të lehtësohen në masën më të madhe për aktivitetet e uljes së mbetjeve, riciklimin dhe rikuperimin e burimeve;
- Fuqizimi i funksionit të stacioneve të grumbullimit të burimeve apo krijimi i qendrave të rikuperimit të materialeve të tilla si, impiantet e rikuperimit të materialeve, bankat e mbetjeve, qendra e riblerjes etj., të vendosura në disa vende në zonën e qytetit;
- Asistimi/Përkrahja e aktiviteteve të grumbulluesve të mbetjeve, tregtarëve dhe industrive të riciklimit të lidhura me aktivitetet e 3R-ve, në Bashkinë e Tiranës.

(3) Plani i Trajtimit të Ndërmjetëm

1) Objektivat e Planifikimit

- Objektivat e trajtimit të ndërmjetëm janë të stabilizojnë dhe dekompozojnë mbetjet dhe të ulin vëllimin e tyre, veç shndërrimit të mbetjeve për rikuperimin e burimeve.

2) Strategjitë e Planifikimit

- Ndarja e mbetjeve në burim, rikuperimi i materialeve dhe sistemet e grumbullimit të ndara duhen bërë para se mbetjet të hyjnë në proceset e trajtimit të ndërmjetëm;

- Proceset e Trajtimit të Ndërmjetëm duhet të projektohen për proceset e rikuperimit të burimeve sa më shumë të jetë e mundur, duke përfshirë dhe mënyrën e incenerimit dhe prodhimit të energjisë elektrike, kompostimit, biogazifikimit etj., për të kthyer mbetjet në energji dhe/ose ricikluar produkte;
- Paraqitja e kompostimit duhet të filloj me kompostimin në familje, kompostimin në komunitet, kompostimin në qendra pilot dhe në fund, zhvillimi i impianteve qendrore të kompostimit në shkallë të madhe;
- Paraqitja e kompostimit duhet të bëhet në bashkëpunim me grupet e fermerëve, fidanishtet, parqet dhe pyjet, etj., për një përdorim të duhur dhe shpërndarje të produkteve përfundimtare.

(4) Plani i Depozitimit të Mbetjeve

1) Objektivat e Planifikimit

- Depozitimi i mbetjeve duhet të jetë procesi i fundit i menaxhimit të mbetjeve për të depozituar dhe magazinuar përgjithmonë mbetjet pa asnjë vlerë për rikuperim dhe/ose kthim të burimeve për përdorim të mëtejshëm dhe të mbrojtë zonat përreth nga ndotjet dytësore.

2) Strategjitë e Planifikimit

- Mbetjet e trajtuara ose jo të rrezikshme familjare dhe inerte, janë mbetjet subjekt për zhvillimin e impianteve të depozitimit përfundimtar të mbetjeve për Bashkinë e Tiranës;
- Impiantet e depozitimit përfundimtar të mbetjeve duhet të zhvillohen duke marrë parasysh sasinë e mbetjeve, që do shmanget në përputhje me sasinë e mbetjeve të planifikuara për depozitim të derivuar nga zbatimi hap pas hapi i rikuperimit të burimeve dhe/ose trajtimit të ndërmjetëm;
- Landfilli sanitar është vlerësuar si metoda më e mirë për depozitim si nga pikëpamja ekonomike dhe mjedisore për zhvillimin e landfillit të mbetjeve jo të rrezikshme. BT-ja duhet të zhvillojë impiantet e depozitimit përfundimtar të mbetjeve përpara fundit të jetës së venddepozitimit të mbetjeve, Sharrë;
- Zhvillimi i impianteve të reja të landfillit duhet të kryhet për më shumë se një venddepozitim kandidat dhe propozimi i zhvillimeve në të ardhmen është bazuar në rezultatin e një studimi të mirë të vendit;
- Ndotja dytësore e mundshme e venddepozitimit të mbetjeve duhet të ulet për të përkohet me praktikën standarde, që përputhen me guidat e BE-se ose të standardeve të tjera ndërkombëtare;
- Zhvillimi i zonës së landfillit duhet të bëhet hap pas hap dhe zona ngjitur duhet të prokurohet për zgjerimin në të ardhmen për një periudhë afatgjatë dhe/ose zhvillimit të impianteve të ndërmjetme për të vazhduar trajtimin e plotë të mbetjeve dhe funksionet e venddepozitimit në vendin e ri.

(5) Plani i Zhvillimit të Kapaciteteve Institucionale

1) Objektivat e Planifikimit

- Objektivi i zhvillimit të kapaciteteve institucionale është që të krijojë marrëveshjet më të përshtatshme institucionale dhe organizative për t'i mundësuar Bashkisë Tiranë të zbatojë në mënyrë të frytshme menaxhimin e mbetjeve të ngurta formuluar me Planin e Integruar të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta të Bashkisë së Tiranës dhe për të përcaktuar veprimet zbatuese mbi periudhën planifikuese afatgjatë.

2) Strategjitë e Planifikimit

- Zhvillimi i kapaciteteve institucionale duhet të përqendrohet në forcimin e strukturës organizative, praktikat menaxheriale dhe teknike për funksionimin e qëndrueshëm dhe mirëmbajtjen e sistemit të MMN të propozuar,
- Zhvillimi i kapaciteteve institucionale kryhet kryesisht për Ekipin e Punës të Projekteve propozuar për t'u krijuar në Drejtorinë e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në BT për forcimin e kapaciteteve për të zbatuar Planin e MIMN të BT.

(6) Plani i Forcimit Financiar

1) Objektivat e Planifikimit

- Objektivi i fuqizimit financiar fillimisht është për të siguruar buxhetin për koston e nevojshme të mirëmbajtjes dhe funksionimit të planit MIMN të propozuar, dhe për të materializuar një financim të pavarur për vendosjen e koston së rikuperueshme të MMN në fazën përfundimtare, për zbatimin e projekteve të ardhshme.

2) Strategjitë e Planifikimit

- Tarifa e mbetjeve, që zbatohet duhet të rishikohet duke pasur parasysh koston për njësi për t'u vlerësuar respektivisht: grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve, trajtimin e ndërmjetëm dhe gatishmërinë për të paguar edhe shumën e shpenzimeve për tarifat e shërbimeve publike duke iu referuar rezultatit të studimit të ndërgjegjësimit shoqëror për menaxhimin e mbetjeve;
- Sistemi optimal i tarifimit të taksës së mbetjeve, do të paraqitet për burimet financiare të MMN për të mbuluar të paktën kostot për funksionimin dhe mirëmbajtjen në fazën fillestare. Kësaj i shtohen shpenzimet e personelit në fazën e dytë dhe në fund të detyrojnë tarifën e mbetjeve për mbulimin e plotë të koston, duke përfshirë koston e amortizimit të kostove të investimeve kapitale,
- Transparenca e llogarisë së menaxhimit të mbetjeve të ngurta do të vendoset për të ditur të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat, si bazë për të përcaktuar shkallën e mbetjeve të tarifuara.

(7) Plani i Rritjes së Ndërgjegjes së Publikut

1) Objektivat e Planifikimit

- Objektivi është përcaktuar për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe të gjitha palëve të interesuara për pjesëmarrje nga aktorët që përmbushin rolin e tyre në aktivitetet e propozuara MMN në Planin MIMN të Bashkisë së Tiranës, që duhet të kryhet në përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të Bashkisë së Tiranës.

2) Strategjitë e Planifikimit

- Për të bërë plotësisht të kuptueshëm Planin e MIMN të Bashkisë së Tiranës për trupën e zbatimit dhe personelin menaxherial të Bashkisë së Tiranës. Atyre do t'u kërkohet të kenë ide të qartë se në të cilat pika është e rëndësishme të kërkojnë bashkëpunimin me shoqërinë për zbatimin me sukses të planeve të veprimit dhe programeve,
- Zbatimi i programeve arsimore për të nxitur një kuptim më të mirë të qytetarëve, grupeve të komunitetit dhe të gjitha palëve të përfshira në aktivitetet e MMN nëpërmjet edukimit të publikut dhe shkollave si dhe fushatave publike duke futur programe të realizueshme të rregullta arsimore. Gjithashtu, duhet të përfshijë vizitën në vendin ku funksionojnë shërbimet e MMN.

5.6. Rrjedha e Përgjithshme e Mbetjeve bazuar në “3R-të”

5.6.1. Qëllimi i Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës

MIMN është hartuar për të realizuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe një menaxhim të mirë për këtë qëllim, kontroll sistematik të elementeve funksionale të prodhimit të mbetjeve, ndarjes, shkarkimit të mbetjeve, rikuperimit të mbetjeve të riciklueshme në burim të prodhimit të mbetjeve; grumbullim dhe transportim i ndarë i mbetjeve, dhe procesimi, shndërrimi, magazinimi dhe landfilli sanitar i lidhur me menaxhimin e mbetjeve të ngurta nga burimi i prodhimit të mbetjeve deri në depozitimin përfundimtar përmes zhvillimit të kapaciteteve institucionale, fuqizimit financiar dhe futjes së partneritetit publik privat; rritjes së ndërgjegjes publike duke përmbushur rolet e të gjithë aktorëve të interesuar. Me fjalë të tjera, Plani i MIMN i Tiranës po synon të ngrejë një sistem të frytshëm të MMN bazuar në zhvillimin e “3R+Mbetje në Energji” për përjasjen teknike kryesore dhe fuqizimin e financimit të MMN për përjasjet kryesore institucionale dhe financiare të sistemuara në një rend hierarkik.

Jeta e njeriut është themeluar në konsumin e burimeve natyrore dhe prodhimi i mbetjeve u shfaq si një pasojë. Duke pasur parasysh burimet e kufizuara natyrore, njerëzit e sotëm duhet të ruajnë burimet natyrore dhe dorëzimin e tyre brezave të ardhshëm. Ruajtja e burimeve natyrore ose zbatimi i MIMN është një aktivitet i madh për krijimin e një shoqërie të shëndoshë drejt riciklimit të burimeve dhe qëllimit përfundimtar të njerëzve sot.

5.6.2. Rrjedha e Propozuar e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Tiranës

Në përputhje me konceptin bazë të paraqitur në seksionin e mëparshëm, “3. Kuadri i Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë së Tiranës”, Figura 5.6.1 përmbledh skemën e propozuar për hartimin e Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës, bazuar në rrjedhën e mbetjeve për grumbullim, aktivitetet 3R, trajtimit të ndërmjetëm dhe depozitimit përfundimtar.

Në thelb, skema e mbetjeve është ndarë në proceset e: 1) grumbullimit, 2) pakësimit, rikuperimit, ripërdorimit dhe riciklimit, 3) trajtimit të ndërmjetëm dhe 4) depozitimit përfundimtar. Çdo proces është i ndarë në kategori/implante duke përfshirë edhe proceset.

Prodhuesit e mbetjeve janë kategorizuar në: 1) familjet, tregtarët, bizneset dhe institucionet, 2) tregjet e fruta-perimeve, 3) hotelet dhe restorantet, 4) qendrat tregtare, 5) parqet, 6) mbetjet vëllimore, 7) fshirja e rrugëve, dhe 8) mbetje të rrezikshme familjare si burimet objektive të prodhuesve të mbetjeve. Pakësimi i mbetjeve do të synohet për katër prodhuesit e parë të mbetjeve të listuar në vijim.


Grumbullimi i mbetjeve do të kryhet fillimisht me sistemin me 3-kontejnerë duke përfshirë: 1) kontejnerin e të riciklueshmeve të thata: për letrën, plastikën, qelqin dhe metalet e pastra 2) kontejnerët për të riciklueshmet e njoma për mbetjet organike ose mbetje të biodegradueshme, dhe 3) kontejnerët e mbetjeve, për mbetjet e djegshme duke përfshirë rërë dhe materiale inerte. Kontejneri i katërt do të vendoset në të ardhmen për të grumbulluar mbetjet e djegshme duke përfshirë letrën dhe plastikën

Rikuperimi i materialeve të riciklueshme nga burimet e prodhuesve të mëdhenj të mbetjeve do të kryhet drejtpërdrejt nga industritë e riciklimit dhe/ose Sipërmarrja ALB e Rikuperimit dhe Riciklimit të Burimeve, që do të propozohet në Planin e MIMN. Implanti qendror i rikuperimit të materialeve do të propozohet në Sharrë për të kryer ndarjen e dytë të kontejnerit të të riciklueshmeve të thata për të rikuperuar letrën e pastër dhe plastikën. Në zonën e qytetit, prodhuesit e mbetjeve sjellin materialet e riciklueshme dhe/ose sendet e përdoruara në vendet e

rikuperimit, që do të quhen bankat e mbetjeve, qendrat e riblerjes ose impiantet e rikuperimit të materialeve në qytet (QRM në Qytet) në këmbim të parave ose të mirave për përfitim. Ato materiale të riciklueshme dhe/ose sende të ripërdorura do të transferohen, nëse ka, përmes dyqaneve të riparimit, në Tregjet e të Dielës ose Tregjet e Rugës ose fabrikat e riciklimit bazuar në karakteristikat përkatëse të materialeve të riciklueshme.

Sistemi i trajtimit të ndërmjetëm do të përmbajë: 1) kompostimin në familje, 2) kompostimin në komunitet, 3) impiantin qendror të kompostimit, 4) impiantin e biogazifikimit, 5) impiantet e prodhimit të energjisë, 6) impianti i djegies dhe 7) impianti i grirjes së mbetjeve vëllimore për qëllime të rikuperimit të energjisë, uljes së vëllimit dhe stabilizimit të mbetjeve.

Në fund, për depozitimin e mbetjeve, planet për 1) mbylljen pas fundit të jetës së landfillit ekzistues të Sharrës, 2) landfillin sanitar dhe, 3) magazinimin e mbetjeve të rrezikshme familjare duhet të sigurohet për të mbyllur sistemin.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figure 5.6.1 Rrjedha Bazë e Mbetjeve të Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta

në Bashkinë e Tiranës

5.6.3. Komponentët e Planit të MIMN

Masterplani i MMN, ndryshe quajtur Plani i MIMN të Bashkisë së Tiranës, është përbërë nga këta shtatë (7) zëra:

Përqasja Teknike

- Plani i Grumbullimit dhe Transportimit të Mbetjeve,
- Plani i Pakësimit të Mbetjeve (Plani 3R),
- Plani i Trajtimit të Ndërmjetëm,
- Plani i Depozitimit të Mbetjeve.

Përqasja institucionale dhe financiare

- Plani i Zhvillimit të Kapaciteteve Institucionale,
- Plani i Fuqizimit Financiar,
- Plani i Rritjes së Ndërgjegjësimit të Publikut.

5.7. Plani i Grumbullimit dhe Transportimit të Mbetjeve

Nga seksioni më poshtë, planet dhe programet, që përfshihen në Planin e MIMN të Bashkisë së Tiranës do të përcaktojnë kushtet themelore për të formuluar planin dhe zhvillimin në faza të tij për periudhën 2013-2027 duke filluar me planin e grumbullimit të mbetjeve dhe transportit.

5.7.1. Kushtet Bazë për Planin e Grumbullimit dhe Transportimit të Mbetjeve

(1) Sasia e Planifikuar e Grumbullimit dhe Transportimit të Mbetjeve

Sasia e përgjithshme e mbetjeve, e treguar në seksionet e mësipërm “Sasia Gjithsej e Mbetjeve Bashkiake” është vlerësuar për sasinë e mundshme të mbetjeve për grumbullimin e mbetjeve në secilën zonë të shërbimit të grumbullimit siç tregohet në Tabelën 5.7.1. Sasia e mbetjeve të grumbulluara në secilën zonë lëviz nga 90t/ditë në 153t/ditë në 2012. Popullsia në të ardhmen do të rritet në secilën zonë shërbimi dhe sasia e grumbullimit të mbetjeve do të rritet në nivelin e 109-185 t/ditë në 2017, 130-219 t/ditë në 2022 dhe 151-253 to/ditë në 2027. Sasia e mbetjeve të grumbulluara do të jetë më pak se sasia e vlerësuar e grumbullimit të mbetjeve në varësi të aktiviteteve 3R. Duke marrë parasysh rikuperimin e materialeve të ricikluara në qytet, sasia e mbetjeve të grumbulluara është vlerësuar përafërsisht 10% më pak se sasia e sipërpërmendur. Veç kësaj, programi i pakësimit të mbetjeve me planin e MIMN për të përcaktuar sasinë e prodhimit të mbetjeve do të sjellë ulje të mëtejshme të sasisë së mbetjeve të grumbulluara, në të ardhmen.

Tabela 5.7.1 Sasia e Mundshme e Mbetjeve të Grumbulluara dhe të Transportuara (t/ditë)

Zonat e Grumbullimit	Sasia Gjithsej e Mbetjeve (t/ditë)															
	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Lindore-1	90	94	97	101	105	109	113	117	121	126	130	134	138	142	146	151
Lindore-2	99	103	107	112	116	120	125	129	134	138	143	147	152	156	161	166
Lindore-3	115	120	125	130	135	140	146	151	156	161	167	172	177	182	188	193
Perëndimore-1	119	124	130	135	141	147	152	158	164	170	176	182	187	193	199	205
Perëndimore-2	107	111	116	121	126	130	135	140	145	150	155	160	165	170	175	180
Perëndimore-3	153	159	165	172	178	185	192	198	205	212	219	226	232	239	246	253
Gjithsej	683	712	741	771	801	832	863	894	925	957	990	1 020	1 051	1 083	1 115	1 148

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-S

(2) Kapaciteti i Kërkuar i Grumbullimit dhe Transportimit të Mbetjeve

1) Kapaciteti i Tanishëm i Grumbullimit dhe Transportimit të Mbetjeve

Kapaciteti i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve është vlerësuar bazuar në numrin e mjeteve ekzistuese, që veprojnë në secilën zonë shërbimi duke supozuar se secili mjet kryen dy udhëtime në ditë siç tregohet në Tabelën 5.7.2.

Tabela 5.7.2 Kapaciteti i Tanishëm i Grumbullimit dhe Transportimit të Mbetjeve në Secilën Zonë Shërbimi

Zonat e Shërbimit të Grumbullimit	Lloji i Mjeteve	Kapaciteti i ngarkimit (t)	Nr. i mjeteve	Nr. i Rrugëve Gjithsej	Kapaciteti i Grumbullimit (t/ditë)	Nr. i Kërkuar i Shoferëve	Nr. i punonjësve të kërkuar për grumbullim
Lindore-1	Kompaktor & Mjet i hapur	3.5 - 14	7	14	130	14	42
Lindore-2	Kompaktor & Mjet i hapur	3.5 - 17.8	7	14	142	14	42
Lindore-3	Kompaktor & Mjet i hapur	3.5 - 14	9	18	138	18	54
Perëndimore-1	Kompaktor & Mjet i hapur	3.5 - 16	10	20	167	20	60
Perëndimore-2	Kompaktor & Mjet i hapur	3.5 - 17.8	8	16	202	16	48
Perëndimore-3	Kompaktor & Mjet i hapur	3.5 - 14	10	20	176	20	60
Totali			51	102	955	102	306

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, BT, Mars 2012, Ekipi Studimor i JICA-s

Kapaciteti më i ulët i grumbullimit është vlerësuar në 130ton/ditë në Lindore-1 dhe kapaciteti më i lartë është vlerësuar në 202 tonë/ditë në zonën e shërbimit Perëndimore-2. Si rezultat, kapaciteti i grumbullimit të mbetjeve i vlerësuar në çdo zonë shërbimi është mjaftueshëm për sasinë e mundshme të grumbullimit të mbetjeve. Kapaciteti i grumbullimit të gjithë zonës së shërbimit është vlerësuar aktualisht në 955 tonë/ditë. Tabela 5.7.3 tregon hollësitë e vlerësimit të kapacitetit të grumbullimit në secilën zonë shërbimi.

Tabela 5.7.3 Hollësitë e Kapacitetit të Tanishëm të Grumbullimit dhe Transportimit të Mbetjeve në Secilën Zonë

Lindore-1				
Lloji i Mjeteve	Kapaciteti i ngarkimit (t)	Nr. i mjeteve	Nr. i Rrugëve Gjithsej	Kapaciteti i Grumbullimit (t/ditë)
Kompaktorë	14	1	2	28
Kompaktorë	12	3	6	72
Kompaktorë	6,5	1	2	13
Mjet i Hapur	3,5	1	2	7
Mjet i Hapur	5	1	2	10
Gjithsej Lindore-1		7	14	130
Lindore-2				
Lloji i Mjeteve	Kapaciteti i ngarkimit (t)	Nr. i mjeteve	Nr. i Rrugëve Gjithsej	Kapaciteti i Grumbullimit (t/ditë)
Kompaktorë	17,8	2	4	71
Kompaktorë	14	1	2	28
Kompaktorë	6,5	2	4	26
Mjet i Hapur	3,5	1	2	7
Mjet i Hapur	5	1	2	10
Gjithsej Lindore -2		7	14	143
Lindore -3				
Lloji i Mjeteve	Kapaciteti i ngarkimit (t)	Nr. i mjeteve	Nr. i Rrugëve Gjithsej	Kapaciteti i Grumbullimit (t/ditë)
Kompaktorë	14	1	2	28
Kompaktorë	12	1	2	24
Kompaktorë	10	1	2	20
Kompaktorë	6,5	4	8	52
Mjet i Hapur	3,5	2	4	14
Gjithsej Lindore -3		9	18	138
Perëndimore-1				
Lloji i Mjeteve	Kapaciteti i ngarkimit (t)	Nr. i mjeteve	Nr. i Rrugëve Gjithsej	Kapaciteti i Grumbullimit (t/ditë)
Kompaktorë	16	1	2	32
Kompaktorë	12	2	4	48
Kompaktorë	10	2	4	40
Kompaktorë	6,5	1	2	13
Mjet i Hapur	3,5	2	4	14
Mjet i Hapur	5	2	4	20
Gjithsej Perëndimore-1		10	20	167
Perëndimore -2				
Lloji i Mjeteve	Kapaciteti i ngarkimit (t)	Nr. i mjeteve	Nr. i Rrugëve Gjithsej	Kapaciteti i Grumbullimit (t/ditë)
Kompaktorë	17,8	1	2	36
Kompaktorë	16	3	6	96
Kompaktorë	14	2	4	56
Mjet i Hapur	3,5	2	4	14
Gjithsej Perëndimore-2		8	16	202
Perëndimore -3				
Lloji i Mjeteve	Kapaciteti i ngarkimit (t)	Nr. i mjeteve	Nr. i Rrugëve Gjithsej	Kapaciteti i Grumbullimit (t/ditë)
Kompaktorë	14	1	2	28

Kompaktorë	12	2	4	48
Kompaktorë	10	3	6	60
Kompaktorë	6,5	1	2	13
Mjet i Hapur	3,5	1	2	7
Mjet i Hapur	5	2	4	20
Gjithsej Perëndimore-3		10	20	176

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, BT, Mars 2012, Ekipi Studimor i JICA-s

2) Kapaciteti i Kërkuar në të Ardhmen për Grumbullimin e Mbetjeve

Kapaciteti i tanishëm i grumbullimit të mbetjeve dhe sasia e kërkuar e grumbullimit të mbetjeve në të ardhmen janë dhënë në Tabela 5.7.4. Kapaciteti i grumbullimit është i mjaftueshëm në secilën zonë të shërbimit për sasinë e kërkuar të grumbullimit të mbetjeve në 2017. Kapacitetet e grumbullimit prej 138t/ditë në Lindore 3 dhe prej 176 t/ditë në Perëndimore 3, janë më pak se kapaciteti i kërkuar i grumbullimit prej 150t/ditë dhe 199 t/ditë respektivisht në 2017. Në 2022 dhe 2027, kapacitetet e grumbullimit të mbetjeve në të gjitha zonat e shërbimit, përveç Perëndimore 2 janë më pak se sasi të kërkuara të grumbullimit të mbetjeve.

Tabela 5.7.4 Kapaciteti i Kërkuar i Grumbullimit dhe Transportimit të Mbetjeve në të Ardhmen

Zonat e Shërbimit të Grumbullimit	Kapaciteti i Tanishëm i Grumbullimit (t/ditë)	Kapaciteti i Kërkuar i Grumbullimit të Mbetjeve (t/ditë)			
		2012	2017	2022	2027
Lindore-1	130	90	109	130	151
Lindore-2	142	99	120	143	166
Lindore-3	138	115	140	167	193
Perëndimore-1	167	119	147	176	205
Perëndimore-2	202	107	130	155	180
Perëndimore-3	176	153	185	219	253
Gjithsej	955	683	831	990	1,148

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

(3) Kapaciteti Mbajtës i Kontejnerëve të Mbetjeve

1) Kapaciteti i Tanishëm Mbajtës i Kontejnerëve të Mbetjeve

Kapaciteti mbajtës i mbetjeve është vlerësuar mbështetur në numrin ekzistues të kontejnerëve të mbetjeve në çdo zonë të grumbullimit duke supozuar një dendësi të mbetjeve për konvertimin e vëllimit në peshën e mbetjeve. Kapaciteti mbajtës i kontejnerëve të mbetjeve në secilën zonë të grumbullimit është vlerësuar në Tabelën 5.7.5. Kapaciteti mbajtës i zonës Lindore-2 është më i ulët duke gjykuar përqindjen mbajtëse prej 76%, që është llogaritur nga pjesëtimi i kapacitetit mbajtës me sasinë e mbetjeve të zonës së shërbimit në 2012. Kontejnerë të tjerë mbetjesh kanë zëvendësuar të vjetrit në Zonën Lindore-3, suke filluar që nga 1 shkurt 2012. Gjithsesi, kapaciteti total mbajtës, i vlerësuar nuk është i mjaftueshëm për sasinë e mbetjeve në zonën e shërbimit. Ndërkohë, kapaciteti mbajtës në zonën Perëndimore-2 tregon përqindjen më të lartë të kapacitetit mbajtës me 97%. Si rezultat, kapaciteti mbajtës në secilën zonë nuk është i mjaftueshëm, edhe pse rreth 10% e mbetjeve bashkiake grumbullohet drejtpërdrejt nga operatorët privatë të grumbullimit, të cilat nuk shkarkohen në kontejnerët e mbetjeve. Grumbullimi i mbetjeve kryhet dy herë

në ditë në zonat ku kapaciteti mbajtës është i pamjaftueshëm për të përballuar problemet e depozitimit të mbetjeve.

Tabela 5.7.5 Kapaciteti Mbjtës i Kontejnerëve të Mbetjeve në Secilën Zonë Shërbimi

Zonat e Shërbimi	Nr. i Kontejnerëve	Vëllimi i Kontejnerëve (m³)	Kapaciteti Mbjtës për Kontejnerë (ton)	Kapaciteti Mbjtës (tonë)	Sasia e Mbetjeve në 2012 (tonë/ditë)	Përqindja e Mbjtjes të Sasia e Mbetjeve (%)
Lindore-1	468	1,7	0,149	70	90	78%
Lindore-2	506	1,7	0,149	75	99	76%
Lindore-3	650	1,7	0,149	97	115	84%
Perëndimore-1	707	1,7	0,149	105	119	88%
Perëndimore-2	696	1,7	0,149	104	107	97%
Perëndimore-3	825	1,7	0,149	123	153	80%
Gjithsej	3852			573	683	84%

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

2) Kapaciteti Mbjtës, i kërkuar i Kontejnerëve të Mbetjeve në të Ardhmen

Kapaciteti i sotëm mbajtës i kontejnerëve dhe kapaciteti mbajtës i kërkuar në të ardhmen janë paraqitur në Tabelën 5.7.6. Kapaciteti mbajtës i mbetjeve nuk është i mjaftueshëm në secilën zonë të mbetjeve për të përballuar sasinë e mbetjeve të kërkuara në 2012. Ka vështirësi në vendosjen e kontejnerëve të mbetjeve, veçanërisht në rrethina ose në rrugë të ngarkuara dhe të zëna. Në këto zona shërbimi i grumbullimit kryhet dy herë në ditë për të mbuluar kapacitetin mbajtës të pamjaftueshëm të kontejnerëve të mbetjeve. Vendosja dhe/ose zëvendësimi i kontejnerëve të mbetjeve duhen të përkohet me sasinë e mundshme të grumbullimit të mbetjeve.

Tabela 5.7.6 Kapaciteti Mbjtës i Kërkuar i Kontejnerëve të Mbetjeve në të Ardhmen


Zonat e Shërbimi	Kapaciteti Mbjtës (tonë)	Sasia e Mundshme e Grumbullimit të Mbetjeve (t/ditë)			
		2012	2017	2022	2027
Lindore-1	70	90	109	130	151
Lindore-2	75	99	120	143	166
Lindore-3	97	115	140	167	193
Perëndimore-1	105	119	147	176	205
Perëndimore-2	104	107	130	155	180
Perëndimore-3	123	153	185	219	253
Gjithsej	573	683	832	990	1 148

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

(4) Zonat e Pambuluara me Shërbimin e Grumbullimit të Mbetjeve

Plani i MIMN i Bashkisë së Tiranës është hartuar të mbulojë të gjithë zonën e bashkisë për shërbimet e grumbullimit të mbetjeve. Sot, disa nga zonat nuk janë të mbuluara nga shërbimet ditore të grumbullimit të mbetjeve dhe banorët e këtyre zonave ankohen për gjendjen dhe dëmtimin mjedisor. Zonat pa shërbim janë përfutur duke mbivendosur disa shtresa të të dhënave GIS, të marra nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, BT dhe janë treguar në Figurën 5.7.1. Të dhënat u përpunuan për të treguar zonat pa asnjë shërbim grumbullimi në një rreze 200m nga vendndodhja e secilit kontejner mbetjesh, kufijtë e 6 zonave të shërbimit të grumbullimit të mbetjeve dhe 11 minibashkitë. Sipas hartës së përpunuar në GIS, është vërejtur se zona e

shërbimit të grumbullimit të mbetjeve nuk mbulon zonën administrative të bashkisë. Gjithsesi, shumica e zonës në qytet është brenda zonës së shërbimit të grumbullimit të mbetjeve, përveç zonave të rrethinave dhe zonave të reja të zhvilluara. Të dhënat u përpunuan gjithashtu, për të treguar zonat e pambuluara ose pa shërbim të grumbullimit të mbetjeve, dhe të paraqitura në Tabelën 5.7.7 deri në Tabelën 5.7.10. Tabela 5.7.7 tregon se zona e shërbimit të grumbullimit është matur për të mbuluar rreth 39km², ndërkohë vlerësimi i zonës së mbuluar me shërbim brenda rrezes 200 m nga kontejneri i mbetjeve mbulon një sipërfaqe prej 27 km². Kjo nënkupton një boshllëk prej 12 km² në zonë. Në anën tjetër, Tabela 5.7.9 tregon zonën administrative të BT-së, e cila është përafërsisht 43 km² dhe, si e tillë, zonat e pambuluara gjithsej të BT-së do të jenë në 16 km² e llogaritur nga zona e mbuluar me kontejnerë mbetjesh e vlerësuar në 27 km², siç përmendet më lart. Këto zona të pambuluara do jenë zona të synuara në hartimin e planit të MIMN për zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve në BT.



Burimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit, BT, Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 5.7.1 Zona e Pambuluar me Shërbimin e Grumbullimit të Mbetjeve në BT

Tabela 5.7.7 Përmbledhja e Zonave të Pambuluara me Shërbim nga Zona me Shërbim Grumbullimi

Zonat e Grumbullimit	Sipërfaqja e Përgjithshme e Shërbimit të Grumbullimit (km ²)	Minibashkitë në Zonën e Grumbullimit	Sipërfaqja e Përgjithshme e minibashkive në Zonën e Grumbullimit të Mbetjeve (km ²)	Sipërfaqet e Përgjithshme të minibashkive të pambuluara me Shërbim Grumbullimi (km ²)	Sipërfaqet totale të mbuluara sipas bufer 200m nga kontejneri i mbetjeve (km ²)	Sipërfaqet e Përgjithshme të pambuluara sipas bufer 200m nga kontejneri i mbetjeve (km ²)	Liqen & Park
Lindore-1	5,41	Minibashkia – 3,4,8,9	5,03	0,38	3,90	1,51	
Lindore-2	4,04	Minibashkia – 1,2,3,4,,8,9	4,03	0,01	3,51	0,53	

Lindore-3	11,74	Minibashkia – 1,2,3,5	11,28	0,46	5,73	6,01	1,92
Perëndimore-1	7,04	Minibashkia – 7,9,10,11	6,90	0,14	5,25	1,79	
Perëndimore-2	4,33	Minibashkia – 2,5,6,7,9,10	4,30	0,03	3,91	0,42	
Perëndimore-3	6,87	Minibashkia – 2,5,6,7	6,73	0,14	5,17	1,70	0,02
Gjithsej	39,43		38,26	1,17	27,47	11,96	

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Tabela 5.7.8 Hollësitë e Zonave të Pambuluara në Minibashkitë nga Zona e Shërbimit të Grumbullimit

Zonat e Grumbullimit	Sipërfaqja e Përgjithshme e Grumbullimit të Mbetjeve (km ²)	Minibashkia në Zonën e Grumbullimit	Sipërfaqja e minibashkive në Zonën e Shërbimit të Grumbullimit (km ²)	Sipërfaqja e Përgjithshme e minibashkisë në zonën e grumbullimit të mbetjeve (km ²)	Sipërfaqja e Përgjithshme e pambuluar e minibashkisë në Zonën e Shërbimit të Grumbullimit (km ²)	Zona e mbuluar në zonë bufer 200m nga kontejneri i mbetjeve (km ²)	Sipërfaqja e Përgjithshme e mbuluar në zonën bufer 200m nga kontejneri i mbetjeve (km ²)	Sipërfaqja e pambuluar e mbuluar në zonën bufer 200m nga kontejneri i mbetjeve (km ²)	Liqen & Parqe (km ²)
Lindore 1		Minibashkia-3	0,01			0,01			
		Minibashkia-4	2,95			2,00			
		Minibashkia-8	1,45			1,28			
	5,41	Minibashkia-9	0,62	5,03	0,38	0,61	3,90	1,51	
Lindore 2		Minibashkia-1	0,23			0,17			
		Minibashkia-2	0,76			0,76			
		Minibashkia-3	1,98			1,53			
		Minibashkia-4	0,61			0,60			
		Minibashkia-8	0,45			0,45			
	4,04	Minibashkia-9	0,00	4,03	0,01	0,00	3,51	0,53	
Lindore 3		Minibashkia-1	2,90			1,62			
		Minibashkia-2	8,35			4,09			1,92
		Minibashkia-3	0,02			0,01			
	11,74	Minibashkia-5	0,02	11,28	0,46	0,02	5,73	6,01	
Perëndimore 1		Minibashkia-7	0,06			0,06			
		Minibashkia-9	2,10			1,82			
		Minibashkia-10	0,09			0,09			
	7,04	Minibashkia-11	4,64	6,90	0,14	3,28	5,25	1,79	
Perëndimore 2		Minibashkia-2	0,02			0,02			
		Minibashkia-5	0,09			0,09			
		Minibashkia-6	0,52			0,40			
		Minibashkia-7	2,99			2,71			
		Minibashkia-9	0,01			0,01			
	4,33	Minibashkia-10	0,68	4,30	0,03	0,68	3,91	0,43	
Perëndimore 3		Minibashkia-2	0,13			0,11			0,02
		Minibashkia-5	2,65			2,31			
		Minibashkia-6	3,95			2,75			
	6,87	Minibashkia-7	0,00	6,73	0,14	0,00	5,17	1,70	
Gjithsej	39,43		38,26	38,26	1,17	27,47	27,47	11,96	

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Tabela 5.7.9 Përmbledhja e Zonave të Pambuluara me Grumbullim për Minibashkitë

Minibashkitë	Sipërfaqja e minibashkive (km ²)	Zona e Grumbullimit	Sipërfaqja e grumbullimit në zonën e Minibashkive (km ²)	Sipërfaqja e pambuluar me shërbim grumbullimi në zonën e minibashkive (km ²)	Sipërfaqja e mbuluar në zonën bufer 200m nga kontejneri i mbetjeve (km ²)	Sipërfaqja e pambuluar në zonën bufer 200m nga kontejneri i mbetjeve(km ²)	Liqen & Parqe (km ²)
Minibashkia – 1	4,00	Lindore 2,3	3,12	0,87	1,79	2,20	
Minibashkia –2	9,56	Lindore 1,2,3, Perëndimore 2,3	9,25	0,31	4,97	4,59	1,94
Minibashkia –3	2,01	Lindore 1,2,3	2,00	0,01	1,54	0,46	
Minibashkia – 4	3,64	Lindore 1,2	3,56	0,08	2,60	1,04	
Minibashkia –5	3,64	Lindore 3, Perëndimore 2,3	2,76	0,88	2,4,3	1,22	
Minibashkia – 6	6,90	Perëndimore 2,3	4,47	2,43	3,16	3,74	
Minibashkia – 7	3,05	Perëndimore 1, 2,3	3,05	0,01	2,77	0,28	
Mesatarja	50,3	62,5	72,2

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Tabela 5.9.5 Norma e Tre Përbërësve dhe Vlera e Ulët Kalorifike (2011)

Përmbajtja e Lagështirës	62,5%
Mbetjet e Djegshme	34,2%
Mbetjet Joorganike & Hiri	3,3%
Vlera Kalorifike (Kcal/kg)	1 166
Vlera Kalorifike (KJoule/kg)	4 882

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

(3) Praktika të Mira të Projekteve të Kompostimit në Botë

Paragrafët në vijim paraqesin praktikat e mira të aktiviteteve për kompostim në shtëpi, në komunitet dhe kompostimit qendror pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Studimit Përgatitor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Urbane në Nairobi në Republikën e Kenias, tetor 2010, JICA. Këta shembuj janë metoda të frytshme për kompostimin në BT dhe do të studiohen më tej për mundësinë e zbatimit në BT në përputhje me kushtet vendore.

1) Kompostimi në Shtëpi në Indonezi

Në Surabaya, Indonezi, kompostimi në shtëpi është kryer nga kontejnerë të llojit me frymëmarrje, si: shporta plastike të veshura me gjeotekstil, për të ruajtur mbetjet para depozitimit nga kuzhina etj., së bashku me materialet mbjellëse të kompostimit. Një nga materialet mbjellëse të quajtur "set kompostimi" bërë nga tretësirë bakteriale lakto-bazë përbërë nga fasule soje të thartuara, kos, maja, etj., të cilat janë të nevojshme për fermentim, dekompozim të mbetjeve organike në kompost pa u kalbur dhe duke pakësuar erën e rëndë të prodhuar në kushtet anaerobe. Pas disa muajsh, mbetjet e futura shkarkohen nga kontejneri dhe groposen në tokë ose grumbullohen për maturimin përfundimtar. Mbetjet organike të maturuara, komposti, përdoret nga banorët për kopshtet e tyre, ose parqet në rajon.

OJQ-ja, PUSDAKOTA, e themeluar nga Universiteti Surabaya është duke planifikuar të mbledhur kompostin e shtëpive në këmbim të parave. Kjo OJQ, gjithashtu, planifikon të udhëzojë njerëzit, në varësi të cilësisë së kompostit, si të fusë mbetjet organike, të mirëmbajë kontejnerin e kompostit etj., me qëllim përmirësimin e cilësisë së kompostit. Çmimi i kompostit të sjellë nga banorët varet nga cilësia e tij dhe ky sistem çmimi u jep nxitje njerëzve për të prodhuar në shtëpi kompost të cilësisë së mirë. Kjo metodë do të studiohet për mundësinë e futjes së tij në zonën, sidomos në shtëpitë e grupit me të ardhura të larta, me kopshte dhe oborre të mjaftueshme për kompostimin në shtëpi.

2) Kompostimi në Komunitet në Indonezi

PUSDAKOTA, si homologe e Shoqatës Kitakyushu International Techno-Cooperative në Japoni (KITA), ka zbatuar kompostimin në nivel komuniteti, që nga viti 2006 së bashku me aktivitetet e sistemit të bankës së mbetjeve. Kompostimi në nivel komuniteti, i quajtur "Metoda Susun" gjithashtu, përdor kontejnerë plastikë të llojit me frymëmarrje. Mbetjet e papërpunuara organike së bashku me mikrogjallesat janë vënë në shportën plastike të veshur me gjeotekstil dhe pastaj bëhet grumbull deri në lartësi dhe gjerësi të përshtatshme për trajtim të lehtë, manual të kontejnerëve. Komposti i parafermentuar merret më pas nga shporta plastike, copëtohet dhe grumbullohet deri në grumbull 1-1,5m kompost për fermentim. Rregullimi i grumbullit të kompostit, matja e temperaturës dhe rregullimi i lagështisë kryhet çdo dy ditë në varësi të kushteve. Kontrolli i proceseve të kompostimit nga përpjekjet e punonjësve në komunitet, jep një cilësi më të mirë të kompostit të prodhuar si dhe sistemit, që është krijuar për kthimin e fitimit, që rrjedh nga mbetjet e riciklueshme.

3) Kompostimi Qendror në Bangladesh

"Waste Concerns", OJQ-ja e regjistruar, ndërtoi një fabrikë kompostimi në shkallë të mesme, me kapacitet prej 130 tonë në ditë dhe pas miratimit, filloi funksionimi për të prodhuar kompost nga mbetjet e biodegradueshme të mbledhura nga tregjet në fillim të vitit 2009. Ky impiant është miratuar nga Qeveria e Bangladeshit dhe nga Bordi Ekzekutiv i

CDM-së OKB-së për Projektin e CDM-së. Shembulli është një rast i mirë për të zhvilluar projektin qendror të kompostit nëpërmjet lidhjes me aktivitetet e sektorit privat, pavarësisht nga dobësia financiare e pushtetit vendor. Kompostimi nga metoda qendrore mund të nisë së pari, me kompostimin e mbetjeve organike nga tregjet publike dhe hapi i dytë mund të përdorë mbetjet e kuzhinës ose mbetjet ushqimore nga familjet, restorantet dhe hotelet, përmes ngritjes së sistemeve të ndarjes dhe grumbullimit të ndarë të mbetjeve.

(4) Statusi i Funksionimit të Impianteve të Mbetjeve në Energji në Japoni

Tabela 5.9.6 tregon numrin 1 126 të impianteve të djegies, që funksionojnë në Japoni në vitin fiskal 2009. Karakteristika të veçanta të Impianteve të djegies që veprojnë në Japoni janë përmbledhur si më poshtë:

- 299 impiante me prodhim energjie janë në veprim me kapacitet të lartë të impiantit në 1 800 tonë/ditë dhe kapaciteti mesatar të impiantit në 366 tonë/ditë
- 827 impiante pa prodhim të energjisë janë në veprim me kapacitet të lartë në 900 tonë/ditë dhe kapaciteti mesatar të impiantit në 85 tonë/ditë
- Efikasiteti më i lartë i prodhimit të energjisë është 44% dhe efikasiteti mesatar ishte 11%
- Në mesin e 299 impianteve të djegies me gjeneratorë të energjisë, energjia elektrike më e madhe e prodhuar është 0,98MWh dhe mesatarja ishte 0.28MWh për ton-mbete,
- Kapaciteti mesatar i gjeneratorit të instaluar është 15kW për ton kapacitet djegieje
- Energjia elektrike mesatare e prodhuar është 63MWh për ton kapacitet djegieje

Tabela 5.9.7 tregon vlerën mesatare të tre zërave, përmbajtja e ujit, të djegshmet dhe inertet/hiri dhe vlerën kalorifike të mbetjeve për 1 075 impiantet e djegies me/pa prodhim energjie. Përmbajtja mesatare e lagështisë, të djegshmet dhe inertet/hiri i impiantit të djegies me prodhim energjie është respektivisht 46%, 45% dhe 9% dhe vlerat mesatare për impiantet pa prodhim energjie janë pak më lartë në përmbajtjen e lagështisë, më pak në të djegshme dhe të larta në inerte/hi, vlera, të cilat reflektojnë qartë tiparin dallues të impianteve me dhe pa prodhim energjie. Lidhur me vlerën mesatare kalorifike, të llogaritur nga të tre zërat, tregon më shumë se 8 200 kJ/kg-mbete për impiantet e djegies me prodhim energjie, edhe pse impiantet e djegies pa prodhim energjie tregojnë përafërsisht një vlerë prej 7 200 kJ/kg-mbete.

Tabela 5.9.6 Gjendja e Impianteve të Incenerimit që Operojnë në Japoni Viti Fiskal 2009

Emërtimi	Njësia	Impiant i Mbetjeve në Energji (Incenerator me Prodhim Energjie)	Incenerator pa Prodhim Energjie
Nr. i Impianteve	(impiant)	299	827
Kapaciteti i Impiantit të Djegies - Gjithsej	(t/ditë)	109,513	70,477
Kapaciteti i Impiantit të Djegies - Max	(t/ditë)	1,800	900
Kapaciteti i Impiantit të Djegies - Mean	(t/ditë)	366	85
Kapaciteti i Impiantit të Djegies - Min	(t/ditë)	25	0.25
Sasia e Mbetjeve të Trajtura (Të Djegura)	(t/vit)	22,719,093	12,804,091
Kapaciteti i Gjeneratorit - Gjithsej	(kW)	1,625,268	
Kapaciteti i Gjeneratorit - Max	(kW)	50,000	
Kapaciteti i Gjeneratorit - Mean	(kW)	5,436	
Kapaciteti i Gjeneratorit - Min	(kW)	100	
Energjia Elektrike e Prodhuar - Gjithsej	(MWh)	6,909,286	
Energjia Elektrike e Prodhuar - Max	(MWh)	139,004	
Energjia Elektrike e Prodhuar - Mean	(MWh)	23,264	
Energjia Elektrike e Prodhuar - Min	(MWh)	62	
Efienca e Energjisë së Prodhuar - Max	(%)	44	
Efienca e Energjisë së Prodhuar - Mean	(%)	11	
Efienca e Energjisë së Prodhuar - Min	(%)	2	
Energjia e Prodhuar për Sasi Mbetjesh të Trajtuar - Max	(MWh/ton)	0.98	
Energjia e Prodhuar për Sasi Mbetjesh të Trajtuar - Mean	(MWh/ton)	0.28	
Energjia e Prodhuar për Sasi Mbetjesh të Trajtuar - Min	(MWh/ton)	0.02	
Kapaciteti Mesatar i Gjeneruesit për Kapacitet Inceneratori	(kW/ton)	15	
Prodhimi Mesatar i Energjisë për Kapacitet Inceneratori	(MWh/vit/ton)	63	

Burimi: www.env.go.jp/recycle/waste_tech/ippan/h19/index.html, analizuar nga Ekipi Studimor i JICA-s

Tabela 5.9.7 Vlera Kalorifike e Mbetjeve Bashkiake në Impiantet e Djegies në Japoni Viti Fiskal 2009

Emërtimi	Incenerator me Prodhim Energjie			Incenerator pa Prodhim Energjie		
Nr. i mostrave	296			779		
Tre Përbërës	Përmbajta e Lagështirës (%)	Të djegshme (%)	Inerte&Hi (%)	Përmbajta e Lagështirës (%)	Të djegshme (%)	Inerte&Hi (%)
Vlera Mesatare	45.5	45.1	9.3	48.9	41.3	9.8
Vlera e Ulët Kalorifike	Llogaritur	Aktualisht e Matur	-	Llogaritur	Aktualisht e Matur	-
Vlera Mesatare	8,164	9,107	-	7,204	7,999	-

Burimi: www.env.go.jp/recycle/waste_tech/ippan/h19/index.html, analizuar nga Ekipi Studimor i JICA-s

(5) Kërkesa e Mundshme për Kompost

Komposti është zbatuar për efektet ajruese/kondicionuese të tokës nga rritja e humusit në tokë. Efektet e humusit janë mjaft të njohura në përmirësimin e karakteristikave të tokës, pasi e bëjnë më të lehtë për ta punuar, rrisin kapacitetin mbajtës të lagështisë, ulin sasinë e përdorur të fertilizantëve kimikë, rrisin aktivitetet e shëndetshme biologjike në tokë etj. dhe rrisin prodhimtarinë e të mbjellave si një rezultat i kombinuar i kryerjes së kompostit. Luhatjet e kërkesës për kompost dhe magazinim, sistemi i tregut, sjelljet e fermerëve për përdorim të kompostit etj., janë elementët kyç për të marrë parasysh udhëzimin e impiantit të kompostimit. Gjithsesi, faktori më kryesor është zona e kultivimit për të vlerësuar kërkesën e mundshme për

kompost. Për këtë faktor, të dhënat statistikore të zonës bujqësore në 2009 dhe kërkesat e pritshme për kompost janë paraqitur në Tabelën 5.9.8. Nga zona bujqësore në tabelë dhe supozimi për normën e përdorimit të kompostit në 20ton për hektar në vit, mesatarisht kërkesa e mundshme e fertilizantit organik gjithsej në zonën bujqësore të Prefekturës Tiranë është vlerësuar afërsisht në 1,1 milion ton/vit ose i barasvlershëm me 3 100 tonë/ditë, në aspektin e sasive të produkteve përfundimtare të kompostit. Për më tepër, kërkesa e kompostimit për vendin arrin në 14 milionë tonë/vit ose 38 000 tonë/ditë. Kërkesa e vlerësuar për kompost nuk përfshin konsumin në parqe, fidanishte dhe rrypëllëzim, kështu që kërkesa e mundshme për kompost do të jetë mjaft e madhe për prodhimin e kompostit në cilësi të mirë nga mbetjet e biodegradueshme. Gjithsesi, kërkohet bashkëpunimi i sektori bujqësor për ngritjen e tregut dhe shpërndarjes së kompostit, si dhe ndërgjegjësimin e fermerëve për përfundimet e përdorimit të kompostit në kultivim.

Tabela 5.9.8 Zona Bujqësore dhe Kërkesa e Vlerësuar për Kompost në Shqipëri

Qarku/Prefektura	Sasia e Tokës (ha)	Tokë Bujqësore (ha)	Pyje, Kullota & Tokë Tjetër (ha)	Norma e Supozuar e Kompostit të Aplikuar (t/ha)	Kërkesa e Mundshme për Kompost (t/vit)
Berat	179 793	52 995	126 798	20	1 059 900
Dibër	248 503	41 059	207 444	20	821 180
Durrës	76 442	40 593	35 849	20	811 860
Elbasan	329 994	72 875	257 119	20	1 457 500
Fier	189 069	121 910	67 159	20	2 438 200
Gjirokastrë	288 426	45 110	243 316	20	902 200
Korçë	371 032	90 920	280 112	20	1 818 400
Kukës	237 348	25 292	212 056	20	505 840
Lezhë	161 910	34 783	127 127	20	695 660
Shkodër	356 199	50 640	305 559	20	1 012 800
Tiranë	165 463	56 609	108 854	20	1 132 180
Vlorë	270 621	62 984	207 637	20	1 259 680
Gjithsej Shqipëria	2 874 800	695 770	2 179 270	-	13 915 400

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit të Tokës dhe Ujërave, MMPAU, Vlerësim i analizuar nga Eksperti Studimor i JICA-s

(6) Opsionet e Trajtimit të Ndërmjetëm


Ka një pafundësi variantesh për trajtimin e ndërmjetëm të mbetjeve bashkiake. Midis shumë prej tyre, metodat e trajtimit të ndërmjetëm për Planin e MIMN të Bashkisë së Tiranës janë përzgjedhur variantet, që marrin parasysh karakteristikat e mbetjeve bashkiake dhe strategjitë për t'u përputhur me objektivat e riciklimit në Shqipëri. Variantet e përzgjedhura janë: i) incinerator, ii) kthimi i mbetjeve në energji, iii) bio-gazifikimi me prodhim energji, dhe iv) kompostimi, të cilët janë paraqitur në Tabelën 2.7.9 për krahasim. Faktori kyç më i rëndësishëm për zgjedhjen është treguesi i kostos për të trajtuar mbetjet në mënyrë të frytshme, duke përkthyer me karakteristikat e mbetjeve. Gjithsesi, kushtet e dhëna të karakteristikave të mbetjeve të përziera, do të ndryshojnë përmes aktiviteteve të rikuperimit të materialeve të riciklueshme dhe grumbullimit të ndarë, të cilat janë propozuar tani e tutje për pjesën më të madhe të aktiviteteve të MIMN. Prandaj, duhet të studiohen katër variantet, duke kërkuar variantin më të mirë për të gjitha mbetjet, ose më mirë, do të merret parasysh zgjedhja e variantit, që shkon më mirë me mbetjet e ndara. Mbjetet e njoma ose mbjetet e ushqimit nuk janë të përshtatshme për djegien, por kjo lloj mbetjeje është një material i mirë për kompostim dhe/ose biogazifikim. Frytshmëria

e djegies së mbetjeve është e mirë duke ulur normën e përzierjes së mbetjeve të njoma me mbetjet e djegshme. Gjithashtu, mund të ulët edhe kapaciteti i impiantit. Përsa u përket mbetjeve të biodegradueshme, mbetjet e njoma nga ushqimi duhet të përzihen me materiale të thata për procesin e kompostimit, por procesi i biogazifikimit nuk kërkon përzierjen e materialit të thatë për procesin e metanizimit. Zbatimi i këtyre tri varianteve së bashku, shton/plotëson pikat e dobëta të proceseve përkatëse të trajtimit. Zgjedhja e një varianti të vetëm nuk është proces i përgjithshëm i frytshëm trajtimi, për t'u përballur me llojet e ndryshme të karakteristikave të mbetjeve. Një zgjidhje e përgjithshme e sistemit është e nevojshme. Përkatësisht, tri variantet, Opsioni TN2 (mbetje në energji), Opsioni TN3 (bio-gazifikim me prodhim energjie) dhe Opsioni TN4 (kompostimi) janë të rekomandueshme për impiantet e trajtimit të ndërmjetëm për BT. Variantet e propozuara të trajtimit të ndërmjetëm janë ilustruar me aktivitetet e tjera duke përbërë sistemin e përgjithshëm të MMN, siç tregohet në Figurën 5.9.2. Opsionet e secili proces trajtimi duhet të studiohen më tej, gjatë zbatimit të projektit.

Tabela 5.9.9 Opsionet e Trajtimit të Ndërmjetëm

Njësitë e Vlerësimit	Opsioni-TN1: Djedia	Opsioni-TN2: Kthimi i Mbetjeve në Energji	Opsioni-TN3: Biogazifikim me Prodhim Energjie	Opsioni-TN4: Kompostimi
Mbetjet Objektive	Mbetje të Djegshme	Mbetje të Djegshme	Mbetje të Biodegradueshme	Mbetje të Biodegradueshme
Besueshmëria Teknike	E besueshme	E besueshme por Komplekse Në Operim	Tretja Biologjike bëhet e Ulët në Dimër.	Tretja biologjike bëhet e ulët në dimër
Kostoja e Investimit	Më pak e Kushtueshme	E Kushtueshme	Më pak e Kushtueshme	E lirë nëse sistemi është më pak i mekanizuar
Kostoja e F&M	Më pak e Kushtueshme	E Kushtueshme	E Lirë	E lirë nëse sistemi është më pak i mekanizuar
Nënproduktet/Rikuperimi	Nxehtësi	Energji Elektrike	Karburant dhe/ose Energji Elektrike	Kompost
Aspektet Mjedisore	Ka nevojë për largim ndotësish nga gazrat e djegies	Ka nevojë për largim ndotësish nga gazrat e djegies	Nevojë për trajtim ujërash të zeza dhe prodhimi i erërave të këqija	Prodhimi i erërave të këqija
Zbatueshmëria	Impiante në shkallë nga e Vogël në të Madhe	Impianti i në shkallë të Mesëm në të Madh	Impianti i në shkallë të Vogël në të Mesme	Impianti në shkallë nga e Vogël në të Mesme
Përfitimet	Furnizimi me Ujë të Ngrohtë	Energji Elektrike për konsum në impiant dhe/ose shitje	Energji Elektrike për konsum në impiant dhe/ose shitje	Shitje e Kompostit
Rekomandime	E ardhme, pritje për rritje të vlerës kalorifike të mbetjeve	E ardhme, pritje për rritje të vlerës kalorifike të mbetjeve dhe partneri në zhvillim/investim	E ardhme, pritje për informacione F&M të impianteve në shkallë të madhe.	Zbatimi i kompostimit në shtëpi dhe në shkallë komunitare. Zbatimi i impiantit të projektit pilot për të studiuar zhvillimin e ardhëm të impiantit qendror të kompostimit në shkallë praktike.

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 5.9.2 Variantet e Propozuara të Trajtimit të Ndërmjetëm për 2027

5.9.2. Skica e Planit të Trajtimit të Ndërmjetëm

Masterplani i planit të grumbullimit dhe transportimit përbëhet nga planet, projektet dhe programet e pasqyruara në Tabelën 5.9.10.

Tabela 5.9.10 Skica e Planit të Trajtimit të Ndërmjetëm

Planet, Veprimet dhe Projektet			Përshkrimi i Punës
MMN-3 Plan i Trajtimit të Ndërmjetëm			Formulimi i planit të trajtimit të ndërmjetëm dhe zbatimi i planeve dhe projekteve për stabilizimin e organikëve / të djegshme, zvogëlimi i vëllimit të mbetjeve dhe rikuperimi i energjisë/burimeve para depozitimit përfundimtar.
	MMN-3-1	Plan i Trajtimit të Ndërmjetëm	Për të kryer studimin e fizibilitetit dhe për të formuluar planin e zbatimit për trajtim të ndërmjetëm të mbetjeve organikëve / të djegshme për të kthyer mbetjet në kompost, biogaz, dhe të prodhojë energji elektrike për të ruajtur koston e funksionimit të objekteve MMN dhe uljen e vëllimit të mbetjeve dhe stabilizimin e mbetjeve të fundme bazuar në propozimin e Studimit të JICA.
	MMN-3-1-1	Hartimi i Planit të Zbatimit për Trajtimin e Mbetjeve Organike	Për të kryer studimin e fizibilitetit dhe për të formuluar planin e zbatimit për mbetjet organike, për të kthyer mbetjet organike në biogaz dhe kompost duke përfshirë planet për shtëpitë, komunitetin, impiantin e kompostimit në shkallë pilot & qendrore, përveç vlerësimit të koston, analizës financiare & ekonomike, burimeve financiare, afatin kohor, monitorimin, etj.
	MMN-3-1-2	Hartimi i Planit të Zbatimit për Mbetjet-në-Energji	Për të kryer studimin e fizibilitetit dhe për të formuluar planin e zbatimit për mbetjet e djegshme për inceneratorin dhe prodhimin e energjisë në lidhje me planin e zbatimit të impiantit të kompostimit dhe Biogazifikimit, veç vlerësimit të koston, analizës financiare & ekonomike, burimeve financiare, afatin kohor, monitorimin, etj.
	MMN-3-2	Zbatimi i Planit të Trajtimit të Mbetjeve Organike	Ndërtimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e Impiantit të Kompostimit dhe/ose Biogazifikimit nga PPP ose nga BT bazuar në afatin kohor dhe përmbajtjen e përcaktuar në planin e zbatimit.
	MMN-3-2-1	Organizimi i Kompostimit në Shtëpi dhe Grupeve Komunitare të Kompostimit	Organizimi i grupeve të kompostimit për kompostimin në shtëpi dhe komunitet dhe udhëzimi i tyre për procedurat e kompostimit.
	MMN-3-2-2	Zbatimi i Projektit Pilot të Kompostimit në Shtëpi dhe Komunitet	Zbatimi i kompostimit në familje dhe komunitet në zonën(at) pilot të studimit.
	MMN-3-2-3	Zgjerimi/Shtirja e Praktikës së Kompostimit në Shtëpi dhe Komunitet	Zgjerimi i zonës së aktivitetit të kompostimit në familje dhe komunitet në gjithë zonën e BT-së.
	MMN-3-2-4	Përzgjedhja e Burimit të Madh të Prodhimit të Mbetjeve të Biodegradueshme	Zgjedhja e vendeve të prodhuesve të mbetjeve në shkallë të madhe, për të kërkuar bashkëpunimin për ndarjen dhe rikuperimin e mbetjeve organike/biodegradueshme si lëndë e parë për kompostimin dhe biogazifikimin.
	MMN-3-2-5	Ndërtimi i Impiantit të Kompostimit i Shkallës Pilot	Kryerja e projekteve inxhinierike, tenderi, kontraktimi i ndërtimit dhe ndërtimi i impiantit të kompostimit dhe/ose biogazifikimit në shkallë pilot të 1ton/ditë secili, nga BT.
	MMN-3-2-6	Operimi/Funksionimi dhe Mirëmbajtja e Impiantit të Kompostimit i Shkallës Pilot	Funksionimi, mirëmbajtja dhe studimi i proceseve të kompostimit dhe/ose biogazifikimit për zgjerimin në të ardhmen të proceseve të duhura për BT.
	MMN-3-2-7	Ndërtimi i Impiantit Qendror të Kompostimit/Biogazifikimit	Kryerja e projekteve inxhinierike, tenderi, kontraktimi i ndërtimit dhe ndërtimi i impiantit të kompostimit dhe/ose biogazifikimit në shkallë të madhe të 50ton/ditë secili (2 impiante), nga PPP ose nga BT bazuar në rezultatet e studimit pilot.
	MMN-3-2-8	Operimi/Funksionimi dhe Mirëmbajtja e Impiantit Qendror të Kompostimit / Biogazifikimit	Funksionimi, mirëmbajtja dhe studimi i proceseve të kompostimit dhe/ose biogazifikimit nga PPP ose BT.
	MMN-3-3	Vlerësimi i Performancës dhe Nivelit/Objektivave të Synuar në Planin e Trajtimit të Mbetjeve Organike	Rishikimi dhe/ose vlerësimi i performancës së impiantit për të vlerësuar arritjen për përmirësimin e impiantit dhe operimit në të.
	MMN-3-4	Zbatimi i Planit të Mbetjeve-në-Energji	Ndërtimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e impiantit të mbetjeve në energji nga PPP ose BT, bazuar në kuadrin kohor dhe përmbajtjen e dhënë në planin e zbatimit.
	MMN-3-4-1	Përzgjedhja e Vendit të Ndërtimit dhe Prokurimi	Kryerja e vrojtimeve/studimeve në terren për më shumë se dy vende alternativë dhe prokurimi i vendit të ndërtimit.
	MMN-3-4-2	Ndërtimi i Impiantit të Mbetjeve-në-Energji	Kryerja e projekteve inxhinierike, tenderi, kontraktimi dhe ndërtimi i impiantit të incenerimit dhe prodhimit të energjisë, nga PPP ose nga BT.
	MMN-3-4-3	Operimi/Funksionimi dhe Mirëmbajtja e Impiantit të Mbetjeve-në-Energji	Funksionimi dhe mirëmbajtja e impiantit të incenerimit dhe prodhimit të energjisë nga PPP ose BeT
	MMN-3-5	Vlerësimi i Performancës dhe Nivelit/Objektivave të Synuar në Planin e Mbetjeve-në-Energji	Rishikimi dhe/ose vlerësimi i performancës së impiantit të mbetjeve në energji për të marrë parasysh arritjet për përmirësimin e impiantit dhe funksionimit në të.

5.10. Plani i Depozitimit Përfundimtar dhe Zhvillimit të Impianteve

5.10.1. Kushtet Bazë për Planin e Depozitimit të Mbetjeve

(1) Sasia e Mbetjeve të Depozituara

Sasia përfundimtare e mbetjeve të depozituara ndryshon në varësi të shtrirjes së aktiviteteve të pakësimit të mbetjeve dhe planeve të trajtimit të ndërmjetëm. Sasitë e mbetjeve për depozitim përfundimtar me dhe pa këto plane janë vlerësuar në Tabelën 5.10.1 dhe pasqyruar në Tabelën 5.10.2. Sasia e mbetjeve të depozituara është llogaritur nga e gjithë sasia e mbetjeve duke zbritur sasinë e vlerësuar të pakësimit të mbetjeve dhe sasisë së rikuperuar për riciklim. Në rastin me projekt, inertet/hiri nga impiantet e mbetjeve në energji duhet t'i shtohet mbetjeve të biodegradueshme, të papërshtatshme, që duhet kundërshtuar nga proceset e kompostimit dhe biodegradimit. Rezultatet e llogaritjeve në tabelën tregojnë se sasia përfundimtare e mbetjeve të depozituara pa projekt luhaten nga 591 t/ditë në 2012 në 993 t/ditë në 2027. Ndërkohë, sasia përfundimtare për depozitim me projekte ul sasinë nga 591 t/ditë në 174 t/ditë nga efekti i pakësimit të mbetjeve dhe planeve të trajtimit të ndërmjetëm.

Tabela 5.10.1 Sasia e Planifikuar e Depozitimit të Mbetjeve

Sasia e Mbetjeve për Depozitim pa Projekt (t/ditë)				
Emërtimi	2012	2017	2022	2027
Mbetje Joorganike & Mbetje të Rrezikshme Familjare	18	22	27	31
Sasia e Mbetjeve të Ulura	0	0	0	0
Rikuperimi i Materialeve të Ricikluara nga Sektori Privat	92	112	133	155
Burimet e Mundshme të të Riciklueshmeve	573	698	830	962
Sasia e Mbetjeve për Depozitim	591	720	857	993
Sasia e Mbetjeve të Mundshme Gjithsej	683	832	990	1,148
Norma e Mbetjeve për Depozitim ndaj Sasisë Gjithsej të Mbetjeve (%)	87%	87%	87%	87%
Sasia e Mbetjeve për Depozitim me Projekt (t/ditë)				
Emërtimi	2012	2017	2022	2027
Mbetje Joorganike & Mbetje të Rrezikshme Familjare	18	22	27	31
Sasia e Mbetjeve të Ulura	0	42	99	115
Materiale të Riciklueshme & Mbetje për Energji	92	212	811	904
Mbetje të Riciklueshme të Mundshme, nga mbetjet e fundme	573	556	53	99
Mbetje nga Impianti i Kompostimit & Biogazifikimit	0	20	40	40
Hi nga Impianti i Mbetjeve për Energji	0	0	4	4
Shuma e Sasisë së Mbetjeve për Depozitim përfshirë Hirin & Mbetjet	592	599	124	174
Sasia Gjithsej e Mbetjeve	683	832	990	1,148
Norma e Depozitimit të Mbetjeve ndaj Sasisë Gjithsej të Mbetjeve (%)	87%	72%	13%	15%

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Tabela 5.10.2 Sasia e Planifikuar për Depozitim Sipas Viteve

Sasia e Mbetjeve për Depozitim pa Projekt																	(t/ditë)
Emërtim	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	
Mbetje In-organike & Mbetje të Rrezikshme Familjare	18	19	20	21	22	22	23	24	25	26	27	28	28	29	30	31	
Reduktimi i Mbetjeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Rekuperimi i Materialeve të Riciklueshme nga Sektori Privat	92	96	100	104	108	112	116	120	125	129	133	137	141	146	150	155	
Burime të Mundshme Riciklimi & Mbetje të Fundme	573	597	621	646	672	698	724	750	776	802	830	855	881	908	935	962	
Sasia e Mbetjeve për Depozitim	591	616	641	667	693	720	747	774	800	828	857	883	910	937	965	993	
Totali i Sasisë së Mundshme të Mbetjeve	683	712	741	771	801	832	863	894	925	957	990	1,020	1,051	1,083	1,115	1,148	
Norma e Mbetjeve për Depozitim ndaj Sasisë Totale të Mbetjeve	87%	87%	87%	87%	87%	87%	87%	87%	87%	87%	87%	87%	87%	87%	87%	87%	
Sasia e Mbetjeve për Depozitim me Projekt																(t/ditë)	
Item	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	
Mbetje In-organike & Mbetje të Rrezikshme Familjare	18	19	20	21	22	22	23	24	25	26	27	28	28	29	30	31	
Reduktimi i Mbetjeve	0	7	15	23	32	42	52	63	74	86	99	102	105	108	112	115	
Materiale të Riciklueshme & Mbetje për Energji	92	103	118	132	147	212	278	655	673	691	811	828	846	864	884	904	
Mbetje të Riciklueshme të Mundshme, nga mbetjet e fundme	573	582	588	595	601	556	510	152	153	154	53	63	72	81	90	99	
Refuzime nga Implanti i Kompostimit & Biogazifikimit	0	0	0	0.4	0.4	20.4	20.4	20.4	20.4	20.4	40.4	40.4	40.4	40.4	40.4	40.4	
Hi nga Implanti i Mbetjeve për Energji	0	0	0	0	0	0	0	0	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6	
Totali i Sasisë së Mbetjeve për Depozitim përfshirë Hirin&Refuzim	592	601	608	616	623	599	553	197	202	204	124	134	144	154	164	174	
Sasia Totale e Mbetjeve	683	712	743	771	801	832	863	894	925	957	990	1,020	1,051	1,083	1,115	1,148	
Norma e Depozitimit të Mbetjeve ndaj Sasisë Totale të Mbetjeve	87%	84%	82%	80%	78%	72%	64%	22%	22%	21%	13%	13%	14%	14%	15%	15%	


Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Sasia e mbetjeve për depozitim përfundimtar u kthye në vëllim mbetjesh dhe në vëllim vjetor të mbetjeve të grumbulluara, për të vlerësuar vëllimin e mbetjeve për landfill. Në kthimin e sasisë së mbetjeve në vëllim mbetjesh, dendësia e mbetjeve të ngjeshura është vlerësuar në 0,75 ton/m³. Veç kësaj, vëllimi i dheut mbulues është shtuar me 15% për të mbushur vëllimin e mbetjeve. Rezultatet e llogaritjes në periudhën 2012-2027 tregojnë vëllimin e përgjithshëm të landfillit, që arrin në 2,4 milionë m³ dhe 7,0 milionë m³ për rastet me dhe pa projekte. Venddepozitimi i sotëm i Sharrës parashikohet të mbushet plotësisht në 2015. Duke filluar nga 2015 është i nevojshëm një landfill i ri. Vëllimi i Landfillit pas venddepozitimit ekzistues të Sharrës është vlerësuar në 1,4 milion m³ dhe 5,7 milionë m³ për rastet me dhe pa projekt në periudhën 2016-2027. Ndryshimi i vëllimit të kërkuar për landfill midis varianteve me dhe pa projekte, është vlerësuar përafërsisht me katër herë. Kjo nënkupton se jetëgjatësia e landfillit me projekte do të rritet me katër herë.

Tabela 5.10.3 Vëllimi i Mbetjeve të Planifikuara për Akumulim në Venddepozitim Sipas Viteve

Emërtim	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Sasia Vjetore e Mbetjeve të Depozituara pa Projekt (t)	216	225	234	244	253	263	273	282	292	302	313	322	332	342	352	363
Sasia e Mbetjeve të Akumuluar në Depozitim, pa Projekt (t)	216	441	675	918	1,171	1,434	1,707	1,989	2,281	2,584	2,896	3,218	3,550	3,892	4,245	4,607
Volumi i Mbetjeve të Akumuluar në Depozitim, pa Projekt (m ³)	288	588	900	1,224	1,562	1,912	2,276	2,652	3,042	3,445	3,862	4,291	4,734	5,190	5,660	6,143
Volumi i Akumuluar i Dheut Mbulues pa Projekt (m ³)	43	88	135	184	234	287	341	398	456	517	579	644	710	778	849	921
Volumi Total i Mbetjeve të Akumuluar në Depozitim, pa Projekt (m ³)	331	676	1,035	1,408	1,796	2,199	2,617	3,050	3,498	3,961	4,441	4,935	5,444	5,968	6,509	7,065
Volumi Total i Mbetjeve të Akumuluar në Depozitim, pa Projekt, pas Sharrës (m ³)					388	791	1,209	1,642	2,090	2,553	3,033	3,527	4,036	4,561	5,101	5,657
Sasia e Mbetjeve të Akumuluar në Depozitim, me Projekt (t)	216	220	222	225	227	219	202	72	74	74	45	49	53	56	60	63
Cumulative easte Disposal Amount ëth Project (t)	216	436	657	882	1,110	1,328	1,530	1,602	1,676	1,750	1,795	1,844	1,897	1,953	2,013	2,077
Volumi i Mbetjeve të Akumuluar në Depozitim, me Projekt (m ³)	216	436	657	882	1,110	1,328	1,530	1,602	1,676	1,750	1,795	1,844	1,897	1,953	2,013	2,077
Volumi i Akumuluar i Dheut Mbulues me Projekt (m ³)	32	65	99	132	166	199	230	240	251	263	269	277	285	293	302	311
Volumi Total i Mbetjeve të Akumuluar në Depozitim, me Projekt (m ³)	248	501	756	1,015	1,276	1,527	1,760	1,842	1,927	2,013	2,065	2,121	2,182	2,246	2,315	2,388
Volumi Total i Mbetjeve të Akumuluar në Depozitim, me Projekt, pas Sharrës (m ³)					261	513	745	828	912	998	1,050	1,106	1,167	1,232	1,301	1,373

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 5.10.1 Vëllimi i Mbetjeve të Planifikuara për Grumbullim në Venddepozitim Sipas Viteve

(2) Projektimi dhe Funksionimi i Landfillit

Në kontekstin e përgjithshëm të MMN, landfilli është pika e fundit e depozitimit. Edhe pse ka disa çështje që kanë të bëjnë me zgjedhjen e vendit, zgjedhja e llojit të landfillit nuk është problem, përse kohë për tipet e landfillit nën Ligjin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve ka përcaktime. Sipas Ligjit, tipet e landfilleve janë kategorizuar në tre (3) lloje: a) landfill për mbetjet e rrezikshme, b) landfill për mbetjet jo të rrezikshme, dhe c) landfill për mbetjet inerte. Sipas Ligjit, vetëm mbetjet që janë subjekt trajtimi mund të dërgohen në landfill dhe lloji i landfillit për mbetje jo të rrezikshme mund të përdoret vetëm për mbetje bashkiake. Ligji përshkruan mbetjet, që nuk mund të pranohen në landfill, si: mbetje të lëngshme, eksplozivë, kimikate, goma dhe bateri makinash, etj.

Në funksion të kërkesave të ligjit, llojet e mbetjeve, që hidhen dhe kërkesa për modernizimin e impianteve të depozitimit për Planin e MIMN të Bashkisë së Tiranës, impiantet e depozitimit duhet të zhvillohen me llojin e quajtur landfill sanitar me impiante shoqëruese për funksionimin dhe mirëmbajtjen e impianteve të depozitimit. Ka disa nivele të landfillit sanitar në aspektin e projektimit strukturor dhe metodat e funksionimit, lloji i landfillit sanitar pothuaj-aerobik i zhvilluar me më shumë se 30 vjet histori në Japoni do të jetë lloji i përshtatshëm miqësor me mjedisin për të përshpejtuar dekompozimin e materies organike në mbetje dhe për të zvogëluar prodhimin e gazit metan.

Mbledhja e mbetjeve ka funksionuar si një rol kyç në rikuperimin e burimeve në landfillin ekzistues. Ai mund të njihet si një pjesë përbërëse e sistemit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në vendet në zhvillim për të ofruar përfitime të rëndësishme ekonomike për mbledhësit e mbetjeve dhe përfitime mjedisore përmes rikuperimit të materialeve ricikluese. Megjithatë, mbledhja e mbetjeve do të ndalohet në landfillin e ri. Mbledhja e përditshme e materialeve të

riciklueshme u ofron mbledhësve të mbetjeve jetesë më të mirë kështu që, mbledhësit e mbetjeve mund të quhen si një forcë pune e mundshme për një rikuperim më të frytshëm të materialeve në programin e rikuperimit të burimeve, që do të zbatohet në kuadër të Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës. Prandaj për BT është e domosdoshme të zbatojë programe të veçanta për mbledhësit e mbetjeve, të cilat do i bëjnë ata partnerë të domosdoshëm në aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta, sidomos në realizimin e ndarjes së mbetjeve, rikuperimin e mbetjeve, kompostimin e mbetjeve të biodegradueshme, etj.

(3) Plani i Landfillit Rajonal


Studimi i Vendit për Venddepozitimin e Mbetjeve të Ngurta (Landfilli Sanitar) në Durrës, Shqipëri (IFC)

Në 2011, IFC ka financuar studimin e vendit për Venddepozitimin e Mbetjeve të Ngurta (Landfill Sanitar) në Durrës, duke synuar vlerësimin dhe më tej, propozimin e vendit më të përshtatshëm për një landfill sanitar të ri, për rajonin e Durrësit. Procesi i vlerësimit filloi me 18 vende dhe pas një sërë zbatimesh të kriterëve teknike, gjeologjike, socio-politike dhe të tjera, numri i vendeve u pakësua në vende kandidate. Të tri “vendet kandidate” kanë mundësi të arsyeshme për landfillin e ardhëm, me përparësitë dhe të metat përkatëse. Tabela 5.10.4 jep informacionin kryesor për secilin vend kandidat.

Tabela 5.10.4 Informacioni Kryesor i Vendeve Kandidatë të Venddepozitimeve të Mbetjeve

Emërtim	Vendi 16	Vendi 9+10	Vendi 4
Vendndodhja	Sukthi-Rada	Sukthi-Shijak	Vrinasi
Largësia nga BeD	10,8 km Veri-Lindje	8,1 km Lindje	4,5 km n Veri-Lindje
Sipërfaqja e Vedit	11,9 ha	6,5 ha + 6,1 ha	67,5 ha
Lartësia	9 – 19 mbi nivelin e detit	32 – 37 mbi nivelin e detit	Niveli i detit/pak më poshtë
Grada e Pjerrësisë	Përafërsisht 2%	Përafërsisht 2%	Përafërsisht 2%
Gjendja e vendit	Mirë, mirësishtuar, pak i thyer në të sheshtë	Mirë, mirësishtuar, pak i thyer në të sheshtë	Mesatar, mirësishtuar, luginë e sheshtë
Pronësia	Pronarë privatë, sot toka përdoret për qëllime bujqësore	Pronarë privatë, sot toka përdoret për qëllime bujqësore	Pronarë privatë, sot toka përdoret për qëllime bujqësore dhe blegtorale
Vrojtime	Vendi është formuar në një luginë të gjerë, praktikisht me nivel të poshtëm, me rritje graduale në pjesën perëndimore dhe lindore, në shpatet e buta të kodrave. Vendi është i aksesueshëm nga rrugë tretësore (udhë fushe), ose përgjatë rrugës nëpër digën e rezervuarit të ujit Rubjekas.	Vendet janë formuar në një terren të sheshtë, rritet gradualisht në shpatin e një kodre të butë, në pjesën jugore. Janë të aksesueshme përgjatë rrugës nga Komuna e Maminasit si dhe nga Bashkia e Shijakut, që shtrihen afër rrugës.	Vendi shtrihet në Lindje të një zone industriale. Terreni është i sheshtë dhe akses i në të është përgjatë rrugës ekzistuese, asnjë rrugë nuk të drejton drejtpërdrejt në këtë vend.
Vlerësimi Paraprak	Vendi qaset nga dy drejtime përgjatë udhëve të këqija fushore. Është e nevojshme të ndërtohet një rrugë e aksesueshme disa km e gjatë. Topografia e vendit është e përshtatshme për ndërtimin e landfillit dhe ka një distancë të shkurtër nga burimi më i madh i mbetjeve, Qyteti i Durrësit. E metë kryesore është qasja e vështirë për mungesë të infrastrukturës rrugore. Përparësia është kapaciteti i mjaftueshëm për një landfill rajonal.	Janë në largësi të shkurtër nga burimi më i madh i mbetjeve, Qyteti i Durrësit. Një akses shumë i mirë përgjatë rrugës së re, nga të dyja anët. Topografia e të dyja vendeve është e përshtatshme për ndërtimin e landfillit dhe është një sasi e mjaftueshme materiali të përshtatshëm për shtresat strukturore të landfillit. E meta kryesore është afërsia me ndërtesat e banimit. Vendi Nr. 9 është në kufirin e kapacitetit për landfill rajonal, por i mjaftueshëm nëse kombinohet me Vending Nr.10.	Është i nevojshëm ndërtimi i landfillit si përgjatë sipërfaqen e tokës. Përsa kohë vendi është kryesisht në nivelin e detit, duhet ngritur në nivel për të evituar rastet e përmbytjes. Grumbullim dhe drenazhim i vështirë i shllamit dhe të precipitimeve sipërfaqësore të ujit. E meta më e madhe janë zonat e përhershme me ujë dhe mungesa e materialeve për instalimin e elementëve strukturor në vend dhe në afërsi të tij. Përsa i përket hapësirës, vendi është i mjaftueshëm për landfill rajonal.

Burimi: Studimi i Vedit për Venddepozitimin e Mbetjeve të Ngurta (Landfilli Sanitar) në Durrës, Shqipëri, 18.05.2011, A.S.A. international Environmental Services GmbH and GEOTest, a.s, IFC



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 5.10.2 Vendndodhja e Vendeve Kandidate për Venddepozitimin Rajonal të Mbetjeve

(4) Zgjedhja e Vendit të Ndërtimit për Planin e MIMN të Bashkisë së Tiranës

Ekipi Studimor i JICA-s dhe Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve, BT kryen përzgjedhjen paraprake të vendit të landfillit të ri nëpërmjet hartës së pamjes satelitore. Nuk ka asnjë vend të përshtatshëm brenda zonës së juridiksionit të BT-së dhe katër vendet kandidate janë zgjedhur nga zonat fqinje të BT-së, siç tregohet në Figurën 5.10.3.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 5.10.3 Vendndodhja e Vendeve Kandidate të Venddepozitimit të Mbetjeve

Zbulimi fushor u krye për katër vende kandidate dhe rezultatet e vrojtimit janë përmbledhur në Tabelën 5.10.5. Tri vendet: Mullet, Lalm dhe zgjerimi i Sharrës janë prona private, ndërkohë, vendi tjetër afër urës së Brarit, është tokë publike. Sipërfaqet e zonave Brar dhe Mullet janë

shumë të vogla për zhvillimin e impianteve të mundshme të MMN duke përfshirë dhe impiantet e depozitimit të mbetjeve. Ndërkohë, vendi i Zgjerimit të Sharrës dhe Lalm janë mjaftueshëm të mëdha për të ndërtuar gjithë impiantet e MMN. Lalm është pronë private dhe ka nevojë për ndërtimin e rreth 1 000 m rrugë të aksesueshme për të arritur venddepozitimin. Vendi i Zgjerimit të Sharrës ka disa përparësi ndaj tri vendeve të tjera, në lidhje me largësinë e transportimit të mbetjeve nga zonat e grumbullimit, zona ngjitur e landfillit ekzistues, aspektet mjedisore etj.

Tabela 5.10.5 Informacioni Kryesor i Vendeve Kandidate të Venddepozitimeve të Mbetjeve

Emërtimi	Brar	Mullet	Sharra Expansion	Lalm
Vendndodhja	Komuna Dajt	Komuna Mullet	Komuna Vaqarr	Komuna Vaqarr
Largësia nga BT	8km	8,5km	6km	9km
Sipërfaqja e Vendit	4.5 ha	15ha	33ha	40ha
Lartësia	+190m ~ +290m	+160m ~ +230m	+115m ~ +155m	+100m ~ +270m
Grada e Pjerrësisë	33%	14%	6%	19%
Gjendja e vendit	Mure Lugine	Shpat kodre	Mure Lugine & Shpat kodre	Mure Lugine & Shpat kodre
Pronësia	Komuna	Private	Private	Private
Vrojtime	Vendi është i vogël dhe i pjerrët. Ka nevojë për rrugë akses, duke kaluar lumin.	Ka nevojë për prokurim të tokës dhe ndërtimin e rreth 600m rrugë të aksesueshme.	Ekzistojnë mjaft shtëpi në zonën ngjitur. Ka nevojë për marrëveshje me Komunën Vaqarr.	Ka nevojë për ndërtimin e rreth 850m rrugë të aksesueshme përgjatë brigjeve të Lumit Erzen.
Vlerësimi Paraprak	Vendi është shumë i pjerrët për të ndërtuar rrugën që të çon në landfill dhe ka rrezik rrëshqitje të shtresave të landfillit, shkaktuar nga puna e papërshtatshme në landfill. Zona është shumë e vogël për vëllimin e mbetjeve për BeT-në.	Toka private zotërohet nga shumë pronarë dhe kërkon kohë për prokurim. Vendi nuk është mjaftueshëm i madh për zhvillimin e impianteve gjithëpërfshirëse të MMN.	Vendi ndodhet pranë zonës së venddepozitimit ekzistues të mbetjeve, Sharrë dhe nuk është i përshtatshëm për qëllime të tjera, përveç mbetjeve. Vendi mjaftueshëm i madh për zhvillimin e impianteve të ndërmjetme dhe për landfill.	Toka private zotërohet nga një pronar duke lehtësuar marrëveshjen. Vendi është mjaftueshëm i madh për zhvillimin e impianteve të ndërmjetme dhe për landfill. Rruga përgjatë brigjeve të lumit ka rrezik përmblyje ose gërryerje.

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Vendi i zgjerimit të Sharrës është i madh dhe ndoshta i mjaftueshëm për të caktuar vendin për impiantet e rikuperimit të materialeve, impiantin e kompostimit, impiantin e biogazifikimit, impiantin e mbetjeve për energji, përveç zgjerimit të vendit të landfillit. Harta e paraqitur në Figurën 5.10.4 synon të tregojë vendin e caktuar për ndërtimin e impianteve gjithëpërfshirëse të LMN në vendin e Zgjerimit të Sharrës.

Vendndodhja e Vendit të Zgjerimit të Sharrës për Zhvillimin e Impianteve Gjithëpërfshirëse të LMN.


Vendi i Zgjerimit të Landfillit Faza-1	: 10,6 ha (2015-2026)
Vendi i Zgjerimit të Landfillit Faza -2	: 11,4 ha (pas 2026)
Impiantet e Rikuperimit të Materialeve	: 2,1 ha
Impiantet e Kompostimit, Biogazifikimit dhe Mbetje për Energji	: 3,4ha
Vendi Alternativ për Impiantin e Mbetjeve për Energji	: 6,3 ha

5.11. Plani i Zhvillimit të Kapacitetit Institucional

5.11.1. Kushtet Bazë për Planin e Zhvillimit të Kapacitetit Institucional

(1) Ngritja e Strukturës Organizative të Zbatimit Efektiv

Qëllimi i zhvillimit të kapaciteteve është të krijojë marrëveshje më të përshtatshme institucionale dhe organizative për të mundësuar administratën e BT-së të zbatojë programet dhe projektet e përcaktuara në kuadër të Planit të MIMN. Subjekti kryesor për ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimit institucional duhet të fillojë me organizimin e agjencisë zbatuese për të ndërmarrë rolet dhe përgjegjësitë kryesore për përgatitjen dhe zbatimin e planeve të veprimit të propozuara në përputhje me qëllimin dhe afatin kohor. Organizimi i MMN të BT sot përbëhet nga sektorët për shërbimet e grumbullimit të mbetjeve dhe depozitimin e mbetjeve, por MIMN kërkon funksione shtesë në Drejtorinë e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta për aktivitetet e pakësimit të mbetjeve, rikuperimin e mbetjeve të riciklueshme, trajtimin e ndërmjetëm, fuqizimin financiar, etj. për të kthyer sistemin e MMN në një sistem modern, të nivelit ndërkombëtar. Sektorët shtesë, si: Ekipi i Punës për Projektet dhe Sektori 3R dhe i Trajtimit të Ndërmjetëm, janë propozuar për t'u themeluar si tregohet në figurën 5.11.1.



Ekipi i Punës i projektit duhet të ndërmarrë rolin kryesor për të përgatitur planin e zbatimit të projekteve dhe programeve dhe për të nxitur zbatimin e Planit të MIMN. Gjithë koordinimi dhe bashkëpunimi me agjencitë e tjera dhe sektorët përkatës do të bëhet nga Ekipi i Punës së Projektit. Sektori 3R dhe i Trajtimit të Ndërmjetëm duhet të ndërmarrë planet e veprimit të

planit të trajtimit të ndërmjetëm për të nxitur fillimisht studimet e fizibilitetit, projektimin inxhinierik dhe mbikëqyrjen e ndërtimit, zbatimin e aktiviteteve 3R, etj. nëpërmjet dhënies së disa prej detyrave firmës/ave konsulente inxhinierike. Më vonë, Sektori mbikëqyr, monitoron dhe inspekton aktivitetet e funksionimit për vlerësimin e rregullt të aktiviteteve. Sektorët e tjerë ekzistues të grumbullimit të mbetjeve dhe depozitimit të mbetjeve duhet të ndërmarrin aktivitetet, që lidhen me fushat për të modifikuar/përmirësuar shërbimet në përputhje me planet e veprimit dhe programet e propozuara. Personeli i funksionimit dhe mirëmbajtjes mund të rekrutohet me dy alternativa. Alternativa e parë: Rekrutimi i punonjësve nga organizmi ekzistues, duke përfshirë punonjës nga drejtoritë e tjera të BT. Alternativa e dytë: Do të bëhet me anë të disa tipe kontratash. Kudo ku të gjenden burime për rekrutimin e punonjësve dhe punonjësit e caktuar duhet të trajnohen shpejt e në vijimësi për zbatimin e planeve dhe të ruaj normalisht sistemin për të realizuar pa probleme funksionet e synuara të Planit MIMN.

Trajnimi i veçantë dhe periodik do të bëhet për të gjithë personelin e përfshirë në aktivitetet e MMN me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të planeve dhe programeve në kuadër të Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës. Në vijim jepen kurset kryesore të trajnimit të nevojshme për zhvillimin e burimeve njerëzore të afta për të kryer shërbime më të mira të MMN:

- Standardet menaxhuese për shërbimet e MMN,
- Standardet teknike dhe kriteret për planifikimin dhe operimin e mirëmbajtjen,
- Performanca individuale për përmbushjen e detyrave.

Aftësitë zbatuese, organizative dhe të menaxhimit duhet të zhvillohen dhe të jenë sa më të suksesshme. Këto praktika funksionimi dhe menaxhimi do të përcaktohen në bazë të këtyre çështjeve:

- Një strukturë organizative e suksesshme, që ka struktura organizative racionale, linja të qarta raportimi, përfshirje të arsyeshme të kontrollit, strukturë të përshtatshme të lartë menaxhimi dhe numrin si dhe nivelin e duhur të drejtorëve, menaxherëve, inxhinierëve dhe inspektorëve,
- Një detyrë e qartë dhe mandatin e përgjegjësive dhe autoritetin e përshtatshëm të drejtuesve dhe inspektorëve për performancë individuale,
- Procedurat për të përcaktuar dhe monitoruar lehtë objektivat nga niveli strategjik deri në menaxhimin e mesëm dhe inspektorët,
- Planifikimi i saktë dhe formulimi i politikave për përgatitjen e planeve strategjike afatmesme/afatgjata, si dhe planeve operative ditore, javore, mujore dhe vjetore,
- Drejtimi i mirë financiar për integrimin e planifikimit financiar në procesin e planifikimit, zbatimin e planifikimit buxhetor, kontrollin dhe sistemet e duhura të kontabilitetit për shërbimet e MMN,
- Vendimi i drejtë i menaxherëve,
- Sistemet e menaxhimit të frytshëm dhe të përshtatshëm të informacionit si dhe procedurat e tjera p.sh., flukset e punës dhe modelet e komunikimit për informacionin e duhur dhe të rregullt për të mundësuar menaxherët që të marrin vendimet e duhura dhe të zbatojnë në mënyrë të rreptë përgjegjësitë e tyre,
- Vlerësimi periodik i performancës së personelit në bazë të objektivave dhe kriterëve të pranuar të performancës për të pasur një personel të mirëtrajnuar dhe të përkushtuar ndaj detyrave të tyre.

Një komitet këshillimor për MMN mund të organizohet kryesisht nga personeli menaxherial i BT dhe anëtarët e thirrur nga agjencitë e tjera të interesuara p.sh., sektorët e qeverisë, sektori

akademik, sektori i ndërmarrjeve, grupet e komunitetit dhe komitetin e MMN kryesuar nga BT. Komiteti shqyrton planet e propozuara të BT për të këshilluar, sugjeruar dhe dhënien e pëlqimit për Planet e veprimit, programet dhe projektet për zbatim. Komiteti i MMN do të thirret çdo tre muaj dhe sipas nevojës.

(2) Sistemi Ligjor Japonez për Themelimin e një Shoqërie të Shëndoshë të Orientuar drejt Riciklimit (SHSHOR)

Një prej aktiviteteve më të rëndësishme të MMN në ditët e sotme është aktiviteti 3R, që po kryhen me përfshirjen e grupeve të interesit në shoqëri, duke përfshirë: prodhuesit e mbetjeve, sipërmarrjet tregtare dhe të biznesit, shkollat, institucionet qeveritare etj. Që të marrë mbështetje nga shoqëria, ngritja e ndërgjegjësimit publik është një nga çështjet kryesore për zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të 3R të MMN për ndihmesën për krijimin e shoqërisë së shëndoshë drejt riciklimit të burimeve (ShShOR) në BT dhe Shqipëri. Për krijimin e ShShOR, një sistem gjithëpërfshirës ligjor është në thelb i nevojshëm për të formuluar rregullat, rregulloret, kriteret, standardet, udhëzimet, etj. për të rregulluar aktivitetet e përgjithshme 3R ose aktivitetet e ShShOR. Në Japoni, masat ligjore për afrimin drejt krijimi të Shoqërisë së Shëndoshë Orientuar drejt Riciklimit të materialeve (ShShOR) janë marrë më shumë se 10 vjet më parë nëpërmjet zbatimit të ligjeve përkatëse të treguara si vijon:

Ligji Themelor i Mjedisit (Akti Nr. 91 i 1993)

Qëllimi i këtij ligji është që në mënyrë sistematike të nxitë politikat për mbrojtjen e mjedisit për të siguruar jetesën e shëndetshme dhe të kulturuar për të dy brezat e sotëm dhe të ardhshëm të kombit, si dhe për të ndihmuar në mirëqenien e njerëzimit, përmes artikullimit të parimeve themelore, qartësimin e përgjegjësisë të qeverive shtetërore, vendore, korporatat dhe qytetarët, si dhe përshkrimin e konsideratave themelore të politikës për mbrojtjen e mjedisit.

Akti Themelor për Themelimin e Shoqërisë së Shëndoshë të Orientuar tek Riciklimi (Akti Nr.110 i 2000)

Qëllimi i këtij ligji është të nxitë sistematikisht politikat për krijimin e një shoqërie “Sound Material-Cycle Society” dhe në këtë mënyrë të ndihmojë për të siguruar jetesën e shëndetshme dhe të kulturuar për brezat e sotëm dhe të ardhshëm të kombit, përmes artikullimit të parimeve themelore për krijimin e “Sound Material-Cycle Society”, në përputhje me filozofinë bazë të Ligjit themelor të Mjedisit (Akti nr 91 të vitit 1993), qartësimin e përgjegjësisë të Shtetit, qeverive vendore, operatorëve të biznesit dhe qytetarët, si dhe çështjet themelore të artikuluar për të bërë politika dhe plan themelor për formimin dhe ngritjen e një shoqërie “Sound Material-Cycle Society”.

Menaxhimi i Mbetjeve dhe Ligji i Pastrimit Publik

Qëllimi i këtij ligji është ruajtja e mjedisit jetësor dhe përmirësimi i shëndetit publik përmes kufizimit të shkarkimit të mbetjeve, zgjidhjes së përshtatshme, ruajtjes, grumbullimit, transportimit, riciklimit, asgjësimit të mbetjeve dhe ruajtjen e mjedisit jetësor të pastër.

Ligji për Nxitjen e Përdorimit të Frytshëm të Burimeve

Qëllimi i këtij ligji është të ofrojë mekanizmin bazë të kërkuar për nxitjen e pakësimit të prodhimit të mallrave të përdorura dhe nënprodukteve, shfrytëzimin e burimeve të riciklueshme dhe pjesët e ripërdorshme dhe në këtë mënyrë të ndihmojë në nxitjen e zhvillimit të shëndoshë

të ekonomisë kombëtare.

Ligji i Riciklimit të Kontejnerëve dhe Paketimit

Qëllimi i këtij ligji është të nxitë pakësimin e kontejnerëve të mbetjeve dhe shkarkimin e mbetjeve të paketimit dhe grumbullimin e veçantë për riciklimin e kontejnerëve të mbetjeve dhe mbetjeve të paketimit, që janë në përputhje me standardet e ndarjes, për të siguruar menaxhimin e duhur të mbetjeve dhe përdorimin sa më të mirë të burimeve nëpërmjet pakësimit të mbetjeve të ngurta bashkiake dhe përdorimin e përshtatshëm të burimeve të riciklueshme, duke ndihmuar për ruajtjen e mjedisit jetësor dhe zhvillimit të ekonomisë kombëtare.

Ligji i Riciklimit të Pajisjeve Shtëpiake

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një sistem grumbullimi dhe riciklimi ku shitësi i pajisjes shtëpiake të marrë përgjegjësinë e grumbullimit të pajisjeve të përdorura në shtëpi me pagesë dhe prodhuesi i pajisjeve shtëpiake të marrë përgjegjësinë e riciklimit të pajisjeve të mbledhura.

Ligji i Riciklimit të Materialeve të Ndërtimit

Qëllimi i këtij ligji është të zvogëlojë depozitimin e mbetjeve të ndërtimit nëpërmjet rikuperimit nga kontraktorët. Ai nxit aktivitete të tilla, si: ndarja dhe riciklimi i mbetjeve të krijuara gjatë aktiviteteve të prishjeve dhe ndërtimit të ndërtesave të materialeve të caktuara, si: beton duke përfshirë pllakat parafabrike, asfalt/beton dhe materiale druri.

Ligji i Riciklimit të Mbetjeve të Ushqimit

Qëllimi i këtij ligji është të zvogëlojë sasinë e stokut të vdekur të depozituar dhe të mbetjeve të ushqimit të mbetur nga subjektet e biznesit, prodhuesit, përpunuesit dhe shitësit nëpërmjet riciklimit. Ai gjithashtu, përshpejton përpjekjet për riciklim nga bizneset e lidhura me ushqimin. Bizneseve të regjistruara të riciklimit i krijohen masa lehtësuese brenda kuadrit të Ligjit të Administrimit të Mbetjeve, Ligjit të Pastrimit Publik dhe Ligjit të Kontrollit të Fertilizantit.


Ligji i Riciklimit të Automjeteve në Fund të Jetës

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë se mbetjet nga mjetet në fund të jetës do të depozitohen në mënyrë të duhur dhe se burimet janë përdorur në mënyrë të frytshme nëpërmjet uljes së sasisë së mbetjeve nga automjetet në fund të jetës, duke përdorur dhe ricikluar mjaftueshëm pjesë të riciklueshme të automjeteve në fund të jetës. Kjo realizohet duke patur prodhues automjetesh, etj. dhe operatorë të bizneseve për grumbullimin dhe dorëzimin e automjeteve në fund të jetës. Gjithashtu, përcaktohen edhe mënyrat e riciklimit etj., duke ndihmuar në ruajtjen e mjedisit dhe zhvillimin e një ekonomie të shëndoshë kombëtare.

Prokurimi i Mallrave Eko-miqësore

Qëllimi i këtij ligji është të hartojë dispozitat e nevojshme: a) për të nxitur shtetin, institucionet e pavarura administrative etj. dhe qeveritë vendore që të prokurojnë mallrat eko-miqësore, etj. b) të japin informacion për mallrat eko-miqësore etj. dhe c) të nxisë një ndryshim në kërkesën drejt mallrave eko-miqësore etj. për shfrytëzimin e më shumë mallrave të riciklimit, duke ndihmuar në aktivitetet e riciklimit. Kjo ndihmon në krijimin e shoqërisë, që mund të gëzojnë zhvillimin e qëndrueshëm e të harmonizuar me mbrojtjen e mjedisit si dhe të ndihmojë për të pasur një jetesë të shëndoshë dhe të kulturuar të qytetarëve sot dhe në të ardhmen.

Marrëdhëniet e ligjeve përkatëse janë ilustruar në figurën 5.11.2. Për të përmbushur Planin MIMN në përputhje me ligjet dhe direktivat e BE-së, kërkohet të hartohet një sistem i ngjashëm ligjor edhe në Shqipëri dhe aktet nënligjore përkatëse të BT.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 5.11.2 Sistemi Ligjor në Japoni për Themelimin e Shoqërisë së Shëndoshë të Orientuar nga Riciklimi

(3) Themelimi i Sipërmarrjes Alb të Rikuperimit dhe Riciklimit

Në Tiranë, mbetjet e paketimit zënë një vëllim të madh, veçanërisht në zonën tregtare. Mbetjet e paketimit përbëhen nga letra dhe plastika, të cilat janë materialet tipike të riciklimit nëse në Shqipëri është krijuar një sistem rikuperimi e riciklimi funksional. Rastet në Gjermani dhe Francë që jepen në vijim, janë praktika të mira për të përballuar riciklimin e mbetjeve të paketimit.


Në Gjermani, organizata jofitimprurëse Duales System Deutschland AG (DSD) është themeluar në vitin 1990 në zbatim të Urdhëresës së Paketimit sipas Aktit të Mbetjeve. DSD-ja është themeluar nga investimet e më shumë se 600 kompanive anëtarëve, duke përfshirë ato të mallrave të konsumit dhe industrisë të paketimit, kompanitë e shitjes me shumicë, shpërndarësit, shitësit, furnizuesit e materialeve etj., që marrin përgjegjësitë e prodhuesve sipas përcaktimeve të Urdhëresës së Paketimit. DDS ndërmerr përgjegjësitë e prodhuesve në emër të kompanive

anëtare. Pra, nëse kompanitë prodhojnë mbetje të paketimit nuk marrin pjesë në sistemin DDS, këto kompani do të marrin përgjegjësi të plota për mbetjet në fund të jetës. DDS kryejnë rikuperimin e materialeve të riciklueshme nëpërmjet grumbullimit të kontejnerëve ose sistemit të depozitimit, për të sjellë materialet e riciklueshme në stacionet e grumbullimit të caktuara, krahas riciklimit të materialeve të rikuperuara. Në praktikë, DDS jep me nënqira procesin e riciklimit të kompanitë ricikluese ose të prodhuesit.

Në Francë, një sistem i ngjashëm është ngritur për rikuperimin dhe riciklimin e mbetjeve të paketimit. Eco-EMBALLAGES (Paketimet) është themeluar në vitin 1992. Po ashtu si në rastin e Gjermanisë, anëtarët marrin përgjegjësi të prodhuesve në emër të kompanive anëtare. Megjithatë, Eco-EMBALLAGES nuk grumbullon materiale të riciklueshme drejtpërdrejt, sepse rikuperimi i materialeve të riciklueshme kryhet nga bashkitë/komunat dhe eko-EMBALLAGES siguron mbështetjen financiare të komunave/bashkive për grumbullimin e ndarë.

Të dy organizatat menaxhohen nga investimet e kompanive anëtare dhe nga të ardhurat prej veprimtarive. Figura 5.11.3 tregon ravijëzimet e aktiviteteve të DDS dhe Eco-EMBALLAGES.

Në rastin e Shqipërisë, përgjegjësitë e prodhuesve janë përcaktuar në bazë të Ligjit “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Urbane” të vitit 2011. Në lidhje me hartimin e Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës, organizata jofitimprurëse e quajtur Sipërmarrja Alb e Rikuperimit dhe Riciklimit është propozuar që të marrë përgjegjësi të prodhuesve në emër të kompanive anëtare, të cilat investojnë në ndërmarrje për të ndërmarrë rikuperimin dhe riciklimin e mbetjeve të paketimit. Themelimi i Sipërmarrjes Alb të Rikuperimit dhe Riciklimit do të mbështetet në rregullat të rrepta dhe rregulloret për përgjegjësi të prodhuesve. Prandaj, miratimi dhe zbatimi i rregullave dhe rregulloreve përkatëse, të ngjashme me rastin e lartpërmendur në Japoni për kuadrin ligjor të themelimit të shoqërisë së shëndoshë orientuar të riciklimi i burimeve është baza për themelin e Sipërmarrjes Alb të Rikuperimit dhe Riciklimit.



Shënim: Në Japoni, sistemi i riciklimit i shtrirë në të gjithë vendin nuk ekziston. Kompanitë individuale ose grupe kompanish ngrejnë sistemin e tyre të rikuperimit dhe riciklimit për të pëmbushur përgjegjësitë e tyre.

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 5.11.3 Sistemi i Rikuperimit dhe Riciklimit të Mbetjeve të Paketimit në Gjermani dhe Francë

5.11.2. Skica e Planit të Zhvillimit të Kapacitetit Institucional

Masterplani i zhvillimit të kapacitetit institucional përfshin planet, projektet dhe programet e përmbledhura në Tabelën 5.11.1

Tabela 5.11.1 Skica e Planit të Zhvillimit të Kapacitetit Institucional

Planet, Veprimet dhe Projektet			Përshkrimi i Punëve
MMN-5 Plani i Zhvillimit të Kapaciteteve Institucionale			Përmirësimi dhe fuqizimi i strukturës institucionale në lidhje me strukturën organizative, sistemi i raportimit, rregullave operative, etj., për zbatimin e planeve të veprimit të propozuara, programeve dhe projekteve
	MMN-5-1	Ngritja/Krijimi i Ekipit të Punës të Projekteve dhe Zbatimit të Projekteve Parësore	Organizimi i një Ekipi Punues i Projekteve ka rol parësor për përgatitjen e planeve të zbatimit dhe buxhetin për zbatimin e planeve të veprimit të planifikuara dhe/ose projektet parësore. Fillohet me një staf të përkohshëm, të zhvilluar për stafin e përhershëm të Sektorit të Planifikimit në të ardhmen në kuadër të Drejtorisë së Menaxhimit të Mbetjeve
	MMN-5-1-1	Rekrutimi i Personelit të Sektorit të Projekteve	Anëtarët e Ekipi Punues të Projekteve duhet të caktohen që në fillim të 2013
	MMN-5-1-2	Orientimi i Planveprimeve të Planit të MIMN, Modifikimi dhe Përfundimi	Të zhvillojë një program orientimi për anëtarët e personelit të Grupit Punues të Projekteve për përmbajtjen e planeve të veprimit dhe projekteve parësore dhe të modifikojë dhe përfundojë konfigurimin e projekteve parësore drejt zbatimit.
	MMN-5-1-3	Përgatitja e Planit të Zbatimit të Projekteve Parësore	Përgatitja e një plan me faza zbatimi për projektet parësore, që mbulojnë periudhat e ngutshme/afatshkurtra, planet afatmesme dhe afatgjata për shtatë zërat e projektit.
	MMN-5-1-4	Buxheti për Zbatimin e Projekteve Parësore	Llogaritja e kostove për zbatimin pesëvjeçarë të projekteve parësore dhe përditësimin e kostos para fillim të vitit fiskal për koston e buxhetit të projektit për vitin e ardhshëm fiskal.
	MMN-5-2	Hartimi i Planit të Zbatimit për Zhvillimin e Kapaciteteve Institucionale	Ekipi i Projektit të formulojë planin e zbatimit të zhvillimit të kapaciteteve institucionale për të përmirësuar shërbimet e MMN përmes aktiviteteve për rekrutimin e personelit të trajnimit për zhvillimin e kapaciteteve, miratimin e akteve nënligjore, rregullave, rregulloreve mbi MMN, hartimi dhe miratimi i masterplanit, anketime etj.
	MMN-5-3	Ngritja e një Sistemi Institucional Shtesë	Miratojnë dhe zbatojnë aktet nënligjore, rregullat, rregulloret, standardet etj. dhe studiojnë skemën të PPP për krijimin e një korporate për të trajtuar materialet e veçanta të riciklueshmet për rikuperimin dhe riciklimin
	MMN-5-3-1	Miratimi i akteve nënligjore në përputhje me Ligjin e MIMN	Të miratojnë dhe zbatojnë rregullat dhe rregulloret nga aktet nënligjore të BT për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në Ligjin për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta
	MMN-5-3-2	Përgatitja e rregullave, rregulloreve, kriterëve, standardeve, etj.	Të përgatisë dhe zbatojë rregullat, rregulloret, kriteret, standardet, udhëzimet, etj. për zbatimin e projekteve MMN, që përfshijnë pjesëmarrjen e palëve të interesuara
	MMN-5-3-3	Studimi dhe Ngritja e Kompanisë ALB të Rikuperimit dhe Riciklimit të Burimeve	Studimi i mundësive për krijimin e një korporate për rikuperimin dhe riciklimin e burimeve dhe për të trajtuar materialet e riciklueshme ekskluzivisht në mbetjet e ngurta me anë të skemës së partneritetit publiko-privat (PPP).
	MMN-5-4	Hartimi dhe Miratimi i Planit të MIMN	Përfundimi i Masterplanit të MMN dhe të marrë miratimin zyrtar të masterplanit për BT. Masterplani duhet të rishikohet dhe përditësohet periodikisht.
	MMN-5-4-1	Rishikimi, Modifikimi dhe Inspektimi i Planit të MIMN	Rishikimi i masterplanit të përgatitur nga Ekipi i Studimit i JICA-s dhe të modifikojë për të përfunduar Masterplanin e Integruar të MMN (PMIMN) e BT sipas nevojës. Rishikimi dhe / ose përditësimi i MIMNP të BT në çdo pesë vjet për të pasqyruar ndryshimin e situatës në vitet e fundit dhe perspektivat në të ardhmen
	MMN-5-4-2	Miratimi Zyrtar i Masterplanit të MIMN	Dorëzimi i PMIMN të BT në Këshillin Bashkiak për miratim
	MMN-5-5	Vrojtimi i të Dhënave Bazë për Treguesit e Performancës dhe Raportimin	Krijimi i një sistemi raportimi për aktivitetet e MMN dhe për të zhvilluar anketa/vrojtime për sigurimin e treguesve të vlerësimit
	MMN-5-5-1	Përgatitja e Raportit Mjor dhe Vjetor	Standardizimin e të dhënave të aktiviteteve për përgatitjen e raportit mjor krahas përgatitjes së raportit vjetor, duke përfshirë përshkrimin e gjendjes dhe vlerësimin e aktiviteteve
	MMN-5-5-2	Ndërgjegjësimi Publik/Sondazhet e Opinioneve për Aktivitetet e MMN	Kryerja e ndërgjegjësimit të publikut dhe anketimi i opinionit për shërbimet e MMN të BT në çdo 3 vjet për të mbledhur të dhënat për të ardhurat, gatishmërinë për të paguar, ankimet, opinionet etj., të përfutuesve
	MMN-5-5-3	Vrojtimi i Sasisë dhe Përbërjes së Mbetjeve Familjare	Kryerja e vërtetimit të sasisë dhe përbërjes së mbetjeve në familje për analizën e normës së prodhimit të mbetjeve për frymë, ndryshimi i përbërjes së mbetjeve të riciklueshme, norma e mbetjeve për përdorim si disa tregues për të vlerësuar nivelin e synuar të aktiviteteve përkatëse dhe tarifave të mbetjeve
	MMN-5-5-4	Vrojtimi i Sasisë dhe Përbërjes së Mbetjeve Tregtare/Biznesit	Kryerja e vërtetimit të sasisë dhe përbërjes së mbetjeve tregtare, biznesit dhe institucioneve për analizën e normës së prodhimit të mbetjeve për njësi shërbimi mbetesh, ndryshimit të përbërjes së mbetjeve, normës së mbetjeve të ricikluara, mbetjeve për përdorim si disa tregues për të vlerësuar nivelin e synuar të aktiviteteve dhe tarifave të mbetjeve

MMN-5-6	Vlerësimi i Performancës dhe Nivelit/Objektivave të Synuar në Planin e Zhvillimit të Kapaciteteve Institucionale	Rishikimi dhe/ose vlerësimi i performancës së zbatimit të zhvillimit të kapaciteteve institucionale
---------	--	---

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

5.12. Plani i Fuqizimit Financiar

5.12.1. Kushtet Bazë për Planin e Fuqizimit Financiar

(1) Sistemi i Ndarë i Llogaritjes

Analizimi i një sistemi të ndarë llogaritës të shërbimeve MMN është i nevojshëm për zbatimin e planit të fuqizimit financiar nën Planin e MIMN të Bashkisë së Tiranës. Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e shërbimeve të MMN duhet të ndahen nga sistemi i përgjithshëm llogaritës i BT, për të identifikuar statusin e tanishëm financiar të shërbimeve të MMN. Sistemi i ndarë llogaritës duhet të jetë e dhëna bazë për përcaktimin e një sistemi të drejtë tarifor për mbetjet, në BT. Do të kërkohet transparenca për llogarinë e ndarë të MMN dhe pasqyrimin financiar e duke bërë publike përmes faqes elektronike të BT-së. Për këtë duhet të caktohet një llogaritar(e) në sektorin financiar ose të punësohet punonjës i ri për të kryer analizën financiare të shërbimeve të MMN në drejtimin e Ekipit të Punës së Projekteve dhe administratorit në ngarkim të menaxhimit financiar në BT.

(2) Analiza e Rrjedhës së Parave (Cash Flow) dhe Pasqyrat Financiare

Bazuar në ndarjen e sistemin llogaritës të MMN, duhet të përgatiten analiza vjetore për rrjedhën e parave dhe pasqyrën financiare. Këto analiza duhet të studiohen së bashku me sistemin e tarifave të mbetjeve për të siguruar fillimisht financimin e kërkuar për funksionimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të MMN drejt përmirësimit të qëndrueshmërisë financiare dhe financimit të pavarur për ngritjen e shërbimeve të MMN me kosto të rikuperueshme. BT duhet të studiojë metodën e analizës dhe rishikimit të të ardhurave, koston dhe tarifën e mbetjeve të grumbulluara për të njohur statusin financiar të shërbimeve të MMN. Zbatimi i masterplanit kërkon kosto investimi shtesë, kosto funksionimi dhe mirëmbajtje, prandaj BT duhet të sigurojë burime financimi për zbatimin e planeve të veprimit dhe programeve nga buxheti i tyre vjetor, subvencione nga Qeveria Qendrore, kredi projektsh nga burime të jashtme, përfshirjen e sektorit privat dhe/ose kombinimin e burimeve financiare të sipërpërmendura.

(3) Vendosja e Tarifës Optimale dhe të Drejtë të Mbetjeve

Gjatë zbatimit të Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës duhet të vendoset një sistemi optimal dhe i drejtë për tarifën e mbetjeve. Për këtë arsye, detyra e lidhur me tarifën e mbetjeve duhet të fillojë me rishikimin e tarifës së mbetjeve të vendosur për familjet dhe bizneset. Duke marrë parasysh parimin; përfituesi paguan (PPP), norma e tarifimit të mbetjeve mund të vendoset në nivelin e rikuperimit të plotë të koston. Gjithsesi, koha dhe futja e normës së plotë të tarifimit duhet të përcaktohet duke marrë parasysh gjendjen ekonomike dhe përballueshmërinë e prodhuesve të mbetjeve ose përfituesve. Kur tarifa është shumë e lartë për përballueshmërinë e prodhuesve të mbetjeve, BT do të marrë masa për të gjetur burime financiare për të plotësuar të ardhurat për të ulur normën e tarifuar. Tarifa e mbetjeve në fazën fillestare mund të përcaktohet në shkallën e mbulimit, të paktën të koston së funksionimit dhe të mirëmbajtjes. Sistemi në faza,

zbatohet për rikuperimin e kostos së shërbimit të MMN siç është diskutuar edhe më parë në seksionet e mësipërme.

- Faza e Parë : Mbulimi i kostove të funksionimit dhe mirëmbajtjes
- Faza e Dytë : Mbulimi i pagave të personelit, përveç kostove të mësipërme
- Faza e Tretë : Mbulimi i kostos së amortizimit, përveç kostove të mësipërme (Mbulimi i Plotë i Kostos)

Norma e propozuar për tarifimin e mbetjeve dhe tarifën në vetvete, do të bëhet mbi supozime të drejta të normës së grumbullimit të tarifës së mbetjeve dhe tarifës së depozitimit të mbetjeve, dhe sasisë së tanishme të kostos së investimit kapital, kostos së zëvendësimit, kostos së funksionimit dhe të mirëmbajtjes. Tarifa duhet të optimizohet pasi kërkohet të bëhet një baraspeshë midis të ardhurave dhe kostove në fazën përfundimtare, për të imponuar normën e mbulimit të plotë të kostos. Në kohën që diskutohet tarifa e mbetjeve, duhet të kryhet edhe vërtetimi i ndërgjegjësimit/opinionit të publikut dhe vërtetimi i prodhuesve të mbetjeve tregtare/biznesit për nivelin e të ardhurave, vullnetit për të paguar, mundësisë për të paguar, llojit të biznesit, sipërfaqja e strukturës së aktivitetit të biznesit, numri i personelit dhe lloji i sasisë së mbetjeve etj., për grumbullimin e të dhënave dhe informacionit për të përcaktuar tarifën e mbetjeve. Gjithashtu, vlerësimi i kostos së investimit, kostove të funksionimit dhe të mirëmbajtjes, sasisë së prodhuar të mbetjeve, përqindjes së mbulimit me shërbim grumbullimi etj., duhet të kryhet për rregullimin e tarifës së mbetjeve.

5.12.2. Skica e Planit të Fuqizimit Financiar

Masterplani i zhvillimit të kapaciteteve institucionale përbëhet nga plane, projekte dhe programe të përmbledhura në Tabelën 5.12.1.

Tabela 5.12.1 Skica e Planit të Fuqizimit Financiar

Planet, Veprimet dhe Projektet			Përshkrimi i Punëve
MMN-6 Plani i Fuqizimit Financiar			Formulimi dhe zbatimi i planit financiar për krijimin e një sistemi financiar të qëndrueshëm dhe me perspektivë, përmes vendosjes së një tarife të drejtë për mbetjet të përfituesit.
MMN-6-1	Hartimi i Planit të Zbatimit për Forcimin Financiar		Formulimin e planit të zbatimit për krijimin e një sistemi të llogaritjes MMN në BT duke përfshirë edhe studimin për kostot për njësi, tarifën e mbetjeve, burimet e tjera financiare etj.
MMN-6-2	Studim për Koston për Njësi të MMN dhe Rishikimi i Tarifave të Mbetjeve		Studimi dhe vlerësimi i kostos për njësi për ton për grumbullimin e mbetjeve, trajtimin e ndërmjetëm dhe depozitimin përfundimtar me / pa kosto amortizimi dhe të rishikojë tarifën e mbetjeve të çdo lloji të përfituesit
MMN-6-3	Zbatimi i Planit të Forcimit Financiar		Zbatimin e planit financiar bazuar në forcimin e kornizës kohore dhe përmbajtjet e përcaktuara në planin e zbatimit
MMN-6-3-1	Hapja e Llogarisë së Veçuar të MMN		Studimi dhe përgatitja për ndarjen e të ardhurave dhe shpenzimeve për verifikimin e kostos për njësi dhe tarifën e mbetjeve
MMN-6-3-2	Përgatitja dhe Ngritja e Sistemit të Tarifimit të duhur të Mbetjeve		Anketa e ndërgjegjësimit / mendimit të përfituesve përfshirë gatishmërinë për të paguar, nivelin e të ardhurave, përballueshmërinë për të paguar etj. dhe studimi i përshtatshmërisë së taksës së mbetjeve, raporti i mbulimit me grumbullim të tarifës së mbetjeve të llojeve të ndryshme të përfituesve. Pastaj, të zbatojë një sistem të shëndoshë tarifor të mbetjeve përftuar nga studimi.
MMN-6-3-3	Zbatimi dhe Hapja e Llogarisë së duhur të MMN		Zbatimi i sistemit të pavarur llogaritës për aktivitetet e MMN të BT
MMN-6-4	Vlerësimi i Performancës dhe Nivelit/Objektivave të Synuar në Planin e Forcimit Financiar		Rishikojë dhe / ose të vlerësojë performancën e zbatimit të planit financiar për përmirësimin e sistemit

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

5.13. Plan i Rritjes së Ndërgjegjes së Publikut

5.13.1. Kushtet Bazë për Planin e Rritjes së Ndërgjegjes së Publikut

(1) Rritja e Ndërgjegjes brenda Agjencisë Zbatuese, BT

Plan i duhet të fillojë nga rritja e ndërgjegjësimit të personelit të BT i interesuar për të siguruar një shërbim të MM-së cilësor për përfituesit. Grupet e synuara janë anëtarët e Ekipit të Punës së Projektit të propozuar, personeli i Drejtorisë së Menaxhimit të Mbetjeve, personeli dhe menaxherët e Drejtorive të tjera dhe menaxherët administrativë të BT. Ngritja e vetëdijes të tyre do të bëhet për të kuptuar plotësisht misionin, qëllimin, strategjitë, përshkrimin e planeve të veprimit të propozuara dhe afatin e zbatimit etj. Takimet periodike të brendshme dhe programet e trajnimit do të jenë të frytshme për rritjen e ndërgjegjësimit për veten për përmbushjen e përgjegjësiave parësore dhe rolet për shërbimet MMN.

(2) Rritja e Ndërgjegjes Publike

Rritja e ndërgjegjes së publikut duhet të kryhet nëpërmjet programeve të marrëdhënieve me publikun dhe materialet e përgatitura nga Ekipi i Punës me Projektet, në bashkëpunim me palët e interesuara. Programet mund të përfshijnë:

- Fushata publike përmes masmedias p.sh. programeve televizive dhe radiofonike, gazeta, fletëpalosje, debate publike etj.,
- Aktivitete të OJQ-ve, OBK (Organizatave me Bazë Komunitare), OJP-të, për edukim joformal për MMN
- Projektet pilot të përfshirjes së komunitetit,
- Programet e përfshirjes së grupeve të interesit.

Programet për rritjen e ndërgjegjësimit publik kryesisht janë drejtuar kryesisht për banorët dhe programet për fëmijë dhe studentë duhet të kryhen përmes edukimit shkollor. Programet për rritjen e ndërgjegjësimit të palëve të interesuara duhet të përgatiten për përmbushjen e përgjegjësiave të prodhuesve për të bërë rikuperimin, ndarjen dhe ruajtjen e materialeve të riciklueshme në secilin vend të punës krahas programeve për pakësimin e sasisë së prodhimit të mbetjeve.

Rritja e ndërgjegjes së publikut do të jetë e suksesshme kur sa më shumë banorë të marrin pjesë në programet e 3R për uljen, ripërdorimin, ndarjen dhe rikuperimin e mbetjeve në burimin e prodhimit të mbetjeve. Aktivitetet e Impiantit të Rikuperimit të Materialeve (FRM) në qytet janë propozuar të pozicionohen në një sërë vendesh në qytet. Programet e FRM në qytet duhet të nxiten fillimisht në grupet komunitare për të kuptuar se pjesëmarrja në shërbimet publike është e nevojshme për të mbajtur një komunitet të pastër. Përpara zbatimit të planit, Ekipi i Punës me Projektet duhet të rishikojë të gjitha aktivitetet, që do të thotë: rikuperimi i të riciklueshmeve nga grumbulluesit e mbetjeve, mundësitë për aktivitetet e kompostimit familjarë dhe komunitarë, vendet për ndërtimin ose marrjen me qira, ose të sigurojë në hapësirat e hapura të ndërtesave ekzistuese për FRM në Qytet, sistemet e tregtimit të të riciklueshmeve, përfshirjen e industrive të riciklimit, mbështetjes dhe asistencës së vlershme të BT, etj., dhe të lidhen me aktivitetet në zona.

Ekipi i Punës me Projektet në bashkëpunim me Minibashkitë duhet të përgatisë programet për përfshirjen e komunitetit, duke filluar brenda zonës tipike të studimit pilot dhe zgjerimit në zonat ngjitur dhe më tej në tërë zonën e BT. Programet duhet të formulohen me përfshirjen e të

gjitha palëve të interesit duke përfshirë banorët, minibashkitë dhe qeverinë qendrore me nismë të BT.

(3) Edukimi në Shkollë

Rritja e ndërgjegjes të fëmijëve në shkolla dhe studentëve duhet të jetë në formë kurrikule për edukimin në shkolla. Projekti i Punës me Projektet, i asistuar nga Drejtoritë e BT-së dhe Ministrinë përkatëse duhet të përgatisin tekstet për edukimin në arsimin 9-vjeçar. Tekstet duhet të përgatiten në mënyrë që të kuptohen qartë rëndësia e mjedisit të pastër, dëmet e ndotjes dhe rreziqet e tyre nga ana pamore. Tekstet duhet të kenë rubrika me çështje kyçe për diskutime të mtejshme në shkollë dhe në shtëpi. Gjithashtu, programet video duhet të quhen si një nga mjetet më të suksesshme të edukimit në shkolla. Veç kësaj, kurrikula në shkolla duhet të përfshijë programe vizitash në terren për grumbullimin e mbetjeve, trajtimin e ndërmjetëm, depozitimin e mbetjeve dhe industrinë e riciklimit. Në këtë mënyrë ata shohin veprimtaritë e sotme dhe për të menduar për ndihmesën e tyre në aktivitetet e MMN. Për më tepër, rezultati i edukimit në shkolla duhet të ofrojë një shans për përfshirjen e prindërve dhe të gjithë anëtarëve të familjes me aktivitetet e MMN. Programet e edukimit në shkolla duhet të ndërmerren në mënyrë të vazhdueshme, çdo vit në përputhje me kurrikulën dhe programet shkollore të përgatitura nga Ekipi i Punës me Projektet, me pjesëmarrjen e autoriteteve edukuese përgjegjëse.

5.13.2. Skica e Planit të Rritjes së Ndërgjegjësimit të Publikut

Masterplani i rritjes së ndërgjegjes së publikut përbëhet nga plane, projekte dhe programe të përmbledhura në Tabelën 5.13.1.

Tabela 5.13.1 Përmbledhje e Planit të Rritjes së Vetëdijes së Popullsisë

Planet, Veprimet dhe Projektet			Përshkrimi i Punëve
MMN-7 Plani i Rritjes së Ndërgjegjes Publike			Formulimi i planit të rritjes së ndërgjegjes së publikut për përgjegjësitë e palëve të interesuara për mbetjet e shkarkuara nga ata dhe nxitja e bashkëpunimit me planveprimet e MMN, që duhen ndërmarrë me përfshirjen e shoqërisë
	MMN-7-1	Hartimi i Planit të Zbatimit për Rritjen e Vetëdijes së Popullsisë	Formulimi i planit të zbatimit për të organizuar grupet e komunitetit për pjesëmarrje në aktivitetet e 3R nëpërmjet marrëdhënieve me publikun, edukimit formal dhe joformal, etj.
	MMN-7-2	Zbatimi i Planit të Rritjes së Ndërgjegjes Publike	Për të njoftuar publikun për konceptin e 3R, duke kursyer burime të mendjes, mbështet për krijimin e një Shoqërie të Shëndoshë Orientuar te Riciklimi (ShShOR). Zbatimi do të fillojë në zonat e studimit pilot dhe të shpërndajë aktivitetet në të gjithë zonën e BT.
	MMN-7-2-1	Zbatimi i Planit të Marrëdhënieve me Publikun	Për të zbatuar informacionin publik të MM-së përmes mediave masive për rritjen e ndërgjegjësimit të banorëve
	MMN-7-2-2	Zbatimi i Planit të Edukimit në Shkolla	Për të përfshirë kurrikulën për mbrojtjen e mjedisit dhe përgjegjësinë për MM-në
	MMN-7-2-3	Zbatimi i Planit të Zbatimit Joformal	Të kryejë takimet publike dhe në vendet e punës për paraqitjen / diskutimin e ruajtjes së mjedisit dhe përgjegjësinë për MM-në
	MMN-7-2-4	Zbatimi i Planit të Përfshirjes së Komunitetit	Të organizojë disa grupe komunitare për grupe modele në zonë për të zbatuar ndarjen në burim, rikuperimin, kompostimin në shtëpi / komunitetit
	MMN-7-3	Vlerësimi i Performancës dhe Nivelit/Objektivave të Synuar në Planin e Rritjes së Ndërgjegjes Publike	Rishikojë dhe/ose vlerësoj performancën dhe nivelin e synuar për të konsideruar përmirësimet në sistem.

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

5.14. Fazat / Udhërrëfytyesi për Krijimin e Sistemit të MIMN

Planet, programet dhe projektet e formuluar në masterplan për Planin e MIMN të Bashkisë së Tiranës, janë ndarë në shtatë (7) zëra siç propozohet në seksionet e mëparshme. Me qëllim përmbushjen e niveleve të synuara të aktiviteteve në përputhje me afatin kohor të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve, Ligjin dhe Direktivat e BE-së, BT duhet të ndërmerret ndërtimin e impianteve dhe të sistemeve bazuar në tri (3) faza të periudhave të zbatimit.

Plani i Ngutshëm dhe Afatshkurtër : 2013-2017

Plani Afatmesëm : 2018-2022

Plani Afatgjatë : 2023-2027

Afati kohor i zbatimit të planeve, programeve dhe projekteve të çdo komponenti tregohet në Figurën 5.14.1.

Tabela 5.14.1 Zbatimi i Afatit Kohor të Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës (2/1)

Plan Veprimet		Periudha Emergjente dhe Afat-Shkurtër					Periudha Afat-Mesme					Periudha Afat-Gjatë				
		2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
MMN-1	Plani i Grumbullimit dhe Transportimit të Mbejeve															
MMN-1-1	Harfimi i Planit të Zbatimit për Grumbullimin dhe Transportimin e Mbejeve															
MMN-1-2	Vrojtimi i Vendpозitmeve ilegale dhe Përgatitja e projektit të Pastimit															
MMN-1-3	Zbatimi i Projektit të Pastimit të Vendpозitmeve ilegale përmes Kontraktimit															
MMN-1-4	Zbatimi i Studimit Pilot për Përmirësimin e Shërbimit të Grumbullimit të Mbejeve															
MMN-1-4-1	Studimi për zgjerimin e Zonës së Shërbimit me Sistemin e 3-koshave															
MMN-1-4-2	Studimi i Grumbullimit të Ndare të Mbejeve për Mbejjet Speciale															
MMN-1-4-3	Zbatimi i Grumbullimit të Ndare në Zonat Pilot të Studimit															
MMN-1-5	Operimi/Funksionimi i Grumbullimit të Ndare sipas Sistemit me 3-kosha															
MMN-1-6	Monitorimi/Inspektimi i Aktiviteteve të Grumbullimit të Mbejeve															
MMN-1-7	Vlerësimi i Performancës dhe Nivelit/Objektivave të Synuar në Planin e Grumbullimit të Mbejeve															
MMN-2	Plani i Minimizimit të Mbejeve (Plani 3R)															
MMN-2-1	Harfimi i Planit të Zbatimit për Aktivitetet 3R															
MMN-2-1-1	Harfimi i Planit të Zbatimit për Reduktimin e Mbejeve															
MMN-2-1-2	Harfimi i Planit të Zbatimit për Rekuperimin, Ripërdorimin, Ricklimin e Mbejeve															
MMN-2-2	Zbatimi i Aktiviteteve 3R															
MMN-2-2-1	Promovimi i Kontrollit të Burimit të Prodhitimit të Mbejeve															
MMN-2-2-2	Promovimi i Kontrollit të Shkarkimit të Mbejeve															
MMN-2-2-3	Promovimi i Rekuperimit të Materialeve të Ricklueshme															
MMN-2-2-4	Promovimi i Ripërdorimit dhe Ricklimin të Materialeve të Ricklueshme															
MMN-2-2-5	Ndërtimi i Implantit Qendror të Rekuperimit të Materialeve në Sharrë															
	Puna Civile															
	Puna e Ndërtimit															
	Punimet Mekanike&Elektrike															
	Punimet Inxhinierike (Projektim 5% : Supervizim 5%)															
MMN-2-2-6	Operimi/Funksionimi i Implantit Qendror të Rekuperimit të Materialeve në Sharrë															
	Kosto Operative (Kosto e Personelit)															
	Kosto Operative (Energjia Elektrike & Shpërdorime)															
	Kostja e Mirëmbajtjes															
MMN-2-3	Monitorimi i Zbatimit të Aktiviteteve 3R															
MMN-2-4	Vlerësimi i Performancës dhe Nivelit/Objektivave të Synuar në Planin e Minimizimit të Mbejeve															
MMN-3	Plani i Trajtimin të Ndërmjetëm															
MMN-3-1	Harfimi i Planit të Zbatimit për Planin e Trajtimin të Ndërmjetëm															
MMN-3-1-1	Harfimi i Planit të Zbatimit për Trajtimin e Mbejeve Organike															
MMN-3-1-2	Harfimi i Planit të Zbatimit për Mbejjet-në-Energji															
MMN-3-2	Zbatimi i Planit të Trajtimin të Mbejeve Organike															
MMN-3-2-1	Organizimi i Kompostimit në Shëpi dhe Grupeve Komunitare të Kompostimit															
MMN-3-2-2	Zbatimi i Projektit Pilot të Kompostimit në Shëpi dhe Komunitet															
MMN-3-2-3	Zgjerimi/Shëritja e Praktikës së Kompostimit në Shëpi dhe Komunitet															
MMN-3-2-4	Përzgjedhja e Burimit të Madh të Prodhitimit të Mbejeve të Biodegradueshme															
MMN-3-2-5	Ndërtimi i Implantit të Kompostimit i Shkallës Pilot															
	Puna Civile															
	Puna e Ndërtimit															
	Punimet Mekanike&Elektrike															
	Punimet Inxhinierike (Projektim 5% : Supervizim 5%)															
MMN-3-2-6	Operimi/Funksionimi dhe Mirëmbajtja e Implantit të Kompostimit i Shkallës Pilot															
	Kosto Operative (Kosto e Personelit)															
	Kosto Operative (Energjia Elektrike & Shpërdorime)															
	Kostja e Mirëmbajtjes															
MMN-3-2-7	Ndërtimi i Implantit Qendror të Kompostimit/Biogazifikimit															
	Puna Civile															
	Puna e Ndërtimit															
	Punimet Mekanike&Elektrike															
	Punimet Inxhinierike (Projektim 5% : Supervizim 5%)															
MMN-3-2-8	Operimi/Funksionimi dhe Mirëmbajtja e Implantit Qendror të Kompostimit/ Biogazifikimit															
	Kosto Operative (Kosto e Personelit)															
	Kosto Operative (Energjia Elektrike & Shpërdorime)															
	Kostja e Mirëmbajtjes															
MMN-3-3	Vlerësimi i Performancës dhe Nivelit/Objektivave të Synuar në Planin e Trajtimin të Mbejeve Organike dhe në-Energji															
MMN-3-4	Zbatimi i Planit të Mbejeve-në-Energji															
MMN-3-4-1	Përzgjedhja e Vendi të Ndërtimit dhe Prokurimi															
MMN-3-4-2	Ndërtimi i Mbejeve-në-Energji															
	Puna Civile															
	Puna e Ndërtimit															
	Punimet Mekanike&Elektrike															
	Punimet Inxhinierike (Projektim 5% : Supervizim 5%)															
MMN-3-4-3	Operimi/Funksionimi dhe Mirëmbajtja e Implantit të Mbejeve-në-Energji															
	Kosto Operative (Kosto e Personelit)															
	Kosto Operative (Karburant, Lëndë Kimike & Ujë)															
	Kostja e Mirëmbajtjes															
MMN-3-5	Vlerësimi i Performancës dhe Nivelit/Objektivave të Synuar në Planin e Mbejeve-në-Energji															

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Tabela 5.14.2 Zbatimi i Afatit Kohor të Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës (2/2)

[illegible]

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

5.15. Listimi i Projekteve/Veprimeve Parësore

Projektet parësore apo planet e menjëhershme të veprimit janë zgjedhur përkohësisht duke marrë parasysh nevojën e ngutshme, efektet e pritshme të projektit, përputhshmërinë e nevojshme me objektivat në Ligj, strategjitë dhe planet kombëtare, direktivat e BE-së, si dhe të ndërlidhjes së planeve, programeve dhe projekteve midis shtatë (7) zërave të propozuar në Planin MIMN. Veprimet/Projektet parësore të çdo zëri të shënuar deri tani do të shqyrtohen sërish në seksionin pasardhës për zërat e çdo pakete projekti.

Planveprimet e Grumbullimit dhe Transportimit të Mbetjeve

- Zbatimi i Projektit të Pastrimit të Venddepozitimeve të Paligjshme,
- Zbatimi i grumbullimit të ndarë në Zonat pilot të Studimit dhe Zgjerimit në zonat fqinjë.

Planveprimet e Pakësimit të Mbetjeve (Plani 3R)

- Zbatimi i Aktiviteteve 3R në zonat pilot të studimit.

Planveprimet e Trajtimit të Ndërmjetëm

- Ndërtimi i impiantit pilot të Kompostimit/Biogazifikimit dhe funksionimi,
- Ndërtimi i Impiantit Qendror të Kompostimit/Biogazifikimit dhe funksionimi,
- Ndërtimi i Impiantit të Mbetjeve në Energji dhe funksionimi.

Planveprimet e Depozitimit të Mbetjeve

- Ndërtimi i Landfillit Sanitar në Zgjerimin e Sharrës Vendi-1 dhe funksionimi.

Planveprimet e Zhvillimit të Kapaciteteve Institucionale

- Ngritja e Ekipit të Punës së Projekteve, orientimi, trajnimi dhe formulimi i masterplanit të MMN, miratimi zyrtar i masterplanit të MMN, ndarja e buxheteve për projekt,
- Zbatimi i vrojtimit të ndërgjegjësimit publik/opinionit për aktivitetet e MMN.

Planveprimet e Fuqizimit Financiar

- Ngritja e një sistemi të shëndoshë tarifor për mbetjet dhe zbatimi/ngritja e një llogarie të qëndrueshme të MMN.

Planveprimet e Rritjes së Ndërgjegjes Publike

- Zbatimi i planit të përfshirjes së komunitetit në zonat pilot për aktivitetet 3R, zgjerimin e zonave të shërbimit dhe grumbullimin e ndarë të mbetjeve.